



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 566 Akti

Nr. 717 Vendimi
Tiranë, më 23.11.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektashi Kryesuese
Pamela Qirko Relatore
Roland Ilia Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, në datën 21.11.2023, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Elio Mazreku**, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shpresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë

22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 5 të nenit 3, si dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Elio Mazreku, aktualisht me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2020 zhvilloi procedurën e shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupa gjyqësore, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Elio Mazreku, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor nr. 2, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjyqësor të datës 19.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionerja Brunilda Bekteshi, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar – ish-DSIK (në vijim AKSIK); Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë nr. *** prot., datë 5.11.2018.

rivlerësimit, z. Elio Mazreku. Në përfundim të veprimeve verifikuese për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasurisë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar raportet² e saj për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Elio Mazreku.

12. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në KLP ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm e të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 23.10.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës së subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Gjithashtu, po në datën 23.10.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua (me *email*) mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 26.10.2023, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve në datën 16.11.2023, në rrugë elektronike (*email*).

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion, trupi gjykues ftoi në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit me njoftimin e bërë elektronikisht, me *email*, në datën 17.11.2023.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 21.11.2023, ora 15:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

18. Subjekti i rivlerësimit, z. Elio Mazreku, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer

² (i) Raporti i AKSIK-së nr. *** prot., datë 2.11.2017; (ii) raporti i AKSIK-së nr. *** prot., datë 21.6.2022 (deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 29.9.2022).

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 9.3.2023.

ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Elio Mazreku, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Z. Elio Mazreku ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

19.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë.

20.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë të përcaktuara qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.4 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

20.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c)

⁴ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale, dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas administrimit të raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së tij. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive.

22.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Elio Mazreku.

22.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca ***), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

23. Zotëron 5/8 pjesë takuese të pasurisë së llojit apartament banimi me sipërfaqe 72 m², ndodhur në bulevardin “*”, Tiranë, përfituar nëpërmjet dhurimit dhe trashëgimisë ligjore.**

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

23.1 Në deklaratën e personave që mbartin detyrimin për deklarim pasurie (deklarata fillestare e pasurisë, dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.3.2004), subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi, ndërtuar para vitit 1990, me sipërfaqe 72 m², ndodhur në rrugën “***”, pallati ***, shkalla ***, apartamenti ***, Tiranë. Deklaron se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie. Si burim krijimi: Privatizuar, kontratë shitblerjeje me N.K.B nr. *** dhe kontratë dhurimi nga gjyshja, E.P*”.

23.2 Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetore (në vijim DIPP) të vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “*Apartament në blv. “***”, p. ***, sh. ***, ap. ***, Tiranë. Përfituar 1/8 pjesë në këtë banesë nga trashëgimia ligjore që buroi nga vdekja e nënës B.R.P (1/8 e sipërfaqes prej 72 m²). Aktualisht apartamenti është në bashkëpronësi 5/8 prej tij dhe 3/8 vëllai D.P . Zotëron 5/8 pjesë takuese mbi këtë pasuri*”.

23.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së mbi këtë pasuri: Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

23.4 Pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi informacionin/dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ⁵ për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, rezultoi se:

⁵ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.12.2020; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 20.3.2018, e ZVRPP-së Tiranë, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (ndodhur në aneksin nr. ***); (iii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); (iv) dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

23.4.1 Në datën 8.2.1994, subjekti i rivlerësimit, nëna B.P, vëllai i tij D.M dhe gjyshja E.P kanë blerë⁶ nga N.K.B, sektori nr. ***, Tiranë, pasurinë e llojit apartament banimi në pallatin nr. ***, shkalla ***, apartamenti nr. ***, me sipërfaqe 72 m², të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, për vlerën 6,821 lekë.

23.4.2 Në datën 25.8.2000, shtetasja E.P (gjyshja) i ka dhuruar⁷ subjektit të rivlerësimit pjesën e saj takuese prej ¼ që ajo zotëronte në pasurinë e llojit apartament banimi në pallatin nr. ***, shkalla ***, apartamenti nr. ***, të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, duke bërë që subjekti të jetë pronar i 2/4 pjesë takuese të kësaj pasurie, nëna e tij B.P me 1/4 pjesë takuese dhe vëllai i tij D.M (P) me 1/4 pjesë takuese.

23.4.3 Në datën 6.9.2013 është vendosur⁸ lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore i së ndjerës B.P, e cila kishte ndërruar jetë në datën 5.6.2013. Si trashëgimtarë ligjorë janë njohur subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij D.P, përkatësisht me nga 1/2 pjesë takuese të pasurisë trashëgimore.

23.4.4 Në datën 26.10.2013, për këtë pasuri është lëshuar dokumenti “Certifikatë për vërtetim pronësie”, me nr. serial ***, në referim të të cilit ajo është regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij D.P , ku rezulton se subjekti zotëron 5/8 pjesë takuese të saj, ndërsa vëllai i tij 3/8 pjesë takuese (pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë rruga “***”, godina ***, hyrja ***, apartamenti ***).

23.5 Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie dhe pjesët takuese që zotëronte mbi të, si dhe se nuk ka dyshime për burimin e krijimit të saj.

23.6 Në vijim, rezulton se në datën 9.6.2020 shtetasi D.P i dhuron⁹ vëllait të tij (subjektit të rivlerësimit) pjesën e tij takuese që dispononte mbi këtë pasuri. Si rrjedhim, subjekti i rivlerësimit bëhet pronar i vetëm i kësaj pasurie, duke zotëruar 100% pjesë takuese të saj¹⁰.

24. Zotëron 1/7 pjesë takuese të pasurisë së llojit banesë private me sipërfaqe 190 - 200 m², ndodhur në rrugën “*”, përfutur nëpërmjet trashëgimisë ligjore (vendim gjykate nr. ***, datë 12.11.2001).**

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

24.1 Në deklaratën e personave që mbartin detyrim për deklarim pasurie (deklarata fillestare e pasurisë, dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.03.2004), subjekti ka deklaruar: “*Shtëpi banimi e ndërtuar para viteve 1990, me sipërfaqe 150 m², ndodhur në rrugën “***”, Tiranë. Deklaron se zotëron 15% (1/7) pjesë takuese të kësaj pasurie. Si burim krijimi: Trashëguar prej gjyshes nga babai, S.H (M).*”

24.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së mbi këtë pasuri: Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

⁶ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.2.1994, redaktuar nga noteri publik, znj. M.S.

⁷ Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.8.2000, redaktuar nga noteri publik, znj. Sh.K .

⁸ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 6.9.2013, “Për lëshimin dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënës B.P”, i cili ka marrë formë të prerë në datën 21.9.2013.

⁹ Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2020, redaktuar nga noteri publik, znj. E.B.

¹⁰ Në datën 29.6.2020 është lëshuar dokumenti “Certifikatë për vërtetim pronësie” me nr. serial ***, në referim të së cilës subjekti figuron 100% pronar i pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë rruga “***”, nd. ***, ap. ***, me sip. 72 m²).

24.3 Pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi informacionin/dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ¹¹ për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, rezultoi se:

24.3.1 Në datën 2.6.1998, halla e subjektit të rivlerësimit, znj. B.M , ka regjistruar pranë Zyrës së Hipotekës Tiranë pasurinë e llojit shtëpi banimi, me nr. ***, e cila përbëhet nga dy dhoma dhe ambiente të tjera ndihmëse, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë. Kjo pasuri është përfituar nga kjo shtetase me anë të vendimeve gjyqësore: (a) nr. ***, datë 8.8.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (b) nr. ***, datë 23.1.1998, të Gjykatës së Apelit; (c) nr. ***, datë 19.5.1998, të Gjykatës së Kasacionit.

24.3.2 Në datën 23.5.2001, në favor të shtetasve B.M është lëshuar vërtetimi/dokumentet hipotekore, ku sipas regjistrimit nr. *** ajo figuron pronare e pasurisë së llojit shtëpi banimi, me nr. ***, e cila përbëhet nga dy dhoma dhe ambiente të tjera ndihmëse, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

24.3.3 Pas padisë së bërë nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarë të tjerë të tij, në datën 12.11.2001 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur¹² njohjen si trashëgimtarë me zëvendësim të trashëgimtarëve S.H (M) të paditësve dhe personave të tretë, ku përcaktohet se subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij janë trashëgimtarë ligjorë në 1/7 pjesë së bashku të pasurisë së lënë trashëgim, të llojit banesë private nr. ***, të përbërë nga dy dhoma e ambiente të tjera ndihmëse, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, si dhe detyrimin e së paditurës B.M të njohë të drejtat e detyrimet trashëgimore të paditësve dhe personave të tretë sipas pjesëve të tyre takuese në trashëgiminë ligjore.

24.3.4 Në datën 10.5.2002 është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. *** pasuria e llojit shtëpi banimi, me nr. ***, e përbërë nga dy dhoma dhe ambiente të tjera ndihmëse, me sipërfaqe truall 198 m² dhe ndërtesë 81 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e ndodhur në rrugën “****”, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij D.M , me 1/7 pjesë takuese së bashku; B.M 1/7 pjesë takuese; M, E dhe G.K 1/7 pjesë takuese së bashku; R, O, M, Sh, P dhe Sh.A 1/7 pjesë takuese së bashku; M e R. M 1/7 pjesë takuese së bashku; F e J. K 1/7 pjesë takuese së bashku; A, A dhe A.M 1/7 pjesë takuese së bashku.

24.3.5 Në datën 8.3.2004 është lidhur një aktmarrëveshje¹³ midis shtetasve B.H (M), Elio Mazreku, D.M , M.M, R.M, M.K, E.K, G.K, M.A, Sh.A, Sh.A, R.A, O.A, P.A, A.M, A. M, A.M, F.K dhe J.K, në cilësinë e palës porositëse, dhe shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “ ****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, me objekt vënien në dispozicion të truallit dhe të shtëpisë me nr. ***, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, të përfituar prej tyre si bashkëpronarë me pjesë takuese përkatëse me anë të vendimit nr. ***, datë 12.11.2001, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me sipërfaqe shtëpie 65.7 m² dhe një truall të përgjithshëm rreth 150 m² ndaj dy shoqërive sipërmarrëse me objekt ndërtim, me kusht që këto të fundit të ndjekin të gjitha procedurat për miratimin e lejes së sheshit të ndërtimit dhe më pas lejes së ndërtimit pranë KRRT-së Bashkia Tiranë. Palët kanë rënë dakord që në shkëmbim të truallit dhe të shtëpisë së ngritur mbi të porositësit do të përfitojnë 27% të të gjithë sipërfaqes së ndërtimit që i përket sipërfaqes së truallit. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për ndjekjen e kësaj procedure, si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të këtij qëllimi do të përballohen nga sipërmarrësit dhe pas

¹¹ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.12.2020; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 20.3.2018, e ZVRPP-së Tiranë, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (ndodhur në aneksin nr. ***); (iii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

¹² Vendim nr. ***, datë 12.11.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili duket se ka marrë formë të prerë në datën 27.11.2001.

¹³ Aktmarrëveshje datë 8.3.2004, konfirmuar me dokumentin noterial vërtetim nënshkrimi, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.3.2004, përpara noteres N.K.

daljes së lejes së sheshit të ndërtimit palët angazhohen të përpilojnë midis tyre një kontratë sipërmarrjeje të specifikuar.

24.3.6 Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar nënshkrimin e kësaj aktmarrëveshjeje në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, kjo vlerësuar në rrethanën e verifikimit të të drejtave reale dhe marrëdhënieve të interesave privatë të tij si subjekt deklarues, në kuptim të ligjit për konfliktin e interesave.

24.3.7 Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit lidhur me këtë konstatim, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se *kur ka plotësuar deklaratën e pasurisë për vitin 2004, nuk i ka shkuar ndërmend fare aktmarrëveshja... Kjo aktmarrëveshje ka pasur afat disamujor. Pra, nëse brenda disa muajsh nuk do të përfitohej leja e ndërtimit, ajo humbte vlerën. Leja e ndërtimit nuk u mor kurrë sepse as shoqëria ndërtuese nuk e kërkoi nga bashkia. Edhe sot e kësaj dite nuk është lëshuar leje për atë truall dhe lagjen përreth. Aktmarrëveshja ka qenë një akt paraprak që e përdorte shoqëria ndërtimore për të bllokuar palët që të mos lidheshin me tjetër shoqëri... Aktmarrëveshja është sot pa fuqi ose e vetëzgjdhur, nuk ka prodhuar atëherë dhe nuk prodhon sot asnjë pasojë juridike. Dhe në kohën kur është deklaruar pasuria për vitin 2004 ka përshtypjen që marrëveshja ishte e zgjidhur sipas vetë parashikimeve të saj...*

24.3.8 Në vijim të verifikimeve të kryera lidhur me këtë çështje – referuar dokumentacionit të administruar në dosje – konfirmohet se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, nuk ka pasur procedim penal të mosfilluar të pushuar, të pezulluar apo të dërguar për gjykim për/ndaj shoqërive “****” sh.p.k., “****” sh.p.k., si dhe përfaqësuesit ligjor dhe ortakëve të tyre. Gjithashtu, duket se nuk evidentohen dosje penale të hetuara nga prokurori Mazreku në të cilën ata të shfaqen në cilësinë e kallëzuesit.

24.3.9 Sipas dokumentit “Vërtetim” datë 6.2.2007, lëshuar nga Bashkia Tiranë, konfirmohet se shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka paraqitur kërkesë për leje shesh ndërtimi në pronë të familjes Mazreku, në rrugën “****”, Tiranë.

24.3.10 Sipas dokumentit “Vërtetim” datë 30.3.2007, lëshuar nga Bashkia Tiranë, konfirmohet se shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka paraqitur kërkesë për leje shesh ndërtimi në pronë të familjes Mazreku, në rrugën “****”, Tiranë.

24.3.11 Gjithashtu, ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri¹⁴ konfirmon se pasuria objekt vlerësimi me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sipërfaqe 198 m² dhe ndërtesë 81 m², figuron e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Elio, D, M, R, A, A, A.E.M, M e E.K , R. O, M, Sh, P, Sh. A, F e J.K.

24.4 Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie dhe pjesën takuese që ai zotëronte mbi të, si dhe se nuk ka dyshime për burimin e krijimit të saj.

25. Zotëron 1/3 pjesë takuese të pasurisë së llojit apartament banimi, me sipërfaqe 58.23 m², ndodhur në rrugën “**”, Tiranë, përfutuar nëpërmjet trashëgimisë ligjore.**

25.1 Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë ndër vite pjesën takuese që ai zotëronte mbi këtë pasuri.

25.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së mbi këtë pasuri: Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.12.2020.

25.3 Pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi informacionin/dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ¹⁵ për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, rezultoi se:

25.3.1 Në datën 10.10.1986, N.K.B Tiranë (sektori nr. ***) dhe babai i subjektit të rivlerësimit, z. H.M, kanë lidhur një kontratë qiraje me nr. ***, me objekt marrjen me qira nga ky i fundit të një banese shtetërore të llojit dhomë e kuzhinë në pallatin nr. ***, shkalla ***, apartamenti nr. ***, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

25.3.2 Në datën 20.10.1993, babai i subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, znj. Z.M, kanë blerë¹⁶ nga N.K.B, sektori nr. ***, Tiranë, pasurinë e llojit apartament banimi në pallatin nr. ***, shkalla ***, apartamenti nr. ***, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, për vlerën 4,624 lekë.

25.3.3 Në datën 23.5.2008 është vendosur¹⁷ lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin H.M , i cili kishte ndërruar jetë në datën 18.2.2008. Si trashëgimtarë ligjorë janë njohur bashkëshortja e të ndjerit, znj. Z.M dhe dy djemtë e tij, subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij D.P, përkatësisht me nga 1/3 pjesë takuese të pasurisë trashëgimore.

25.3.4 Duket se bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore, në datën 27.1.2009 kjo pasuri është regjistruar në regjistrat hipotekorë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, vëllait të tij dhe bashkëshortes së babait, znj. Z.M, me nga 1/3 pjesë takuese secili (referuar dokumentit “Kartelë pasurie”).

25.3.5 Në datën 4.2.2009, për këtë pasuri është lëshuar dokumenti “Certifikatë për vërtetim pronësie”, me nr. serial ***, në referim të të cilit ajo është regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, vëllait të tij dhe bashkëshortes së babait, znj. Z.M , me nga 1/3 pjesë takuese në emër të secilit bashkëpronar (pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë rruga “****”, Tiranë).

25.4 Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie dhe pjesën takuese që ai zotëronte mbi të, si dhe se nuk ka dyshime për burimin e krijimit të saj.

26. Zotëron ½ pjesë takuese të pasurisë së llojit apartament banimi, me sipërfaqe 129.1 m², ndodhur në rrugën “**”, Tiranë, blerë në datën 30.6.2010, me vlerë 15,990,000 lekë (pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***).**

26.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar fondet e tërhequra nga disa depozita bankare, më konkretisht: (i) mbylljen e depozitës bankare në BKT; (ii) mbylljen e depozitës bankare në ProCredit Bank; (iii) tërheqjen e kryer nga depozita në Bankën Amerikane të Shqipërisë – duke referuar deklarinë e pasurisë për vitin 2010.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

26.2 Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2010, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi, me sipërfaqe 129.1 m², ndodhur në rrugën “****”, pallati “****”, kati ***, ap. ***, Tiranë, blerë prej tij dhe bashkëshortes në çmimin 15,990,000 lekë.

¹⁵ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.12.2020; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 20.3.2018, e ZVRPP-së Tiranë, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (ndodhur në aneksin nr. ***); (iii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); (iv) dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

¹⁶ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.1993, redaktuar nga noteri publik, znj. M.S.

¹⁷ Vendim nr. ***, datë 23.5.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Për lëshimin dëshmisë së trashëgimisë të të ndjerit H.M”, i cili ka marrë formë të prerë në datën 7.6.2008.

26.3 Sa i përket burimeve të krijimit të kësaj pasurie, ka deklaruar: (a) pakësim të llogarisë në Intesa Sanpaolo Bank, për shkak të tërheqjes së shumës 48,000 euro, përdorur për blerjen e apartamentit; (b) tërhequr shuma 24,417 euro nga llogaria në ProCredit Bank, përdorur për blerjen e apartamentit; (c) tërhequr shuma 39,517 euro nga llogaria në Bankën Kombëtare Tregtare, përdorur për blerjen e apartamentit. Të tria tërheqjet janë në vlerën totale 111,934 euro.

26.4 Konkluzioni i ILDKPKI-së mbi këtë pasuri: Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Tiranë dhe DPPP-ja.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

26.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri¹⁸, dokumentacion i cili është pjesë e dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, si dhe dokumentacionit tjetër të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri (nëpërmjet pyetësorëve të dërguar etj.), konstatohet se:

26.5.1 Në datën 30.6.2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij V.M kanë blerë¹⁹ nga shtetasit F dhe A.V pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 129.1 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, për shumën 15,990,000 lekë, e cila referohet se është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale nga blerësit në favor të shitësit. Shitësi ka deklaruar se është likuiduar dhe se nuk ka asnjë pretendim.

26.5.2 Referuar dy dokumenteve – mandate bankare, të depozituara nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, rezulton se:

a) Në datën 2.7.2010, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e shtetasit F.V në Credins Bank shumën 112,000 euro, me përshkrimin “Elio Mazreku për blerje apartamenti kontratë rep. *** kol. ****”.

b) Në datën 5.7.2010, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka depozituar *cash* në llogarinë e shtetasit F.V në Credins Bank shumën 5,000 euro, me përshkrimin “Blerje apartamenti nga V.F rep. *** kol. ****”.

26.5.2.1 Siç u evidentua më sipër, në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie të datës 30.6.2010, palët kanë deklaruar se janë likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe se nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit. Pra, referuar kësaj kontrate, çmimi i shitjes prej 15,990,000 lekësh (ekuivalenti i shumës në valutë prej 117,000 euro) është likuiduar përpara nënshkrimit të saj.

26.5.2.2 Ndërkohë, referuar dy mandatpagesave bankare të evidentuara si më sipër duket se çmimi i shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi është likuiduar pas nënshkrimit të kontratës.

26.5.2.3 Por, në kushtet kur pagesat janë kryer nëpërmjet sistemit bankar dhe në një periudhë shumë të afërt nga momenti i nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, Komisioni vlerëson të reflektojë në analizën financiare se çmimi i blerjes së kësaj pasurie është likuiduar në datat 2.7.2010 dhe 5.7.2010, sipas mandateve bankare të depozituara nga subjekti.

26.5.3 Rezulton se në datën 8.7.2010 pasuria objekt vlerësimi është regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij (pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë rruga “****”, shkalla ***, kati ***, apartamenti nr. ***, Tiranë, me sipërfaqe 129.1 m²).

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.12.2020.

¹⁹ Kontratë shitblerjeje apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.6.2010, redaktuar nga noteri publik, znj. E.M.

26.5.4 Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie, apartamentit të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie

26.6 Sikurse u evidentua më sipër, si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi subjekti ka referuar shumat e tërhequra nga tri llogari bankare, përkatësisht: (i) tërheqjen e shumës 48,000 euro nga ISP Bank; (ii) tërheqjen e shumës 24,417 euro nga ProCredit Bank; (iii) tërheqjen e shumës 39,517 euro nga BKT.

26.7 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje rezulton se në datën 2.7.2010 (data e kryerjes së pagesës në Credins Bank në shumën 112,000 euro), subjekti dhe personi i lidhur kanë tërhequr nga llogaritë e tyre në ISP Bank, Credins Bank dhe BKT përkatësisht vlerat monetare të deklaruara dhe të evidentuara si më sipër, në total shumën prej 111,934 euro.

➤ **Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtyre llogarive bankare, pra nuk ka deklaruar burimin konkret të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi.**

26.8 Në vijim të hetimit, i pyetur nga Komisioni²⁰ në lidhje me burimet e krijimit të vlerave monetare në tri llogaritë bankare të evidentuara si më sipër, duke i kërkuar të depozitohë dokumentacion justifikues ligjor, si dhe të deklarojë mbi mënyrën e përfitimit të këtyre të ardhurave sipas periudhave përkatëse për çdo vit më vete, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shumat e parave në këto llogari bankare janë krijuar nga të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortes së tij në kuadër të projektit të fondacionit “***” në Shqipëri. Po ashtu, referon se ka pasur dhe të ardhura të tjera nga përfshirja e saj si eksperte, trajnuese, në përkthime etj., në sektorin e OJF-ve. Në vijim, deklaroi se nuk përjashtohet që të kenë pasur edhe kursime që të kenë ndikuar në këto derdhje, me anë të të cilave janë krijuar vlerat e këtyre depozitave.

26.9 Sa i përket pagesës së detyrimeve tatimore, ka sqaruar se: “...*Funksionimi i organizatave jofitimprurëse në Shqipëri rregullohej me ligjin nr. 8888, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”. Duke qenë se në kohën e hapjes së degës së fondacionit “***” në Tiranë, ata nuk pranonin që të hapej shoqatë më vete, por kërkonin degë të tyre në Shqipëri (dhe të tilla degë kishin jo vetëm në Shqipëri), ligji i kohës parashikonte që këto degë fondacionesh të huaja nuk regjistroheshin në gjykatë, por nishin funksionimin e tyre në Shqipëri me një leje/pëlqim nga autoriteti përkatës shtetëror shqiptar”.*

26.10 Po ashtu, lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, subjekti ka parashtuar se referuar nenit 40 të ligjit nr. 8888, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”: “1. “*Organizatave jofitimprurëse, pavarësisht nga format e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat që realizojnë nga dhurimet, grantet, interesat bankare dhe kuotat e anëtarësisë. 2. Organizatat jofitimprurëse, që kryejnë veprimtari ekonomike në përputhje me nenin 36 të këtij ligji, i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat vetëm në rast se të ardhurat e realizuara nuk destinohen për veprimtari për të cilat organizata është regjistruar”.*

26.11 Në vijim ka referuar se V.Sh.M, sipas kontratës, ka qenë me detyrë “*Local Consultant for Albania*” dhe si rrjedhojë mendon që ka qenë kjo arsyeja përse është menduar që kjo e ardhur (fee) nuk duhet t’i nënshtrohej këtij tatimi. Nga ana tjetër, subjekti deklaroi se nëse punëdhënës/kontraktorë të ndryshëm për të cilët ajo ka punuar (duke kryer shërbime konsulence, përkthime, punë të çfarëdolloji, sikurse janë deklaruar ndër vite) kanë zbritur detyrimet tatimore në burim sipas ligjit të kohës, e në këtë kontekst mendon që kjo duhet parë zë për zë në çdo rast pagese dhe sipas kontratave përkatëse ose dokumenteve që përfshinin palët në të tilla marrëdhënie, pa folur dhe për politikën financiare që ndiqte secili prej tyre. Nëse dikush nuk e ka përcaktuar në kontratë specifikisht që detyrimi tatimor do të duhej të

²⁰ Nëpërmjet pyetësorit nr. ***.

paguhej nga përfituesi i shumës së shpërblimit, atëherë është logjike që të mendohet që kjo shumë duhet të jetë paguar nga dhënësi i shumës, në këtë rast punëdhënësi/kontraktori etj. Por, mbetet si parim i përgjithshëm që asokohe është çmuar që shoqatat përjashtoheshin nga të tilla detyrime.

26.12 Gjithashtu konstatohet se me përgjigjet e dhëna subjekti ka referuar deklaratimet e bëra më parë prej tij në ILDKPKI mbi krijimin e këtyre të ardhurave, si dhe ka depozituar dokumentacion voluminoz, nëpërmjet të cilit pretendon të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre.

26.13 Komisioni konstaton se në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklaram pasurie, e vitit 2003, si dhe në deklaratat pasardhëse të interesave privatë të viteve 2004 – 2010 (vit në të cilin janë tërhequr vlerat e depozitave të evidentuara më sipër), subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur ka deklaruar të ardhura të përfituara nga personi i lidhur si rezultat i punës së kryer për fondacionin “***”, si dhe nga projekte, përkthime, ekspertiza etj., të kryera/realizuara prej saj për palë të treta. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ai dhe bashkëshortja kanë përfituar të ardhura nga puna për organizata jofitimprurëse apo projekte, përkthime, ekspertiza etj., të kryera/realizuara për palë të treta për periudhën para vitit 2003.

26.14 Nga ana tjetër, rezultoi se në total shuma e tërhequr nga llogaritë e sipërcituara është 112,000 euro, ndërkohë që pagesa e kryer në favor të shitësit të pasurisë objekt vlerësimi është në shumën 117,000 euro (ekuivalenti i vlerës 15,990,000 lekë).

➤ **Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës 5,000 euro, e cila duket se ka shërbyer si pagesë për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.**

26.15 I pyetur nga Komisioni, duke i kërkuar të deklarojë burimin e krijimit të shumës 5,000 euro, pjesë e vlerës së paguar për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi²¹, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *nuk e kujton këtë lloj pagese, ndonëse nuk e kundërshton. Mendon që, nisur nga periudha e largët që ka kaluar, derisa të sqarohet përfundimisht gjendjen financiare të atyre viteve, këto duhet të jenë para që kanë qenë në gjendje cash (dhe që mund të kenë buruar nga shuma që ishte trashëguar nga babai H.M dy vjet më parë ose mund të kenë buruar nga kursime familjare). Por, nuk mund të shprehet me siguri të plotë. Gjithsesi, mundësia për ta paguar këtë vlerë është e dukshme, nisur nga të ardhurat vjetore të deklaruara.*

26.16 Verifikimi dhe analizimi i kronologjisë së deklaramit dhe krijimit të llogarive bankare në ISP Bank, ProCredit Bank dhe BKT, vlerat e tërhequra nga të cilat janë deklaruar si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi

Depozitë në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 48,000 euro

26.16.1 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga ISP Bank²², Komisioni konstaton se në datën 28.3.2002 në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit në valutën euro (llogaria nr. ***) është kredituar shuma 2,300 euro. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie konstatohet se kjo llogari gjatë vitit 2002 është shtuar me vlerën 8,100 euro²³ me kreditim dhe 97 euro²⁴ nga interesat. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2002 (datë 31.12.2002) ka qenë në vlerën 10,497 euro. Gjatë vitit 2003 rezultoi se në këtë llogari është kredituar në total shuma

²¹ Nëpërmjet pyetësorit nr. ***.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 9.5.2023, e Intesa Sanpaolo Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.5.2023.

²³ Deri në datën 30.6.2002, shuma 3,500 euro; deri në datën 30.9.2002, shuma 2,600 euro; deri në datën 30.12.2002, shuma 2,000 euro (totali i shtuar 8,100 euro).

²⁴ Deri në datën 30.6.2002, shuma 14 euro; deri në datën 30.9.2002, shuma 36 euro; deri në datën 30.12.2002, shuma 47 euro.

10,000 euro²⁵ dhe janë përfituar 219 euro nga interesat²⁶. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2003 ka qenë në vlerën 20,716 euro.

26.16.2 Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, e vitit 2003 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.3.2004), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Depozitë kursimi nr. *** në Bankën Amerikane të Shqipërisë, në emër të V.M ose/dhe Elio Mazreku, me vlerë 22,000 euro, me burim të holla të mbledhura nga rrogat, përkthimet, puna për hartim të raporteve e studimeve prej tij dhe bashkëshortes (për OJQ dhe fondacione të ndryshme)*”.

➤ **Komisioni konstaton se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë për gjendjen e llogarisë depozitë në Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot ISP Bank) në fund të vitit 2003.**

26.16.3 Gjatë vitit 2004, në këtë llogari është kredituar në total shuma 10,475 euro²⁷, si dhe janë përfituar interesat në shumën 424 euro²⁸. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2004 ka qenë në vlerën 31,615 euro.

26.16.4 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2004, në seksionin e pasurive, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Depozitë kursimi në Bankën Amerikane të Shqipërisë, V dhe Elio Mazreku, shuma 9,600 euro, data e krijimit 28.3.2002*”.

➤ **Komisioni konstaton se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë për shtesën e krijuar gjatë vitit 2004 në llogarinë depozitë në Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot ISP Bank).**

26.16.5 Gjatë vitit 2005, në këtë llogari është kredituar në total shuma 11,185 euro²⁹, si dhe janë përfituar 700 euro nga interesat³⁰. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2005 ka qenë në vlerën 43,500 euro.

26.16.6 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2005, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “*Shuma 9,870 euro në llogarinë bankare nr. *** në Bankën Amerikane janë derdhur gjithsej të ardhurat vjetore*”.

➤ **Komisioni konstaton se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë për shtesën e krijuar gjatë vitit 2005 në llogarinë depozitë në Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot ISP Bank).**

26.16.7 Përgjatë viteve 2006 – 2010, subjekti i rivlerësimit ka përfituar interesa bankarë nga kjo llogari depozitë, konkretisht: (i) për vitin 2006, shumën 978 euro; (ii) për vitin 2007, shumën 1,263 euro; (iii) për vitin 2008, shumën 1,081 euro; (iv) për vitin 2009, shumën 909 euro; (v) për vitin 2010, për periudhën janar – qershor 2010, shumën 471 euro.

²⁵ Deri në datën 30.1.2003, shuma 500 euro; deri në datën 28.2.2003, shuma 600 euro; deri në datën 31.3.2003, shuma 800 euro; deri në datën 30.5.2003, shuma 1,500 euro; deri në datën 30.6.2003, shuma 600 euro; deri në datën 30.9.2003, shuma 2,600 euro; deri në datën 2.12.2003, shuma 3,400 euro (totali i shtuar 10,000 euro).

²⁶ Shuma 219 euro, e kredituar nga interesat e depozitës gjatë vitit 2003.

²⁷ Deri në datën 5.1.2004, shuma 1,700 euro; deri në datën 5.2.2004, shuma 1,315 euro; deri në datën 5.3.2004, shuma 760 euro; deri në datën 5.4.2004, shuma 600 euro; deri në datën 5.5.2004, shuma 850 euro; deri në datën 7.6.2004, shuma 1,500 euro; deri në datën 9.8.2004, shuma 1,000 euro; deri në datën 9.9.2004, shuma 1,000 euro; deri në datën 11.10.2004, shuma 1,150 euro; në datën 12.11.2004 depozitë *cash* 800 euro; në datën 14.12.2004 depozitë *cash* 800 euro (totali i shtuar 10,475 euro).

²⁸ Shuma 424 euro, kredituar nga interesat e depozitës gjatë vitit 2004.

²⁹ (i) Në datën 14.1.2005, subjekti depoziton *cash* vlerën 800 euro; (ii) në datën 14.2.2005, subjekti depoziton *cash* vlerën 800 euro; (iii) në datën 15.3.2005, subjekti depoziton *cash* vlerën 800 euro; (iv) në datën 15.4.2005, subjekti depoziton *cash* vlerën 800 euro; (v) në datën 16.5.2005, subjekti depoziton *cash* vlerën 800 euro; (vi) në datën 16.6.2005, subjekti depoziton *cash* vlerën 850 euro; (vii) në datën 18.7.2005, subjekti depoziton *cash* vlerën 1,000 euro; (viii) në datën 18.8.2005, subjekti depoziton *cash* vlerën 1,620 euro; (ix) në datën 19.9.2005, subjekti depoziton *cash* vlerën 800 euro; (x) në datën 20.10.2005 depoziton *cash* shumën 800 euro; (xi) në datën 21.11.2005, subjekti depoziton *cash* shumën 800 euro; (xii) në datën 21.12.2005, subjekti depoziton *cash* shumën 1,315 euro.

³⁰ Shuma 700 euro, kredituar nga interesat e depozitës gjatë vitit 2005.

26.16.8 Pas përfitimit të këtyre interesave bankarë, gjendja e kësaj llogarie depozitë në datën 2.7.2010 ka qenë në shumën 48,202 euro. Rezulton se në datën 2.7.2010 personi i lidhur ka tërhequr nga kjo llogari shumën 48,000 euro, me përshkrimin “V.M, blerje shtëpie”.

26.16.9 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2010, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “Llogaria në Intesa Sanpaolo Bank ka pësuar pakësime (për shkak të tërheqjes së shumës 48,000 euro, që u përdor për blerjen e apartamentit)”.

Depozitë në ProCredit Bank, në shumën 24,417 euro

26.16.10 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga ProCredit Bank³¹, Komisioni konstaton se në datën 11.1.2008 subjekti dhe personi i lidhur kanë hapur llogarinë bashkëmërore me nr. ***, në monedhën euro. Rezulton se gjatë vitit 2008 në këtë llogari janë kryer 14 depozitime *cash* në vlerën totale 23,199 euro³². Pra, gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2008 ka qenë në shumën 23,199 euro.

26.16.11 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2008, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “Depozitë kursimi në ProCredit Bank, krijuar më 11.1.2008, burimi i krijimit të ardhura nga bashkëshortja – paga, shpërblime, honorare dhe kursime, shuma 23,199 euro”.

26.16.12 Pas përfitimit të interesave bankarë për vitin 2009 (shuma 304 euro) dhe shtesave të vlerave monetare të kryera në këtë llogari për vitin 2010 – nëpërmjet dy kreditimeve të bëra për periudhën janar – qershor të vitit 2010 (në total shuma 914 euro) – në datën 2.7.2010, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 24,417 euro. Konfirmohet se në datën 2.7.2010 shuma 24,417 euro është tërhequr *cash* nga subjekti i rivlerësimit, me përshkrimin “Tërheq Elio Mazreku me lajmërim”.

26.16.13 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2010, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “Llogaria në ProCredit Bank është tërhequr e tëra shuma 24,417 euro dhe nuk ekziston më (shuma u përdor për blerjen e apartamentit)”.

Llogari bankare në BKT, në shumën 39,517 euro

26.16.14 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga BKT-ja³³, Komisioni konstaton se në datën 27.1.2006 subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë hapur llogarinë bashkëmërore me nr. ***, në monedhën euro. Rezulton se gjatë vitit 2006 në këtë llogari janë kryer 13 depozitime *cash*³⁴ në vlerën totale 16,300 euro. Pra, gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2006 ka qenë në shumën 16,300 euro.

26.16.15 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2006, në seksionin e pasurive, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: (i) depozitë bankare nr. ***, në euro, me afat 1-mujor në Bankën Kombëtare Tregtare, hapur në datën 27.1.2006 prej tij dhe bashkëshortes, në shumën 16,300

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e ProCredit Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.9.2017.

³² (i) Në datën 11.1.2008 depozitohet *cash* vlera 1,500 euro; (ii) në datën 11.2.2008 depozitohet *cash* vlera 730 euro; (iii) në datën 18.3.2008 depozitohet *cash* vlera 800 euro; (iv) në datën 16.4.2008 depozitohet *cash* vlera 850 euro; (v) në datën 8.5.2008 depozitohet *cash* vlera 2,000 euro; (vi) në datën 19.5.2008 depozitohet *cash* vlera 980 euro; (vii) në datën 27.5.2008 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (viii) në datën 10.6.2008 depozitohet *cash* vlera 450 euro; (ix) në datën 24.6.2008 depozitohet *cash* vlera 800 euro; (x) në datën 10.7.2008 depozitohet *cash* vlera 1,469 euro; (xi) në datën 25.8.2008 depozitohet *cash* vlera 800 euro; (xii) në datën 1.9.2008 depozitohet *cash* vlera 6,300 euro; (xiii) në datën 3.9.2008 depozitohet *cash* vlera 4,700 euro; (xiv) në datën 10.11.2008 depozitohet *cash* vlera 820 euro.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2020, e BKT-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.9.2017.

³⁴ (i) Në datën 27.1.2006 depozitohet *cash* vlera 800 euro; (ii) në datën 23.2.2006 depozitohet *cash* vlera 900 euro; (iii) në datën 20.3.2006 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (iv) në datën 4.4.2006 depozitohet *cash* vlera 800 euro; (v) në datën 5.5.2006 depozitohet *cash* vlera 800 euro; (vi) në datën 31.5.2006 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (vii) në datën 4.7.2006 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (viii) në datën 10.8.2006 depozitohet *cash* vlera 4,000 euro; (ix) në datën 11.9.2006 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (x) në datën 5.10.2006 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (xi) në datën 8.11.2006 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (xii) në datën 5.12.2006 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (xiii) në datën 28.12.2006 depozitohet *cash* vlera 2,000 euro.

euro + interesi 68 euro; (ii) vlerën 400,000 lekë, që ruhej *cash* në banesë dhe është derdhur në BKT rreth 3,300 euro.

26.16.16 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2007, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar se depozita bankare në BKT, në shumën 16,300 euro, përfshin edhe shumën 3,300 euro, që i përgjigjet shumës 400,000 lekë, të cilat i kishte *cash* në banesë nga mbyllja e llogarisë së kursimit në Bankën e Kursimeve (Raiffeisen Bank).

26.16.17 Referuar deklaramit të bërë, si dhe pas verifikimit të dokumentacionit bankar, duket se si burim për krijimin e vlerës 16,300 euro, gjendje në llogari bankare në BKT në datën 31.12.2006, ka shërbyer edhe pakësimi i gjendjes së likuiditeteve *cash* të deklaruara më parë, në shumën 400,000 lekë. Pra, duket se edhe shuma 3,300 euro, e deklaruar si derdhje në BKT, është pjesë e vlerës 16,300 euro, gjendje në datën 31.12.2006 në llogari bankare në këtë bankë.

26.16.18 Në vijim të verifikimit të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara nga subjekti në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) në deklaratën fillestare të pasurisë subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash*; (ii) në DIPP-në e vitit 2004, në seksionin e pasurive, ka deklaruar shumën 400,000 lekë, të tërhequr nga llogaria depozitë kursimi në Bankën e Kursimeve në emër të z. Elio Mazreku dhe znj. B.P (llogari e mbyllur); (iii) në DIPP-në e vitit 2005, subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësime likuiditetesh *cash*.

26.16.19 Komisioni konstaton se në deklaratën fillestare të pasurisë, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar *depozitë kursimi në Bankën e Kursimeve, Arka nr. ***, Tiranë, me afat, nr. ***, në emrin Elio Mazreku dhe B.P, datë 25.11.1996, me vlerë 0.4 milionë lekë*. Si burim krijimi ka deklaruar: të holla të mbledhura ose të sjella prej vëllait nga emigracioni dhe gjatë kohës kur punonte në Shqipëri.

26.16.20 Raiffeisen Bank³⁵ konfirmon se subjekti i rivlerësimi ka pasur një depozitë të mbartur nga ish-Banka e Kursimeve, me gjendje në datën 30.9.2004 në vlerën 440,335 lekë. Rezulton se në datën 16.12.2004 subjekti ka tërhequr shumën prej 444,625 lekësh nga kjo llogari.

26.16.21 Në vijim të verifikimit të dokumentacionit bankar, Komisioni konstaton se gjatë vitit 2007 në llogarinë bashkëmërore të subjektit dhe personit të lidhur në BKT janë kryer 16 depozitime *cash*³⁶ në vlerën totale 20,040 euro, e cila rezulton se është bashkuar me fondet e mëparshme të disponuara në këtë llogari depozitë.

26.16.22 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2007, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në euro me afat 1-mujor në BKT, nr. ***, hapur prej tij dhe bashkëshortes në datën 27.1.2006, në shumën 20,452 euro.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020.

³⁶ (i) Në datën 1.2.2007 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (ii) në datën 12.4.2007 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (iii) në datën 2.5.2007 depozitohet *cash* vlera 1,300 euro; (iv) në datën 10.5.2007 depozitohet *cash* vlera 750 euro; (v) në datën 22.5.2007 depozitohet *cash* vlera 700 euro; (vi) në datën 28.5.2007 depozitohet *cash* vlera 800 euro; (vii) në datën 28.6.2007 depozitohet *cash* vlera 1,200 euro; (viii) në datën 25.7.2007 depozitohet *cash* vlera 800 euro (V. M.); (ix) në datën 10.8.2007, depozitohet *cash* vlera 955 euro; (x) në datën 10.9.2007 depozitohet *cash* shuma 1,945 euro; (xi) në datën 1.11.2007 depozitohet *cash* vlera 1,000 euro; (xii) në datën 22.11.2007 depozitohet *cash* vlera 680 euro. Shuma totale e depozituar deri në datën 22.11.2007 prej 12,130 euro, së bashku me shumën 16,300 euro të vitit 2006 dhe shumën 583 euro të përfutur nga interesat e akumuluar, janë investuar në depozitë me afat – vlera totale e depozitës në shumën 29,013 euro; (xiii) në datën 5.12.2007 depozitohet *cash* vlera 5,800 euro; (ixv) në datën 14.12.2007 depozitohet *cash* vlera 800 euro; (xv) në datën 21.12.2007 depozitohet *cash* vlera 510 euro; (xvi) në datën 28.12.2007 depozitohet *cash* vlera 800 euro. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2007, në vlerën 36,923 euro.

26.16.23 Pas investimeve të kryera në vijimësi të fondeve të kësaj depozite konstatohet se për vitet 2007 – 2010 janë përfituar interesa në total në shumën 3,177 euro³⁷.

26.16.24 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2010, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “*Llogaria në Bankën Kombëtare Tregtare është tërhequr shuma 39,517 euro dhe nuk ekziston më që nga data 2.7.2010 (shuma e përdorur për të blerë apartamentin)*”.

26.16.25 Konfirmohet se në datën 2.7.2010 personi i lidhur ka tërhequr *cash* të gjithë shumën e kësaj depozite, në vlerën totale 39,517 euro, me përshkrimin “V.M mbyllje depozite 1-mujore”.

26.16.26 Nga sa u parashtrua më sipër – bazuar në dokumentacionin shkresor bankar – rezulton se në datën 2.7.2010 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë tërhequr nga llogaritë e tyre bankare në total shumën 111,934 euro, konkretisht: (i) 48,000 euro nga Intesa Sanpaolo Bank; (ii) 24,417 euro nga ProCredit Bank; (iii) 39,517 euro nga BKT.

26.16.27 Nga ana tjetër, siç u evidentua edhe më sipër, rezulton se po në datën 2.7.2010 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e shtetasit F.V (shitësi i pasurisë objekt vlerësimi) shumën 112,000 euro, me përshkrimin “Elio Mazreku për blerje apartamenti kontratë rep. *** kol. ***”.

26.16.28 Bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, si burim për krijimin e fondeve në këto tri depozita bankare, tërheqja e të cilave duket se ka shërbyer për pagesën në datën 2.7.2010 të këstit të parë për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, në shumën 112,000 euro, si dhe të shumës 5,000 euro të paguar në datën 5.7.2010 si këst i dytë dhe i fundit i shlyerjes së çmimit të kësaj pasurie, kanë shërbyer: (a) të ardhurat e personit të lidhur si rezultat i punësimit në organizata jofitimprurëse; (b) të ardhurat e personit të lidhur nga veprimtari të tjera të kryera për palë të treta, si përkthime, konsulenca, ekspertiza etj., kryesisht në sektorin e OJF-ve; (c) të ardhura të tjera familjare.

26.16.29 Gjithsesi, duket se si burime kryesore të krijimit të vlerave monetare të evidentuara në llogaritë bankare të analizuara si më sipër janë deklaruar të ardhurat nga puna dhe veprimtaria e personit të lidhur për organizata jofitimprurëse dhe ente të tjera, prej angazhimit në projekte të ndryshme, kryesisht në sektorin e OJF-ve.

26.16.30 Komisioni verifikoi dhe analizoi në mënyrë të detajuar të gjitha burimet e të ardhurave të deklaruara prej subjektit/personit të lidhur, të krijuara si rezultat i punësimit dhe/apo i shërbimeve të kryera nga personi i lidhur për OJF të ndryshme, organizata ndërkombëtare apo ente të tjera.

26.17 Të ardhurat e personit të lidhur nga puna në OJF

Të ardhura nga punësimi në shoqatën “*”, për periudhën 1996 – 1999***

26.17.1 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura gjatë punës trevjeçare në OJF-në “****”, afërsisht në shumën 400,000 lekë. Konstatohet se bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) dokumentin “Aktmarrëveshje”, shkresë e thjeshtë, e datës 13.11.1996, lidhur mes përfaqësuesit të shoqatës “****” dhe përfaqësuesit të Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore; (ii) vërtetimin nr. *** prot., datë 25.4.2008, lëshuar nga DRSSH Tiranë, në referim të të cilit konfirmohet se znj. V.Sh (M) ka qenë e siguruar pranë subjektit “****” për periudhën mars 1996 – dhjetor 1999.

26.17.2 Bazuar në vërtetimin e DRSSH-së Tiranë dhe në dokumentet e tjera të depozituara nga subjekti, të cilat referojnë derdhjen e kontributeve nga shoqata “****” në favor të personit të lidhur, që i përgjigjen pagës minimale për periudhën mars 1996 – dhjetor 1999, si dhe në

³⁷ (i) Për vitin 2007, kredituar 583 euro nga interesat; (ii) për vitin 2008, kredituar 83 euro nga interesat; (iii) për vitin 2010, shuma 2,511 euro.

dokumentin mandatarkëtim i kontributeve për periudhën 1998 – 1999, rezulton se të ardhurat neto të përfituara nga personi i lidhur si rezultat i punësimit në këtë shoqatë kanë qenë në total në shumën 353,000 lekë³⁸.

Të ardhurat nga punësimi në fondacionin “*”***

26.17.3 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga si drejtuese e fondacionit “****” (Zyra Shqiptare, sot *** Shqipëri, NIPT ***), në total vlerat monetare: 18,627 marka gjermane, 85,105 euro, 4,533,350 lekë.

Të ardhurat për periudhën 2000 – 2001

26.17.4 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur mbi burimin e krijimit të depozitave, vlerat e të cilave kanë shërbyer për pagesën e kryer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit në Tiranë, sa i përket të ardhurave të përfituara nga puna në fondacionin “****”, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Në fillim të vitit 2000, kur ai dhe V (bashkëshortja) ishin të lidhur, por jo të martuar, ajo mori vesh që fondacioni “****” *** donte të hapte një degë në Shqipëri. Të tilla degë ishin hapur ose do të hapeshin në tërë vendet e lindjes. Ajo aplikoi, u intervistua dhe u përzgjedh si fituese. Pra, la punën tek “****” dhe nisi punën e re në degën e këtij fondacioni në Shqipëri. Puna duhet të ketë nisur më 1 prill 2000... Zyra lokale e *** në Tiranë ka nisur punën në atë zyrë në datën 1 maj 2000”.*

26.17.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, pjesë e dokumentacionit të depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, dokumentacionit të depozituar më parë në ILDKPKI, si dhe atij të depozituar gjatë hetimit administrativ të kryer, Komisioni konstaton se:

26.17.5.1 Në datën 28.4.2000 duket se është lidhur marrëveshja për marrjen me qira³⁹ nga ana e fondacionit “****” (e përfaqësuar nga personi i lidhur) të një apartamenti 2+1 të ndodhur në Tiranë, kundrejt pagesës mujore 440 DEM (deutsch marka) dhe 100 USD, me synim përdorimin për zyrë pa qëllime përfitimi, marrëveshje e cila hyn në fuqi në datën 1.5.2000.

26.17.5.2 Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull *“Work Plan, June – December 2000”*, duket se për periudhën qershor – dhjetor të vitit 2000 është përcaktuar një plan pune me detyra të përcaktuara për personin e lidhur, si përfaqësuese e degës së fondacionit “****” në Tiranë, Shqipëri.

26.17.5.3 Gjithashtu, referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull *“P.D.A.M.C 1999/2001”*, duket se fondacioni “****” ka pasur një plan buxheti për periudhën 1999 – 2001, në të cilën, ndër të tjera, është parashikuar se fondi për pagesën e punonjësit në Shqipëri (konsulentit) do të ishte 7,455 DEM/6-mujor.

26.17.5.4 Referuar dokumentit *“Librezë pune”*, duket se personi i lidhur ka filluar punë në fondacionin “****” në datën 1.3.2000, në pozicionin e menaxheres së përgjithshme.

26.17.5.5 Në datën 1.3.2001, bazuar në kërkesën e bërë nga znj. V.Sh (M), në cilësinë e përfaqësueses së fondacionit “****”, Tiranë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit⁴⁰ ka vendosur të miratojë kërkesën për çeljen e zyrës lokale të “****”.

³⁸ Vlera që rezulton e përfituar si e ardhur nga paga neto – në përputhje me detyrimet e paguara për sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

³⁹ Referojuni dokumentit shkresë e thjeshtë *“Marrëveshje për dhënie apartamenti me qira”*, datë 28.4.2000, depozituar nga subjekti, por i cili duket se nuk është nënshkruar nga palët.

⁴⁰ Referojuni dokumentit *“Shkresë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”* nr. *** prot., datë 1.3.2001.

26.17.6 Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, sa i përket të ardhurave të përfituara nga puna në fondacionin “****” personi i lidhur ka deklaruar specifikisht se pagesa fillimisht bëhej me monedhë holandeze (guilder), që konvertohej në marka gjermane, në total përfituar shuma 18,627 DEM, e cila duket se përfaqëson buxhetin e pagës për një periudhë 15-mujore për konsulentin në Shqipëri, në referim të projektbuxhetit të sipërcituar⁴¹.

26.17.7 Sa më sipër, në kushtet kur sipas dokumentit “Librezë pune” personi i lidhur ka filluar punë në fondacionin “****” në datën 1.3.2000, si dhe për sa kohë dokumenti “Projektbuxhet” referon të dhëna financiare për periudhën 1999 – 2001, duket se shuma e të ardhurave të pretenduara dhe të deklaruara në vlerën 18,627 marka gjermane (ekuivalenti i shumës prej rreth 1,179,000 lekësh) përfaqëson të ardhura të përfituara nga puna e personit të lidhur për periudhën 1.3.2000 – 31.12.2001.

Të ardhurat për periudhën 1.5.2002 – 30.4.2005

26.17.8 Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Agreement”, duket se mes personit të lidhur dhe fondacionit “****” në mars të vitit 2003 është nënshkruar një marrëveshje e vlefshme për periudhën 1.5.2002 – 30.4.2005, në të cilën përcaktohet se për punën e kryer nga personi i lidhur në pozicionin e përfaqësueses lokale të fondacionit “****” në Shqipëri do të ketë si pagesë për harkun kohor 1.5.2002 – 30.10.2002 shumën 511 euro/muaj dhe për periudhën 1.11.2002 – 31.12.2003 shumën 600 euro/muaj. Ndërsa, për vitet 2004 dhe 2005 do të aplikohet përkatësisht nga 5% rritje në vit (630 euro/muaj për vitin 2004 dhe 660 euro/muaj për vitin 2005).

26.17.9 Bazuar në të dhënat e pasqyruara në dokumentin e sipërcituar, duket se për periudhën 1.5.2002 – 30.4.2005 personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer në fondacionin “****”, në total shumën prej 22,026 euro.

Të ardhurat për periudhën 1.5.2005 – 31.12.2006

26.17.10 Në vijim të verifikimit të dokumenteve të depozituara nga subjekti, referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Agreement”, duket se mes personit të lidhur dhe fondacionit “****” në dhjetor të vitit 2005 është nënshkruar një marrëveshje⁴² e vlefshme për periudhën 1.5.2005 – 31.12.2006, në të cilën përcaktohet se për punën e kryer nga personi i lidhur në pozicionin e përfaqësueses lokale të fondacionit “****” në Shqipëri do të ketë si pagesë vlerën 725 euro/muaj.

26.17.11 Bazuar në të dhënat e pasqyruara në dokumentin e sipërcituar, duket se për periudhën 1.5.2005 – 31.12.2006 personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer në fondacionin “****”, në total shumën prej 14,500 euro.

Të ardhurat për periudhën 1.4.2007 – 31.12.2007

26.17.12 Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Framework Agreement” duket se mes personit të lidhur dhe fondacionit “****” në datën 3.4.2007 është lidhur një marrëveshje tjetër, që përfshin periudhën e punësimit, nga data 1.4.2007 deri më 31.12.2007, në të cilën nuk përcaktohet ndonjë ndryshim në aspektin e trajtimit financiar të personit të lidhur. Pra, duket se edhe për këtë periudhë është paguar me 725 euro/muaj.

26.17.13 Bazuar në të dhënat e pasqyruara në dokumentin e sipërcituar, duket se për periudhën 1.4.2007 – 31.12.2007 personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer në fondacionin “****”, në total shumën prej 6,525 euro.

⁴¹ Shuma 7,455 DEM * 2.5 = 18,627 DEM.

⁴² Shkresë në gjuhën angleze me titull “Agreement”, paraqitur në përgjigje në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi nr. ***.

Të ardhurat për periudhën 1.4.2008 – 31.12.2010

26.17.14 Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Framework Agreement”, duket se mes personit të lidhur dhe fondacionit “***” në datën 1.1.2008 është lidhur një marrëveshje tjetër, që përfshin periudhën e punësimit, nga data 1.4.2008 deri më 31.12.2010, në të cilën përcaktohet se për punën e kryer nga personi i lidhur në pozicionin e përfaqësueses lokale të fondacionit “***” në Shqipëri për periudhën 1.4.2008 – 31.12.2008 do të paguhej në shumën 800 euro/muaj, ndërsa për periudhën 1.1.2009 – 31.12.2010 do të paguhej në shumën 1,000 euro/muaj.

26.17.15 Bazuar në të dhënat e pasqyruara në dokumentin e sipërcituar, duket se për periudhën prill 2008 – qershor 2010, pra para kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer në fondacionin “***”, në total shumën prej 25,200 euro.

26.17.16 Sa më sipër, bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e depozituar në mbështetje të tyre, subjekti pretendon se për periudhën para kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, krahas të ardhurave në marka gjermane ka përfituar të ardhura në valutë nga puna për fondacionin “***”, në total shumën prej 68,251 euro.

26.17.17 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit bankar të administruar në dosje rezulton se prej datës 31.12.2001 deri më 25.1.2010 personi i lidhur ka pasur aktive dy llogari personale në monedhën euro pranë Intesa Sanpaolo Bank (ish-BIA Bank), në të cilat janë evidentuar transaksione të fondeve në mbërritje dhe tërheqje/pagesa në shuma të konsiderueshme. Më konkretisht, rezultojnë fonde në mbërritje me dërgues në dukje “***”, në total shuma 623,000 euro, nga të cilat shuma 594,000 euro debitohet nga kjo llogari nëpërmjet tërheqjeve *cash* dhe transfertave të ndryshme “për pagesa”, ndërsa pjesa tjetër e mbetur në shumën prej rreth 29,000 euro transferohet në llogarinë e fondacionit “***”, në datën e mbylljes së llogarisë së mbetur aktive, 25.1.2010.

26.17.18 Të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur, veprimet e kryera në këto llogari bankare të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

Periudha	Kreditime (euro)	Debitime (euro)	Gjendje në fund (euro)
31.12.2001	1,457		1,457
2002	65,000	44,380	22,077
2003	40,000	51,649	10,428
2004	80,000	89,055	1,373
2005	70,000	55,314	16,059
2006	100,000	105,286	10,773
2007	30,410	40,377	806
2008	93,795	92,267	2,334
2009	143,439	113,086	32,687
25.1.2010		3,002	29,685
Totali	€ 624,101	€ 594,416	€ 29,685.00

➤ **Komisioni konstaton se personi i lidhur, në cilësinë e personit që mbart detyrimin për deklarimin e pasurive dhe interesave privatë, nuk ka deklaruar gjendjet e këtyre llogarive bankare personale në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë të depozituara në ILDKPKI dhe/apo shtesat/pakësimet e tyre gjatë viteve.**

26.17.19 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni mbi mosdeklarimin e këtyre dy llogarive personale të personit të lidhur, si dhe mbi burimin dhe destinacionin e fondeve të evidentuara në këto llogari, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: “...Tërë derdhjet dhe tërheqjet e këtyre llogarive, hyrje-daljet e shumave kanë qenë të gjitha nga dhe për llogari që nuk lidhen fare me jetën vetjake të V.M (bashkëshortes) dhe as me bashkëjetesën me të. Llogaritë tregojnë që ka transferta bankare me persona/subjekte me të cilët e ka pas lidhur vetëm puna në degën e fondacionit “*** ” ose drejtuese e OJF-së “***” në Shqipëri. Pra, nuk kishim se si të deklaronim llogaritë e punës sikur të ishin private. Arsyeja se përse këto llogari nuk mund të regjistroheshin në bankë në emër të “***” ishte sepse forma e zgjedhur për ekzistencën e kësaj OJF-je nga fondacioni i huaj ishte degë e fondacionit në Shqipëri. Pra, asokohe dega nuk kishte regjistrim në gjykatë, nuk kishte regjistrim në asnjë vend tjetër, por vetëm ishte lejuar nga autoriteti shtetëror përkatës (në këtë rast i fushës mjedisore) që të ushtronte veprimtarinë. Për rrjedhojë, bankat nuk pranonin të çelnin llogari në emër të kësaj dege. Në bankat shqiptare është pranuar gjithmonë hapja e të tilla llogarive për subjektet që kanë pasur regjistrim në gjykatë dhe, më pas, në tatime. Kur fondacioni “***” ndërpreu financimet dhe mbulimin e projekteve nëpër vende të tjera, degët nëpër vendet e ndryshme ku funksiononin u nxitën që të regjistroheshin më vite. Ka qenë kjo fillesa e OJF-së “***” Shqipëri, që u regjistrua në gjykatë, në drejtorinë tatimore dhe në zyrat përkatëse shtetërore, me NIPT-in e vet, duke përfshirë këtu edhe çeljen e llogarive bankare në emër të kësaj OJF-je (sërish me drejtuese/titullare të llogarive V.M)...”.

26.17.20 Në shqyrtim dhe analizë përfundimtare të lëvizjeve të kësaj llogarie në raport me shpjegimet e dhëna nga subjekti, trupi gjykues krijoi bindjen se kemi të bëjmë me një llogari ku kryheshin transaksione në emër dhe për fondacionin “***”, nga përfaqësuesja e këtij fondacioni në Shqipëri, bashkëshortja e subjektit, znj. V.M.

26.17.21 Nga ana tjetër, në vlerësim të të dhënave të evidentuara si më sipër, Komisioni konstaton se totali i të ardhurave të pretenduara nga personi i lidhur si të përfituara nga puna e kryer në fondacionin “***” për periudhën 2002 – 2009 përbën rreth 9% të të ardhurave totale të kredituara në llogaritë bankare të personit të lidhur për këtë periudhë.

26.17.22 Në vijim të verifikimit të llogarive bankare të personit të lidhur, Komisioni konstaton se në llogarinë në monedhën euro pranë Intesa Sanpaolo Bank, për periudhën korrik – dhjetor 2010 është kredituar shuma 5,001 euro⁴³, në dukje me përshkrim nga pagat e transferuara nga fondacioni “***”.

26.17.23 Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Agreement”, duket se mes personit të lidhur dhe fondacionit “***” në datën 28.7.2011 është lidhur një marrëveshje tjetër, që përfshin periudhën e punësimit në formë provizore nga data 1.8.2011 deri më 31.10.2011, në të cilën përcaktohet trajtimi financiar i personit të lidhur në shumën totale 2,016 euro. Bazuar në të dhënat e pasqyruara në dokumentin e sipërcituar, duket se: (i) brenda periudhës 10-ditore pas lidhjes së kontratës do të paguhej shuma 1,000 euro; (ii) deri në datën 8.10.2011 do të paguhej shuma 700 euro; (iii) deri në datën 8.11.2011 do të paguhej shuma 316 euro.

⁴³ (i) Në datën 19.7.2010 kreditohet vlera 834 euro, me përshkrimin “With check from fond. *** to V.M/paga qershor 2010”; (ii) në datën 18.8.2010 kreditohet vlera 834 euro, me përshkrimin “With check V.M/paga korrik *** to acc”; (iii) në datën 23.9.2010 kreditohet vlera 828 euro, me përshkrimin “With check V.M, pagesë rroga gusht 2010, nga ***”; (iv) në datën 7.10.2010 kreditohet vlera 831 euro, me përshkrimin “With check Fond. *** to V.M paga shtator 2010”; (v) në datën 15.11.2010 kreditohet vlera 832 euro, me përshkrimin “With check V.M, paga tetor 2010”; (vi) në datën 24.12.2010 kreditohet vlera 832 euro, me përshkrimin “With check V.M/paga nëntor 2010 from fond ***”.

26.17.24 Nga ana tjetër, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes së tij me burim rrogën dhe dietat nga puna si drejtuese e shoqatës “***”, në total shumën prej 3,600 euro.

26.17.25 Nga verifikimi i llogarive bankare konstatohet se në llogarinë në monedhën euro të personit të lidhur pranë Intesa Sanpaolo Bank gjatë vitit 2011 është kredituar shuma 1,446 euro⁴⁴, në dukje me përshkrim nga pagat e transferuara nga fondacioni “***”.

26.17.26 Bazuar në deklaratimet e bëra, si dhe në dokumentacionin e depozituar – pjesë e dosjes së hetimit administrativ – duket se për periudhën 2000 – 2011 personi i lidhur mund të ketë përfituar në total të ardhura nga puna e saj në fondacionin “***” vlerat monetare si vijon: (i) 18,627 marka gjermane (ekuivalenti i shumës prej rreth 1,179,000 lekësh); (ii) shumën rreth 76,000 euro, nga ku, siç u evidentua edhe më sipër, për periudhën para likuidimit të çmimit të pasurisë objekt vlerësimi vlerat e mundshme të të ardhurave të përfituara janë 18,627 marka gjermane dhe 68,251 euro.

Në analizë të të gjitha të dhënave të mësipërme, trupi gjykoës vëren se ekzistojnë *indicie dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për periudhën 2000 – 2011 ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme financiare me fondacionin “*” dhe se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer për këtë fondacion.***

26.17.27 Në vijim, gjatë hetimit administrativ Komisioni i kërkoi sërish subjektit të rivlerësimi të depozitave dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga puna e personit të lidhur në fondacionet, organizatat dhe/apo ente të tjera të ndryshme të referuara prej tij (të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar), si dhe të shpjegojë dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbi pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura⁴⁵.

26.17.28 Subjekti depozitoi dokumentacionin e përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar, që lidhet me të ardhurat e përfituara në monedhën euro me burim nga puna e personit të lidhur në fondacionin “***”, për periudhën 2002 – 2011. Ndërsa, sa i përket pagesës së detyrimit tatimor mbi to, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. ***, duke pretenduar se personi i lidhur nuk ka pasur detyrim për pagesën e detyrimit tatimor mbi këto të ardhura.

26.17.29 Paraprakisht Komisioni vlerësoi se, bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, duket se të ardhurat e referuara si të përfituara nga personi i lidhur në funksion të punës së kryer për fondacionin “***” janë të ardhura të tatueshme.

26.17.30 Për më tepër duket se nga verifikimi i marrëveshjeve/kontratave të lidhura mes bashkëshortes së subjektit dhe fondacionit “***”, në disa prej tyre parashikohet se pagesa e taksave dhe/ose detyrimeve për sigurimet shoqërore mbeten përgjegjësi e personit të lidhur. Ndërsa në pjesën tjetër nuk ka përcaktim mbi mbajtjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur.

⁴⁴ (i) Në datën 25.5.2011 kreditohet vlera 496 euro, me transfertë, me përshkrimin “*** transfert to V.M rrogë janar – prill 2011”; (ii) në datën 18.7.2011 kreditohet 337 euro, me transfertë, me përshkrimin “*** to V & Elio Mazreku rroga muajt maj - korrik 2011”; (iii) në datën 13.9.2011 kreditohet vlera 129 euro, me përshkrimin “*** fav V dhe Elio Mazreku rroga e muajt gusht 2011”; (iv) në datën 8.11.2011 kreditohet vlera 342 euro, me përshkrimin “Fond.*** fav V & Elio Mazreku si pagesë rroge tetor – nëntor 2011”; (v) në datën 27.12.2011 kreditohet vlera 142 euro, me përshkrimin “Fond.*** to V & Elio Mazreku rroga dhjetor + prapambetje shtator”.

⁴⁵ Nëpërmjet pyetësorit nr. ***.

➤ Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit, duke i kërkuar të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga bashkëshortja e tij prej punës së kryer në fondacionin “****” për periudhën 2000 – 2011. Gjithashtu, subjektivit iu kërkuar të paraqesë dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji (të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar) për përfitimin e të ardhurave në monedhën marka gjermane për periudhën 2000 – 2001.

26.17.31 Nga verifikimi i informacionit të dërguar nga DRT Tiranë⁴⁶ dhe ISSH⁴⁷ rezultoi se për periudhën janar 2012 e në vijim personi i lidhur figuron të jetë i regjistruar si punonjës i fondacionit “****”. Në analizën financiare paraprake janë pasqyruar dhe reflektuar të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur për punën e kryer në fondacionin “****”, bazuar në të dhënat e referuara në informacionin e dërguar nga DRT Tiranë dhe ISSH. Komisioni konstaton se përputhet vlera e deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* për shumën e përfituar nga personi i lidhur në monedhën lekë nga puna në fondacionin “****” me vlerën e evidentuar në shkresat e institucioneve të referuara si më sipër, për periudhën nga janari 2012 deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting*, në shumën prej rreth 4.5 milionë lekësh.

26.18 Të ardhurat e personit të lidhur nga veprimtari të tjera të kryera për palë të treta, si përkthime, konsulenca, ekspertiza etj., kryesisht në sektorin e OJF-ve

26.18.1 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* personi i lidhur ka deklaruar se ka përfituar të ardhura të ndryshme nga puna/shërbimet e kryera për palë të treta, konkretisht nga përkthimet, konsulencat, ekspertizat etj., kryesisht në sektorin e OJF-ve, ku përfshihen të ardhura të përfituara edhe për periudhën para likuidimit të çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, të evidentuara si më poshtë:

Të ardhura nga përkthime për fondacionin “*”, në total vlerat 2,531 USD, 10,559 euro dhe 73,682 lekë***

26.18.2 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie (deklarata fillestare e pasurisë e vitit 2003, dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.3.2004), në seksionin e të ardhurave, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhura nga përkthimet e realizuara që prej 7 vjetësh për OJF e fondacione të ndryshme dhe si eksperte në fushën e mjedisit, duke realizuar shërbime dhe raporte për projekte të ndryshme mjedisore, por nuk ka deklaruar shumën e përfituar, duke sqaruar se nuk mund ta përcaktojë saktësisht pasi këto të ardhura janë të shpërndara në vite dhe pa rregull; (ii) Në DIPP-në e vitit 2004 duket se subjekti ka deklaruar përfitimin e shumës prej rreth 500 euro nga personi i lidhur për përkthimet e realizuara në favor të fondacionit “****” + të tjera; (iii) Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara prej bashkëshortes nga përkthimet dhe shërbime për fondacione e forume të ndryshme (***, ***, F.R i OJQ-ve Krujë), në total shumat 201 USD dhe rreth 300 – 400 euro; (iv) Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga përkthime, shërbime, dieta (jashtë vendit) për shoqata, fondacione, forume etj. (***, ***, F.R i OJQ-ve Krujë, *** etj.), në total shumat 1,806 euro, 346 USD dhe 10,365 lekë; (v) Në DIPP-në e vitit 2007, ndër të tjera, ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga puna si eksperte apo përkthime për qendrën “****” dhe fondacioni “****”, në euro, USD dhe lekë, konkretisht shumat 3,361 euro, 586 USD dhe 16,605 lekë; (vi) Në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar të ardhura të përfituara prej bashkëshortes nga përkthimet për fondacionin “****”, shumën prej 2,024 euro; (vii) Në DIPP-në e vitit 2009 ka deklaruar të ardhura të përfituara prej bashkëshortes nga kryerja e shërbimeve

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2020, e DRT-së Tiranë, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.10.2020.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 10.9.2020, e ISSH-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.9.2020.

të përkthimit për fondacionin “****”, korrik 2009, në shumën prej 1,140 USD; (viii) Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar të ardhura të tjera të bashkëshortes nga kryerja e punëve të ndryshme, përkthime, trajnime etj., por pa përcaktuar subjektet nga janë përfituar këto të ardhura, si dhe vlerat përkatëse monetare të përfituara.

26.18.3 Në vijim të verifikimit të deklarimeve të bëra ndër vite në ILDKPKI, duket se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur kanë deklaruar përfitimin e të ardhurave si rezultat i punës së kryer nga personi i lidhur për fondacionin “****” edhe për periudhën 2011 – 2016.

26.18.4 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer me përkthime për fondacionin “****”, duket se: (i) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Declaration”, e datës 23.12.2004, personi i lidhur ka përfituar shumën 95 USD; (ii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Declaration”, e datës 10.6.2005, personi i lidhur ka përfituar shumën 46 USD; (iii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Declaration”, e datës 13.10.2006, personi i lidhur ka përfituar shumën 461 euro dhe 57 USD; (iv) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë e fondacionit “****”, e datës 26.12.2006, personi i lidhur ka përfituar shumën 229 USD; (v) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë e fondacionit “****”, e datës 15.11.2006, personi i lidhur ka përfituar shumën 10,365 lekë; (vi) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë e fondacionit “****”, e datës 17.12.2007, personi i lidhur ka përfituar shumën 16,605 lekë⁴⁸; (vii) Referuar 4 dokumenteve në gjuhë të huaj, shkresa të thjeshta të fondacionit “****”, që mbajnë datat 10.5.2007, 31.5.2007 dhe 13.7.2007, personi i lidhur ka përfituar shumën totale prej 586 USD⁴⁹; (viii) Referuar 6 dokumenteve në gjuhë të huaj, shkresa të thjeshta të fondacionit “****”, që mbajnë datat 31.5.2007, 13.7.2007, 7.9.2007, 21.11.2007 dhe 17.12.2007, personi i lidhur ka përfituar shumën totale prej 2,694 euro⁵⁰; (ix) Referuar 4 dokumenteve në gjuhë të huaj, shkresa të thjeshta të fondacionit “****”, që mbajnë datat 5.5.2008, 6.6.2008, 10.7.2008 dhe 4.9.2008, personi i lidhur ka përfituar shumën totale prej 2,129 euro; (x) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë e fondacionit “****”, e datës 16.7.2009, personi i lidhur ka përfituar shumën 1,440 USD; (xi) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë e fondacionit “****”, e datës 13.10.2010, personi i lidhur ka përfituar shumën 135 USD⁵¹; (xii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë mandatpagesë e fondacionit “****”, personi i lidhur për periudhën dhjetor 2010 ka përfituar shumën 277 euro; (xiii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë e fondacionit “****”, në periudhën qershor 2012, personi i lidhur ka përfituar shumën 557 euro; (xiv) Referuar tri dokumenteve në gjuhë të huaj, shkresa të thjeshta të fondacionit “****”, që mbajnë datat 17.4.2013, 28.6.2013 dhe 9.11.2013, personi i lidhur ka përfituar shumën totale prej 740 euro; (xv) Referuar katër dokumenteve në gjuhë të huaj, shkresa të thjeshta të fondacionit “****”, të periudhave shtator 2015, tetor 2015, nëntor 2015 dhe dhjetor 2015, personi i lidhur ka përfituar

⁴⁸ Gjithashtu, subjekti ka depozituar kopje të dokumentit mandat bankar, datë 3.1.2014, të Societe Generale Albania, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumën 46,712 lekë (fonde të fondacionit “****”).

⁴⁹ Gjithashtu, subjekti ka depozituar kopje të dokumentit mandat bankar në ProCredit Bank, të datës 9.8.2007, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumën 174 USD, përcaktuar si shumë e përfituar në dokumentin e fondacionit “****”, të datës 13.7.2007.

⁵⁰ Gjithashtu, subjekti ka depozituar: (i) kopje të dokumentit mandat bankar në ProCredit Bank, të datës 9.8.2007, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumën 54 euro, të përcaktuar si shumë e përfituar në dokumentin e fondacionit “****”, të datës 13.7.2007; (ii) kopje të dokumentit “Çek bankar”, me nr. serie **, në ProCredit Bank, në të cilin duket se referohet se është tërhequr nga personi i lidhur shuma 1,224 euro, përcaktuar si shumë e përfituar në dy dokumentet e fondacionit “****”, të datës 7.9.2007; (iii) kopje të dokumentit mandat bankar në ProCredit Bank, të datës 22.11.2007, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumën 682 euro, përcaktuar si shumë e përfituar në dokumentin e fondacionit “****”, të datës 21.11.2007.

⁵¹ Gjithashtu, subjekti ka depozituar kopje të dokumentit mandat bankar në Societe Generale Albania, të datës 22.12.2010, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumën 135 USD, përcaktuar si shumë e përfituar në dokumentin e fondacionit “****”, të datës 13.10.2010.

në total shumë prej 1290 euro⁵²; (xvi) Referuar tri dokumenteve në gjuhë të huaj, shkresa të thjeshta të fondacionit “****”, të periudhave 30.3.2016, prill 2016 dhe maj 2016, personi i lidhur ka përfituar shumë totale prej 1,049 euro⁵³.

26.18.5 Sa më sipër, duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer për fondacionin “****” për periudhën 2004 – 2016, në total vlerat monetare 9,197 euro, 2,588 USD dhe 26,970 lekë. Për periudhën para kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit të blerjes të pasurisë objekt vlerësimi duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer për fondacionin “****”, në total vlerat monetare 5,284 euro, 1,013 USD dhe 26,970 lekë.

26.18.6 Komisioni vëren se tri vlera monetare të evidentuara si të tërhequra me çek nga bashkëshortja e subjektit – pjesë e fondeve të fondacionit “****” – duket se nuk lidhen me të ardhura të referuara si të përfituara nga personi i lidhur në informacionin e pasqyruar në shkresat e këtij fondacioni të administruara në dosje, pasi nuk përkon periudha e tërheqjes dhe shumat përkatëse të tërhequra me periudhën dhe shumat e referuara në këto shkresa, konkretisht: (i) tërheqja e shumës 46,712 lekë në datën 3.1.2014; (ii) tërheqja e shumës 928 euro në datën 19.6.2015; (iii) tërheqja e shumës 119 euro në datën 4.4.2016. Këto vlera monetare duket se pretendohen si të ardhura shtesë, krahas atyre të referuara në shkresat e sipërcituara.

26.18.7 Gjithashtu, duket se në shkresat e fondacionit “****”, që lidhen me periudhën e përfitimit të të ardhurave nga viti 2006 e në vijim, referohet se është mbajtur në burim tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur, sipas shkallës tatimore përkatëse.

Në analizë të të gjitha të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për periudhën 2004 – 2016 ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme financiare me fondacionin “**” dhe se ka përfituar të ardhura nga puna/shërbimi i kryer për këtë fondacion.***

26.18.8 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi dokumentacionin e plotë të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar, që lidhet me marrëdhënien e punësimit/shërbimit të personit të lidhur me fondacionin “****”.

26.18.9 Në kushtet kur nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi marrëdhënien e bashkëshortes së subjektit me fondacionin “****” rezultoi se në shkresat e depozituara për periudhën nga viti 2006 e në vijim referohet se është mbajtur tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur, sipas shkallës tatimore përkatëse, në analizën financiare paraprake u reflektuan të ardhura nga ky burim për këtë periudhë, sipas informacionit të dhënë në shkresat e fondacionit “****”, përveç të ardhurave për të cilat evidentohet vetëm tërheqja me çek e tyre.

⁵² Gjithashtu, subjekti ka depozituar: (i) kopje të dokumentit mandat bankar të Societe Generale Albania, datë 19.6.2015, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumë prej 928 euro (fonde të fondacionit “****”); (ii) kopje të dokumentit mandat bankar të Societe Generale Albania, datë 20.11.2015, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumë prej 259 euro, të përcaktuar si të përfituar nga personi i lidhur në dokumentin e fondacionit “****”, të muajit shtator 2015; (iii) kopje të dokumentit mandat bankar të Societe Generale Albania, datë 20.11.2015, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumë prej 95 euro, të përcaktuar si të përfituar nga personi i lidhur në dokumentin e fondacionit “****”, të muajit tetor 2015; (iv) kopje të dokumentit mandat bankar të Societe Generale Albania, datë 20.11.2015, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumë prej 631 euro, të përcaktuar si të përfituar nga personi i lidhur në dokumentin e fondacionit “****”, të muajit nëntor 2015.

⁵³ Gjithashtu, subjekti ka depozituar: (i) kopje të dokumentit mandat bankar të Societe Generale Albania, datë 4.4.2016, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumë prej 119 euro (fonde të fondacionit “****”); (ii) kopje të dokumentit mandat bankar të Societe Generale Albania, datë 12.5.2016, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumë prej 97 euro, të përcaktuar si të përfituar nga personi i lidhur në dokumentin e fondacionit “****”, të muajit prill 2016; (iii) kopje të dokumentit mandat bankar të Societe Generale Albania, datë 12.5.2016, nga ku duket se personi i lidhur ka tërhequr me çek shumë prej 57 euro, të përcaktuar në dokumentin e fondacionit “****”, të muajit maj 2015.

26.18.10 Ndërsa, për periudhën para vitit 2006, në shkresat e fondacionit “****” nuk është përcaktuar mbajtja e tatimit në burim për të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur.

➤ **Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të shpjeguar/argumentuar mbi marrëdhënien e personit të lidhur me fondacionin “****” për këtë periudhë, si dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbajtjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, përfshirë edhe të ardhurat e evidentuara si të tërhequra me çek në vitet 2014, 2015 dhe 2016.**

Të ardhura nga qendra “*”, për shërbime si trajnuese, moderatore, lehtësuese, përkthyes, në total vlerat 37,200 lekë dhe 2,753 euro***

26.18.11 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie (deklarata fillestare e pasurisë e vitit 2003, dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.3.2004), në seksionin e të ardhurave, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhura nga përkthimet e realizuara që prej 7 vjetësh për OJF e fondacione të ndryshme, si dhe si eksperte në fushën e mjedisit, duke realizuar shërbime dhe raporte për projekte të ndryshme mjedisore, por nuk ka deklaruar shumën e përfituar, duke sqaruar se nuk mund ta përcaktojë saktësisht, pasi këto të ardhura janë të shpërndara në vite dhe pa rregull; (ii) Në DIPP-në e vitit 2004 rezulton se subjekti ka deklaruar përfitimin e shumë prej rreth 500 euro nga personi i lidhur, pagesa konsulence si eksperte për studime nga qendra “****”, M.M.M dhe K.E Krujë; (iii) Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara prej bashkëshortes së tij nga përkthimet dhe shërbime për fondacione e forume të ndryshme (***, ***, F.R i OJQ-ve Krujë), në total shumat 201 USD dhe rreth 300 – 400 euro; (iv) Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga përkthime, shërbime, dieta (jashtë vendit) për shoqata, fondacione, forume etj. (***, ***, F.R i OJQ-ve Krujë, *** etj.), në total shumat 1,806 euro, 346 USD dhe 10,365 lekë; (v) Në DIPP-në e vitit 2007, ndër të tjera, ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga puna si eksperte apo nga përkthime për qendrën “****” dhe fondacionin “****”, në euro, USD dhe lekë, konkretisht shumat 3,361 euro 586 USD dhe 16,605 lekë; (vi) Në DIPP-në e vitit 2008, ndër të tjera, ka deklaruar të ardhura të përfituara nga bashkëshortja si *freelance trainer* për qendrën “****”, I.T.A.P dhe ***, në total vlerat monetare 195,700 lekë dhe 300 euro; (vii) Në DIPP-në e vitit 2009 ka deklaruar të ardhura të përfituara nga bashkëshortja për kryerjen e shërbimeve të trajnimit për qendrën “****”, në total shumën prej 250 euro; (viii) Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar të ardhura të tjera të bashkëshortes nga kryerja e punëve të ndryshme, përkthime, trajnime etj., por pa përcaktuar subjektet nga janë përfituar këto të ardhura, si dhe vlerat përkatëse monetare të përfituara.

26.18.12 Në vijim të verifikimit të deklaratimeve të bëra ndër vite në ILDKPKI, duket se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur kanë deklaruar përfitimin e të ardhurave si rezultat i punës së kryer nga personi i lidhur për qendrën “****” edhe për periudhën 2011, në shumën 180 euro.

26.18.13 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer me përkthime për qendrën “****”, duket se: (i) Referuar dy dokumenteve në gjuhë të huaj, në dukje të llojit mandatpagesa, me titull “Voucher”, që mbajnë datat 15.2.2005 dhe 3.3.2005, personi i lidhur për vitin 2005 ka përfituar në total shumën 350 euro; (ii) Referuar tri dokumenteve në gjuhë të huaj, në dukje të llojit mandatpagesa, me titull “Payment Voucher”, që mbajnë datat 21.3.2006, 26.05.2006 dhe 30.11.2006, personi i lidhur për vitin 2006 ka përfituar në total shumën 645 euro; (iii) Referuar dy dokumenteve në gjuhë të huaj, në dukje të llojit mandatpagesa, me titull “Payment Voucher”, që mbajnë datat 2.10.2007 dhe 18.10.2007, personi i lidhur për vitin 2007 ka përfituar në total shumën 450 euro. Këto mandatpagesa “Payment Voucher” duket se shoqërohen me mandat për mbajtjen e tatimit në burim për të ardhurat “Income Voucher”; (iv) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Young Environmentalist Kit

– Under ***, i cili duket se është nënshkruar nga përfaqësues të qendrës **** dhe bashkëshortja e subjektit, për periudhën korrik – shtator 2008 personi i lidhur ka përfituar të ardhura në total në shumën 26,000 lekë; (v) Referuar tri dokumenteve në gjuhë të huaj, në dukje të llojit mandatpagesa, me titull “Payment Voucher”, që mbajnë datat 7.4.2008 dhe 15.7.2007, si dhe për një mandat (data e palexueshme), personi i lidhur për vitin 2008 ka përfituar në total shumën 275 euro. Dy nga këto mandatpagesa “Payment Voucher” duket se shoqërohen me mandat për mbajtjen e tatimit në burim për të ardhurat “Income Voucher”, konkretisht pagesat 100 euro dhe 150 euro; (vi) Referuar dy dokumenteve të qendrës *** “Vërtetim Pagese nr. ***” dhe “Vërtetim Pagese nr. ***”, të datës 5.4.2010, që lidhen me dokumentin në gjuhë të huaj, me titull “Service Agreement”, datë 5.4.2010 (nr. *** prot.), nënshkruar nga personi i lidhur dhe përfaqësues të qendrës ****, personi i lidhur ka përfituar në total shumën 222 euro. Duket se bazuar në dokumentin “Vërtetim Pagese nr. ***”, qendra **** ka mbajtur tatimin në burim për shumën e referuar në këtë mandatpagesë, konkretisht për shumën 225 euro. Sipas dokumentit bankar të paraqitur nga subjekti, duket se në datën 5.4.2010 personi i lidhur ka tërhequr me çek nga llogaria e qendrës **** në ProCredit Bank shumën 222 euro; (vii) Gjithashtu, referuar dokumentit në gjuhë të huaj, me titull “Service Agreement”, datë 15.7.2010 (nr. *** prot.), nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe qendrës ****, personi i lidhur do të përfitonte shumën 150 për tri ditë pune, në total shumën prej 450 euro. Pas mbajtjes së tatimit shuma neto e përfituar do të ishte 405 euro. Bazuar në dokumentin bankar të paraqitur nga subjekti duket se në datën 23.9.2010 personi i lidhur ka tërhequr me çek në ProCredit Bank nga llogaria e qendrës **** shumën prej 405 euro.

26.18.14 Gjithashtu, duket se referuar dokumentit “Mandatpagesë”, të datës 11.12.2009, personi i lidhur ka tërhequr me çek bankar shumën 225 euro nga llogaria e qendrës ****.

26.18.15 Sa më sipër, bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e depozituar, duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer për qendrën ****, për periudhën 2005 – 2010, në total vlerat monetare 2,347 euro⁵⁴ dhe 26,000 lekë. Për periudhën para kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer për qendrën ****, në total vlerat monetare 1,942 euro dhe 26,000 lekë.

Në analizë të të gjithë të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë indicie dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për periudhën 2005 – 2010, ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme financiare me qendrën ** dhe se ka përfituar të ardhura nga puna/shërbimi i kryer për këtë subjekt.**

26.18.16 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi dokumentacionin e plotë të përkthyer në gjuhën shqipe, të njëzuar dhe të noterizuar, që lidhet me marrëdhënien e punësimit/shërbimit të personit të lidhur me qendrën ****.

26.18.17 Nga shqyrtimi i dokumenteve që tregojnë marrëdhënien e bashkëshortes së subjektit me qendrën ****, duket se për periudhën nga viti 2007 e në vijim kryesisht referohet se është mbajtur në burim tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur. Bën përjashtim e ardhura e përfituar për periudhën korrik – shtator 2008, në total në shumën 26,000 lekë. Në këtë kuptim, në analizën financiare paraprake u reflektuan të ardhura nga ky burim për periudhën nga viti 2007 e në vijim sipas informacionit të dhënë në shkresat/dokumentet e qendrës ****, përveç të ardhurave të përfituara për periudhën korrik – shtator 2008 dhe ato për të cilat evidentohet vetëm tërheqja me çek e tyre – si më sipër.

⁵⁴ Në këtë shumë nuk është përfshirë vlera e evidentuar si e tërhequr me çek në datën 11.12.2009, në ProCredit Bank, prej 225 euro.

26.18.18 Ndërsa, për periudhën para vitit 2007 në shkresat/mandatet/dokumentet e qendrës “****” nuk është përcaktuar mbajtja e tatimit në burim për të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur.

➤ **Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të shpjeguar/argumentuar mbi marrëdhënien e personit të lidhur me qendrën “****” për këtë periudhë, si dhe/apo të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbajtjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, përfshirë ato të evidentuara si të përfituara për periudhën korrik – shtator 2008, si dhe ato të tërhequra me çek në datën 11.12.2009.**

26.18.19 Të ardhura nga **:** (i) të ardhura nga kontrata me ***, nr. ***, tetor 2006, në vlerën 1,400 euro, nga të cilat 700 euro tërhequr me çek dhe 700 euro kaluar përmes Raiffeisen Bank; (ii) të ardhura nga kontrata me ***-në, viti 2013, “L.A.R.E.D”, në vlerën 3,216 euro. Pagesat përmes llogarisë bankare në Raiffeisen Bank dhe një pagesë me çek bankar prej 900 euro; (iii) të ardhura nga trajnimi për *** (shtator 2015) në vlerën 150 euro. Shuma është derdhur në llogarinë rrjedhëse nr. ***, në Intesa Sanpaolo Bank.

26.18.20 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga përkthime, shërbime, dieta (jashtë vendit) për shoqata, fondacione, forume etj. (****, ***, F.R i OJQ-ve Krujë, *** etj.), në total shumat 1,806 euro, 346 USD dhe 10,365 lekë; (ii) Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga puna si eksperte për ***-në, kontrata *** no. ***, datë 30.10.2006, kësti i dytë i pagesës me çekun nr. ***, tërhequr nga Raiffeisen Bank në datën 22.5.2007, derdhur në BKT.

26.18.21 Në vijim të verifikimit të deklarimeve të bëra ndër vite në ILDKPKI, duket se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur kanë deklaruar përfitimin e të ardhurave si rezultat i punës së kryer nga personi i lidhur për ***-në për vitet 2013 dhe 2015, konkretisht: (i) Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara prej bashkëshortes nga konsulenca në fusha të ndryshme për projekte me ***, *** Albania dhe ***, në total shumën prej 8,800 euro; (ii) Në DIPP-në e vitit 2015, personi i lidhur ka deklaruar shumën e të ardhurave prej 150 euro, të përfituar nga trajnimet për ***-në.

26.18.22 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer (trajnimet) për ***-në – duket se: (i) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj “SSA” (***) no. ***), datë 30.10.2006, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të ***-së, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 1,400 euro, e cila do të ndahet në dy pagesa nga 700 euro. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 21.12.2006 është transferuar shuma 700 euro, me dërgues “****”, me përshkrimin “**** SSA for V.M 1st month from ****”. Gjithashtu, bazuar në dokumentin bankar të paraqitur nga subjekti, duket se në datën 22.5.2007 personi i lidhur ka tërhequr me çek në Raiffeisen Bank nga llogaria e ***-së në Shqipëri shumën 700 euro; (ii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj “SSA” (***) no. ***), datë 20.5.2013, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të ***, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve dhe për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën 3,200 euro, e cila do të ndahet në tri pagesa, si vijon: (a) kësti i parë 900 euro; (b) kësti i dytë 1,500 euro; (c) kësti i tretë 600 euro. Nga verifikimi i llogarisë bankare të personit të lidhur në Raiffeisen Bank, duket se: (a) në datën 6.11.2013 është kredituar shuma 1,500 euro, me subjekt dërgues “****”; (b) në datën 13.11.2013 është kredituar shuma 216 euro, me subjekt dërgues “****”; (c) në datën 23.12.2013 është kredituar shuma 600 euro, me subjekt dërgues “****”. Gjithashtu, bazuar në dokumentin bankar të paraqitur nga subjekti, duket se në datën 25.9.2013 personi i lidhur ka tërhequr me çek në Raiffeisen Bank nga llogaria e *** në Shqipëri shumën

900 euro; (iii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj me titull “Terms of Reference”, datë 17.8.2015 dhe “SSA” (***) no. ***), datë 15.9.2015, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të ***, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve dhe për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën 150 euro. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje konfirmohet se në datën 12.10.2015 shuma 150 euro është kredituar në llogarinë e personit të lidhur në ISP Bank.

26.18.23 Sa më sipër, bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e depozituar, duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer (trajnimet) për ***-në, në total vlerën 4,750 euro. Për periudhën para kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer (trajnimet) për ***-në, në total vlerën monetare prej 1,400 euro.

Në analizë të të gjitha të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vitet 2006, 2007, 2013 dhe 2015, ka pasur marrëdhënie financiare me përfaqësinë e * në Shqipëri dhe se ka përfituar të ardhura nga puna/shërbimi i kryer për këtë organizatë.***

26.18.24 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar, vetëm kontratën/marrëveshjen e datës 30.10.2006, të lidhur me ***, ku referohet përfitimi i vlerës 1,400 euro.

26.18.25 Gjithashtu, konstatohet se në marrëveshjet/kontratat e lidhura mes bashkëshortes së subjektit dhe *** është përcaktuar se taksat apo detyrimet e tjera që rrjedhin nga kjo marrëdhënie nuk mbulohen nga pala punëdhënëse (***)

➤ **Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të depozituar dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji (të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar) për dy nga kontratat/marrëveshjet e lidhura me *** (marrëveshjet/kontratat e datave 20.5.2013 dhe 17.8.2015). Gjithashtu, subjektit iu kërkua të provojë me dokumentacion justifikues ligjor pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga marrëdhënia e punësimit/shërbimit me ***.**

26.18.26 *Të ardhura të marra nga I.K* (Ministria e Arsimit) më 12.10.2006 për shkrimin e një artikulli në revistë, në shumën 14,200 lekë. Subjekti/personi i lidhur deklaroi se nuk ka dokument provues, duke sqaruar se paratë janë tërhequr në zyrën e financës së institucionit.

26.18.27 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar shumën e të ardhurave prej 14,200 lekësh, të përfituara nga bashkëshortja e tij në datën 12.10.2006 prej I.K (në varësi të Ministrisë së Arsimit), për shkrim artikulli në revistë.

➤ **Por, duket se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave dhe pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.**

26.18.28 *Të ardhura nga përkthime për ****, në total në shumën 71,835 lekë. Deklaron se nuk ka kontratë dhe as mandatpagesë.

26.18.29 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2004, ndër të tjera, të ardhurat e bashkëshortes së tij nga përkthimi për materiale shoqatash, konkretisht nga ***, janë në shumën prej 71,385 lekësh.

➤ Por, duket se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave dhe pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.

Të ardhura nga marrëdhënia me kompaninë “”***

26.18.30 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, personi i lidhur ka deklaruar: (i) të ardhura nga kontrata me kompaninë “***”, për projektin “***”, titulli “***”, pagesa të përfituara në dy këste nga 750 euro, në muajt maj dhe korrik të vitit 2007, në total shuma 1,500 euro; (ii) të ardhura nga kontrata me kompaninë “***”, kaluar përmes Raiffeisen Bank, për projektin “***”. Transfertat e kryera në datat 17.10.2007, 3.1.2008, 29.4.2008 dhe 20.8.2008, në total në shumën 7,729 euro.

26.18.31 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga kompania austriake “***” në formën e shpërblimit për projektin “***” (1,500 euro) + rroga mujore (500 euro/muaj) korrik – dhjetor, në total shuma 4,500 euro; (ii) Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga paga + honorare prej bashkëshortes së tij nga punësimi në projektin “***” në kompaninë “***”, në total në shumën 4,234 euro.

26.18.32 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer për kompaninë “***”, duket se: (i) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Contract”, datë 4.4.2007, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të kompanisë “***”, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve dhe për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën 1,500 euro. Gjithashtu, subjekti ka depozituar dy dokumente në gjuhë të huaj me logo të kompanisë “***”, me titull “Confirmation of Payment”, ku referohet se: (a) në datën 8.5.2007, personi i lidhur konfirmon se ka marrë pagesën prej 750 euro; (b) në datën 15.7.2007, personi i lidhur konfirmon se ka marrë pagesën prej 750 euro nga kjo kompani; (ii) Referuar dokumentit bankar në gjuhë të huaj, të depozituar nga subjekti (nga E Bank Austri), në datën 15.10.2007, nga llogaria e përfaqësuesve të kompanisë “***” transferohet në llogarinë e personit të lidhur shuma 1,955 euro. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje rezulton se në datën 17.10.2007 në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank kreditohet nëpërmjet transfertës bankare shuma 1,946 euro, me urdhërues “W D.M. ***”, me përshkrimin “Projekt ***”; (iii) Në vijim të verifikimit të dokumentacionit bankar të administruar në dosje, Komisioni konstaton se në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank gjatë vitit 2008 janë kredituar dy vlera monetare me anë të transfertës, në të cilat identifikohet si urdhërues “W D.M”, në total shuma 4,234 euro, konkretisht: (a) në datën 29.4.2008, shuma 1,891 euro, me përshkrimin “Projekt *** supply chain organic herbs payment request dated 23 April 2008”; (b) në datën 20.8.2008, shuma 2,343 euro, me përshkrimin “Projekt *** invoice July 29th 2008”; (iv) Gjithashtu, në llogarinë bankare të personit të lidhur identifikohet një transfertë hyrëse në datën 3.1.2008, në shumën 1,546 euro, pa përshkrim, por e cila duket se ka referencë të ngjashme me dy transfertat e sipërcituara.

26.18.33 Sa më sipër, bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e depozituar, duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer për kompaninë “***”, për vitet 2007 dhe 2008, në total shumën prej 9,226 euro.

Në analizë të të gjitha të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vitet 2007 dhe 2008, ka pasur marrëdhënie financiare me kompaninë “*” dhe se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer për këtë subjekt.***

26.18.34 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar kontratën/marrëveshjen e datës 4.4.2007, të lidhur me kompaninë “***”, ku referohet përfitimi i vlerës 1,500 euro, si dhe pesë vërtetime pagesash.

26.18.35 Rezulton se në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka depozituar tri vërtetime shtesë, që lidhen me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga marrëdhënia e punësimit/shërbimit të bashkëshortes së tij me kompaninë “***”, me të dhënat si vijon: (i) vërtetim pagese i datës 25.2.2008, ku referohet se personi i lidhur konfirmon se ka marrë pagesën 1,000 euro; (ii) vërtetim pagese i datës 23.4.2008, ku referohet se personi i lidhur konfirmon se ka marrë pagesën 1,500 euro; (iii) vërtetim pagese i datës 21.8.2008, ku referohet se personi i lidhur konfirmon se ka marrë pagesën 2,352 euro.

➤ **Por, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga marrëdhënia e punësimit/shërbimit me kompaninë “***”. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të depozituar dokumentacion justifikues ligjor me qëllim provueshmërinë e pagesës së detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura.**

26.18.36 *Të ardhura nga shërbimi në kuadër të **** (P.D.S.O – ***), deklaruar për vitin 2008, përfituar me transfertë në Raiffeisen Bank, në total shuma 8,000 euro

26.18.37 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga bashkëshortja e tij, projekt me ing. I.H, projekti DSD (P.D.S.O – ***), shuma 8,000 euro.

26.18.38 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga shërbimet e kryera në kuadër të DSO-së, duket se referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Task description V.M – for the function of assistant in the P.P.D.S.O (***) , 1.5.2008 – 31.8.2008”, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe shtetasit I.H, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën 8,000 euro, katër pagesa mujore nga 2,000 euro secila. Gjithashtu, subjekti ka depozituar dokumentin në gjuhë të huaj, me titull “Confirmation of Payment”, nga ku duket se personi i lidhur konfirmon se ka përfituar nga shtetasi I.H pagesën prej 8,000 euro, për projektin “Privatization of the DSO (***) for the period May – August 2008”.

26.18.39 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje konfirmohet se në datën 25.8.2008 në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës vlera 8,000 euro, me subjekt dërgues (urdhërues) të identifikuar “Dipl.Ing. I.H”, me përshkrimin “Ai Till August – Projekt DSO”.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vitin 2008 ka pasur marrëdhënie financiare me ing. I.H në kuadër të një projekti për operatorin * dhe se ka përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie.***

26.18.40 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar dokumentin “Përshkrim pune” të referuar si më sipër, si dhe dokumentin për konfirmimin e pagesave.

➤ Por, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga marrëdhënia e punësimit/shërbimit marrëdhënia e punësimit/shërbimit me shtetasin I.H dhe/apo ***. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të depozituar dokumentacion justifikues ligjor me qëllim provueshmërinë e pagesës së detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura.

26.18.41 Të ardhura nga kompania “****” për projektin “****”, në shumën 2,392 euro, përfituar në datën 23.10.2009 me transfertë bankare në Raiffeisen Bank. Subjekti/personi i lidhur deklaroi se nuk ka gjetur dokumente provuese për këto të ardhura.

26.18.42 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhura nga shërbimet e konsulencës për kompaninë austriake “****”, në shumën 2,500 euro.

26.18.43 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje konfirmohet se në datën 23.10.2009 në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës vlera 2,392 euro, me subjekt dërgues (urdhërues) të identifikuar “**** W.G.Mbh.”, me përshkrimin “Voice from 12. june 2009”.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie* dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, në vitin 2009 ka pasur marrëdhënie financiare me kompaninë austriake “****” dhe se ka përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie.

➤ Por, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji për përfitimin e këtyre të ardhurave dhe nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.

26.18.44 Të ardhura nga ***/*** për projektin “****”, në shumën 97,400 lekë, përfituar nëpërmjet transfertave bankare në Raiffeisen Bank në muajt maj dhe dhjetor të vitit 2008. Subjekti/personi i lidhur deklaroi se nuk e disponon kontratën.

26.18.45 Komisionin konstaton se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar të ardhurat në shumën 97,400 lekë, përfituar nga bashkëshortja prej trajnimeve të bëra për organizatën “****”, projekti “****”.

26.18.46 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje, konfirmohet se: (i) në datën 16.5.2008, në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës vlera 19,900 lekë, me subjekt dërgues (urdhërues) të identifikuar “Shoq. për ruajtjen e natyrës (***)”, me përshkrimin “G Dieta nga fondi ****”; (ii) në datën 24.12.2008, në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës vlera 75,500 lekë, me subjekt dërgues (urdhërues) të identifikuar “Shoq. për ruajtjen e natyrës (***)”, me përshkrimin “G 8 Dite Fee + 8 Dite ****”.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie* dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, në vitin 2008 ka pasur marrëdhënie financiare me organizatën “****” dhe se ka përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie.

➤ Por, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji për përfitimin e këtyre të ardhurave dhe nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me

dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.

26.18.47 Të ardhura nga K.E Krujë, projekti “K.L.Sh.C Krujë”, përfituar në datën 15.9.2006, në shumën 60 USD

26.18.48 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga përkthime, shërbime, dieta (jashtë vendit) për shoqata, fondacione, forume etj. (***, ***, F.R i OJQ-ve Krujë, *** etj.), në total shumat 1,806 euro, 346 USD dhe 10,365 lekë.

26.18.49 Me qëllim provueshmërinë e përfitimit të këtyre të ardhurave, subjekti ka depozituar kopje të dokumentit “Vërtetim pagese”, i cili duket të jetë i palexueshëm.

➤ **Sa më sipër, duket se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave dhe pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.**

26.18.50 Të ardhura nga kompania “**”, projekti “****”, përfituar në datën 28.1.2009, në shumën 1,061 euro**

26.18.51 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga bashkëshortja V.M prej shërbimeve të konsulencës nga projekti për kompaninë “****”, në shumën 1,061 euro.

26.18.52 Me qëllim provueshmërinë e përfitimit të këtyre të ardhurave, subjekti ka depozituar kopje të dokumentit “Mandatpagesë”, nr. ***, datë 28.1.2009, me përshkrimin “Shërbim konsulence – projekti ***, për V.M, shuma prej 1,060 euro”.

➤ **Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimi/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji për përfitimin e këtyre të ardhurave dhe nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.**

26.18.53 Të ardhura nga kompania “**”, viti 2007, në shumën 3,250 euro; referenca ***, “P.M.C.S.E.E”. Subjekti/personi i lidhur deklaroi se pagesat janë bërë nëpërmjet Raiffeisen Bank, por se kontratën nuk e disponon. Referon se ka depozituar printimin, ku duket “komunikimi me personin përgjegjës” dhe kërkesa për pagesa.**

26.18.54 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga puna si monitoruese për kompaninë daneze “****”, për projektin “P.M.C.S.E.E DG ENV”, në shumën 3,300 euro.

26.18.55 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim punën e kryer për kompaninë “****”, duket se, referuar dy dokumenteve në gjuhë të huaj, shkresa të thjeshta: (i) “Payment of fee for peirod December 2006 – April 2007”; (ii) “Payment of fee for peirod April – July 2007”, personi i lidhur ka përfituar nga kompania “****” në total shumën 3,267 euro, për projektin “P.M.C.S.E.E DG ENV”.

26.18.56 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje konfirmohet se: (i) në datën 26.6.2007, në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës vlera 971 euro, me subjekt dërgues (urdhërues) të identifikuar “**** A/S”, me përshkrimin “EUR ***/***/INV ***. ***”; (ii) në datën 14.9.2007, në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës vlera 2,279 euro, me subjekt dërgues (urdhërues) të identifikuar “****”, me përshkrimin “EUR ***/***/INV OCIENO. ***”. Pra, konfirmohet se në llogarinë e personit të lidhur gjatë vitit 2007 është kredituar shuma 2,250 euro, me transfertë bankare nga kompania “****”.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie* dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, në vitin 2007 ka pasur marrëdhënie financiare me kompaninë “**” dhe se ka përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie.**

26.18.57 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi dokumentacionin e plotë të përkthyer në gjuhën shqipe, të njëzuar dhe të noterizuar, që lidhet me marrëdhënien e punësimit/shërbimit të personit të lidhur me kompaninë “****”.

➤ **Por, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga marrëdhënia e punësimit/shërbimit me kompaninë “****”. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.**

26.18.58 *Të ardhurat nga kontratat me ****:* (i) për vitin 2008, shuma 80,000 lekë (kontrata no. ****/****/****, datë 22.10.2008); (ii) për vitin 2009, shuma 40,000 lekë (dy kontrata: njëra no. ****/****/****, datë 10.3.2009, tjetra pa numër, datë 13.11.2009); (iii) për vitin 2011, shuma 150,000 lekë, përfituar nga puna në rolin e *national coordinator*. Subjekti/personi i lidhur deklaroi se nuk e disponon kontratën për këtë vit. Gjithashtu, deklarohet se shumata e përfituara janë kaluar në rrugë bankare përmes Intesa Sanpaolo Bank.

26.18.59 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) në DIPP-në e vitit 2008, ndër të tjera, ka deklaruar të ardhura të përfituara nga bashkëshortja si *freelance trainer* për qendrën “****”, I.T.A.P dhe ****, në total vlerat monetare 195,700 lekë dhe 300 euro; (ii) në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara prej bashkëshortes nga kontrata me **** – Tiranë, në datat 10.3.2009 dhe 13.11.2009, secila nga 40,000 lekë, në total shumën prej 80,000 lekësh; (iii) në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka përfituar nga **** shumën prej 150,000 lekësh, si pagesë për trajnimet e kryera.

26.18.60 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim shërbimet e kryera në favor të **** – duket se: (i) referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë “S.S.A- No ****/****/****”, datë 22.10.2008, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të ****, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën prej 80,000 lekësh; (ii) referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë “S.S.A - No ****/****/****”, datë 10.3.2009, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të ****, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën prej 40,000 lekësh; (iii) referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë “S.S.A”, datë 13.11.2009, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të ****, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën prej 40,000 lekësh. Gjithashtu, subjekti ka depozituar kopje të *email*-it të dërguar nga personi i lidhur për të disponuar kontratën e vitit 2011.

26.18.61 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje, rezulton se: (i) në datën 18.11.2008, në llogarinë e personit të lidhur në ISP Bank është kredituar nëpërmjet transfertës shuma 80,000 lekë, pa përshkrim; (ii) në datën 8.7.2009, në llogarinë e personit të lidhur në ISP Bank është kredituar nëpërmjet transfertës shuma 40,000 lekë, pa përshkrim; (iii) në datën 4.12.2009, në llogarinë e personit të lidhur në ISP Bank është kredituar nëpërmjet transfertës shuma 40,000 lekë, me përshkrimin “A/C TO A/C Transfer TRFR U.N.D.P. to V.M, PAYM of SSA ALB ****/**** REF: **** VO ****”; (iv) në datën 11.11.2011, në llogarinë e personit të lidhur në ISP Bank është kredituar nëpërmjet transfertës shuma 150,000 lekë, pa përshkrim.

26.18.62 Sa më sipër, bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e depozituar, duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga shërbimet e kryera për ***, në total në vlerën 270,000 lekë. Për periudhën para kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit të blerjes të pasurisë objekt vlerësimi, duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura nga shërbimet e kryera për ***, në total shumën prej 120,000 lekësh.

Në analizë të të gjitha të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vitet 2008, 2009 dhe 2011 ka pasur marrëdhënie financiare me organizatën “**” dhe se ka përfituar të ardhura nga shërbimet e kryera për këtë organizatë.***

26.18.63 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi pjesërisht dokumentacionin të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar, që lidhet me marrëdhënien e punësimit/shërbimit të personit të lidhur me organizatën “****”.

26.18.64 Gjithashtu, duket se në marrëveshjet/kontratat e lidhura mes bashkëshortes së subjektit dhe *** është përcaktuar se taksat apo detyrimet e tjera që rrjedhin nga kjo marrëdhënie nuk mbulohen nga pala punëdhënëse (***)

➤ **Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion e plotë në formën e kërkuar nga ligji, si edhe nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga marrëdhënia e punësimit/shërbimit me organizatën “****”. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këto konstatime.**

26.18.65 *Të ardhura nga I.T.A.P:* (i) trajnim për *senior managers* (kontrata nr. ***, datë 20.6.2008), shuma 121,500 lekë⁵⁵; (ii) pagesa e bërë në datën 22.12.2008 nëpërmjet sistemit bankar në Raiffeisen Bank, në shumën 29,700 lekë, duke referuar se nuk ka dokument tjetër për këtë pagesë.

26.18.66 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2008, ndër të tjera, ka deklaruar të ardhura të përfituara nga bashkëshortja si *freelance trainer* për qendrën “****”, I.T.A.P dhe ***, në total vlerat monetare 195,700 lekë dhe 300 euro.

26.18.67 Referuar dokumentit kopje të mandatit bankar nga ProCredit Bank, datë 4.9.2008, depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, paraqitet lëvizja e llogarisë e shtetases M. M (M), nga ku duket se në datën 2.9.2008 në llogarinë e kësaj shtetaseje është transferuar shuma 121,500 lekë, me përshkrimin “Nga “I.T.A.P. Lik. Kont. ***, datë 20.6.2008”.

26.18.68 Në vijim të verifikimit të dokumentacionit bankar të administruar në dosje konstatohet se në datën 22.12.2008 në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank është kredituar shuma 29,700 lekë, me përshkrimin “HON V.M”.

➤ **Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për përfitimin e këtyre të ardhurave dhe nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.**

26.18.69 *Të ardhura të përfituara nga tri kontrata me institutin “****” për vitin 2009:* (a) kontrata datë 7.9.2009, me objekt “Hartimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për Komunën D”; (b) kontrata datë 1.10.2009, me objekt “Hartimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për Komunën G.Z”. Në total, shuma e përfituar nga këto dy kontrata është në vlerën 2,591,805 lekë; (c) kontrata datë 15.1.2009, me objekt “Menaxhimi i Mbetjeve për G.Z dhe Fushë-Arrëz”,

⁵⁵ Me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, subjekti ka depozituar kopje të mandatit bankar nga ProCredit Bank, datë 4.9.2015.

shuma e të ardhurave të përfituara në vlerën 11,183 euro. Gjithashtu, subjekti/personi i lidhur ka deklaruar të ardhura për dieta për të njëjtin projekt në shumën 110,250 lekë, duke referuar se të gjitha shumat janë transferuar nëpërmjet sistemit bankar në datën 21.11.2014.

26.18.70 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga bashkëshortja si eksperte e kontraktuar nga instituti “***”, për tri projekte e, konkretisht: (i) shumën 11,200 euro, me kontratën për G.Z, Fushë-Arrëz, datë 15.1.2009; (ii) shumën 1,380,000 lekë, kontrata me Komunën D, datë 7.9.2009; (iii) shumën 1,214,000 lekë, kontrata me Komunën G.Z, datë 1.10.2009. Ndërsa, referuar DIPP-së së vitit 2014, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar të ardhura/dieta me burim projektet me institutin “***”.

26.18.71 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim shërbimet e kryera për institutin “***”, duket se: (i) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Contract for Consulting Services”, datë 15.1.2009, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të institutit “***”, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën 12,444 euro, duke u dakordësuar se tatimi mbi të ardhurat do të mbahet dhe paguhet nga instituti “***” dhe, si përfundim, shuma neto që do të përfitohet është 11,200 euro; (ii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Contract for Consulting Services”, datë 7.9.2009, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të institutit “***”, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën 1,533,333 lekë, duke u dakordësuar se *tatimi mbi të ardhurat do të mbahet dhe paguhet nga “***”* dhe, si përfundim, shuma neto që do të përfitohet është 1,380,000 lekë; (iii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Contract for Consulting Services”, datë 1.10.2009, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të institutit “***”, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve për periudhën e përcaktuar në marrëveshje të përfitojë shumën 1,349,333 lekë, duke u dakordësuar se *tatimi mbi të ardhurat do të mbahet dhe paguhet nga “***”* dhe, si përfundim, shuma neto që do të përfitohet është 1,214,400 lekë.

26.18.72 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje rezulton se: (i) në datën 8.12.2009, në llogarinë e personit të lidhur në monedhën euro në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës shuma 11,183 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “***/***”, me përshkrimin “Shlyerje kontrate”; (ii) në datën 8.12.2009, në llogarinë e personit të lidhur në lekë në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës shuma 1,378,620 lekë, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “***/***”, me përshkrimin “Shlyerje kontrate datë 7 shtator 09”; (iii) po në datën 8.12.2009, në llogarinë e personit të lidhur në lekë në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës shuma 1,213,185 lekë, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “***”, me përshkrimin “Shlyerje kontrate datë 1.10.2009”.

26.18.73 Sa më sipër, bazuar në deklaratimet e bëra dhe në dokumentacionin e depozituar, duket se personi i lidhur pretendon se ka përfituar të ardhura shërbimet e kryera për institutin “***”, për periudhën para kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, në total vlerat monetare 11,183 euro dhe 2,591,805 lekë.

Në analizë të të gjitha të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë indicie dhe prova të besueshme që tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vitin 2009 ka pasur marrëdhënie financiare me institutin “*” dhe se ka përfituar të ardhura nga shërbimet e kryera për këtë institut.**

26.18.74 Pas kërkesës së bërë nga Komisioni, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit depozitoi kontratat e nënshkruara mes personit të lidhur dhe institutit “***”, të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuara dhe të noterizuara.

26.18.75 Në kushtet kur nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi marrëdhënien e punësimit/shërbimit të bashkëshortes së subjektit me institutin “****” rezultoi se në kontrata është përcaktuar se është mbajtur nga punëdhënësi tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur sipas shkallës tatimore përkatëse – pasi në dokumentet e këtij instituti përcaktohet se personi i lidhur do të përfitonte shumën neto pas mbajtjes së tatimit, si dhe në konsideratë të faktit nga ku provohet se shumat e përfituara kanë kaluar nëpërmjet sistemit bankar, në analizën financiare përfundimtare janë reflektuar të ardhurat nga ky burim.

26.18.76 Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* personi i lidhur ka deklaruar të ardhura të tjera të përfituara nga veprimtari të kryera për palë të treta, si përkthime, konsulenca, ekspertiza etj., kryesisht në sektorin e OJF-ve, të krijuara pas likuidimit të çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësi, si vijon:

26.18.77 *Të ardhura nga fshati* ***: (a) shuma 48,650 lekë, përfituar në datën 22.7.2011, me çek bankar – deklaroi se nuk ka kontratë për këtë rast; (b) shuma 26,000 lekë, përfituar sipas kontratës datës 5.4.2013; (c) shuma 329,815 lekë nga trajnimet për “Gjetje e Fondeve dhe Menaxhimi i Ndryshimit”, sipas tri kontratave të datave 28.10.2013, 14.11.2013 dhe 27.6.2014. Për këto të ardhura referon dokumentin “Statement bankar” të datës 23.12.2013, në Intesa Sanpaolo Bank; (ç) shuma 14,700 lekë, përfituar sipas kontratës datë 9.6.2015, me çek bankar në Credins Bank.

26.18.78 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) në DIPP-në e vitit 2011, subjekti/personi i lidhur nuk ka deklaruar të ardhura nga fshati ***; (ii) në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara prej bashkëshortes nga kryerja e trajnimeve tek fshati *** dhe në palë të treta, shuma e përgjithshme 430,200 lekë; (iii) në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura të përfituara prej saj nga kryerja e trajnimeve për fshatin *** në shumën 103,015 lekë; (iv) në DIPP-në e vitit 2015, subjekti/personi i lidhur nuk ka deklaruar të ardhura nga fshati ***.

26.18.79 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer për fshatin ***, duket se: (i) referuar dokumentit mandat tërheqje me çek nga llogaria e shoqatës “**** fshati i fëmijëve”, i datës 22.7.2011, personi i lidhur ka tërhequr shumën 48,650 lekë; (ii) referuar dokumentit kontratë sipërmarrjeje (shërbimi), datë 5.4.2013, personi i lidhur ka përfituar shumën 26,000 lekë neto; (iii) referuar dokumentit kontratë shërbimi, datë 28.10.2013, personi i lidhur ka përfituar shumën 900 euro; (iv) referuar dokumentit kontratë shërbimi, datë 14.11.2013, personi i lidhur ka përfituar shumën 900 euro; (v) referuar dokumentit kontratë shërbimi, datë 27.6.2014, personi i lidhur ka përfituar shumën bruto 116,200 lekë; (vi) referuar dokumentit kontratë shërbimi, datë 9.6.2015, personi i lidhur ka përfituar shumën bruto 15,000 lekë.

26.18.80 Komisioni konstaton se në datën 19.12.2013, në llogarinë e personit të lidhur pranë Raiffeisen Bank është kredituar shuma 226,800 lekë, me përshkrimin “Fshati *** Trajnim gjetja e fondeve dhe menaxhimi i ndryshimit”.

26.18.81 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁵⁶ rezulton se për muajin qershor 2014 është deklaruar punësimi i personit të lidhur pranë fshatit ***, me pagë neto 103,019 lekë dhe për muajin qershor 2015 është deklaruar punësimi i personit të lidhur pranë fshatit ***, me pagë neto 14,700 lekë.

26.18.82 Në analizën financiare paraprake u reflektuan si të ardhura nga ky burim vetëm të ardhurat e konfirmuara nga shkresa e DRT-së Tiranë, pra ato të cilat janë deklaruar në organin tatimor.

➤ **Me dërgimin e rezultateve të hetimit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dokumentuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e tjera të pretenduara nga marrëdhënia me fshatin ***.**

26.18.83 *Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin ***:* (a) për vitet 2011 – 2012, shuma 110,000 lekë; (b) për vitet 2013, 2015 dhe 2016, shuma 278,410 lekë.

26.18.84 Në vijim të verifikimit të deklarimeve të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, duket se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur ka deklaruar përfitimin e të ardhurave si rezultat i punës së kryer nga personi i lidhur në Universitetin ***, për vitet 2011 – 2013 dhe 2015 – 2016, konkretisht: (i) në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga Universiteti *** për punën si pedagoge në vlerën 55,000 lekë; (ii) në DIPP-në e vitit 2012, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga paga si lektore pranë Universitetit *** dhe të ardhura nga përkthime për organizata të ndryshme, në total shumën 260,000 lekë; (iii) në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura të bashkëshortes nga mësimdhënia në Universitetin ***, në vlerën 154,412 lekë; (iv) në DIPP-në e vitit 2015, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin ***, në vlerën 49,378 lekë; (v) në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga puna si pedagoge në Universitetin ***, të derdhura në llogarinë rrjedhëse nr. ***, në Raiffeisen Bank, në vlerën 82,131 lekë.

26.18.85 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer për Universitetin *** dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstaton se: (i) Referuar lëvizjeve të llogarive të personit të lidhur në ABI Bank rezulton se në datën 20.12.2011 është kredituar shuma 55,000 lekë, me përshkrimin “Kalim nga Universiteti *** tek V.M paga për muajin dhjetor 2011”; (ii) Referuar lëvizjeve të llogarive të personit të lidhur në ABI Bank rezulton se në datën 23.3.2012 është kredituar shuma 55,000 lekë, me përshkrimin “Salary V.M”; (iii) Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga DRT-ja Tiranë konfirmohet se personi i lidhur ka qenë i punësuar pranë Universitetit *** për periudhat dhe pagat si vijon: (a) për periudhën shkurt – maj 2013 ka përfituar pagën në vlerën neto prej 131,601 lekësh; (b) për periudhën tetor – dhjetor 2015 ka përfituar pagën në vlerën neto prej 82,132 lekësh; (c) për periudhën janar – shkurt 2016 ka përfituar pagën në vlerën neto prej 49,379 lekësh; (iv) Referuar lëvizjeve të llogarive të personit të lidhur në Raiffeisen Bank, rezulton se: (a) gjatë vitit 2013 janë kredituar të ardhura nga paga pranë këtij institucioni në shumën 131,601 lekë; (b) gjatë vitit 2015, shuma 49,379 lekë; (c) gjatë vitit 2016, shuma 82,132 lekë.

26.18.86 Në analizën financiare paraprake u reflektuan si të ardhura nga ky burim vetëm të ardhurat e konfirmuara nga shkresa e DRT-së Tiranë, pra ato të cilat janë deklaruar në organin tatimor.

➤ **Me dërgimin e rezultateve të hetimit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dokumentuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e tjera të pretenduara nga marrëdhënia me Universitetin ***.**

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2020, nga DRT Tiranë, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.10.2020.

26.18.87 *Të ardhura nga trajnime/konsulenca për qendrën “****”, në shumën totale neto 156,150 lekë. Në deklarinë e bërë është pasqyruar se këto të ardhura janë përfituar nëpërmjet transfertës bankare në Intesa Sanpaolo Bank, si dhe janë referuar kontratat ref.co: ***/PC: ***, datë 6.3.2013; ref.co: ***/PC: ***, datë 5.9.2013; ref.co: ***/PC: ***, datë 25.1.2014; ref.co: ***/PC: ***, datë 15.11.2014.*

26.18.88 Në vijim të verifikimit të deklarimeve të bëra ndër vite në ILDKPKI, duket se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi lidhur kanë deklaruar përfitimin e të ardhurave si rezultat i punës së kryer nga personi i lidhur për qendrën “****”, për vitet 2013 dhe 2014, konkretisht: (i) në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara prej bashkëshortes së tij nga kryerja e trajnimeve tek Q.R.M dhe fshatit ***, në total shumën 430,200 lekë; (ii) në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur ka deklaruar shumën e të ardhurave prej 73,350 lekësh, përfituar nga trajnimet për qendrën “****” (Q.R.M).

26.18.89 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer (trajnimet) për qendrën “****”, duket se: (i) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Contract of Services”, datë 6.3.2013, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të qendrës “****”, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 42,000 lekë, nga e cila do të mbahet tatimi në burim në masën 10% të shumës; (ii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Contract of Services”, datë 5.9.2013, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të qendrës “****”, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 50,000 lekë, nga e cila do të mbahet tatimi në burim në masën 10% të shumës; (iii) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Contract of Services”, datë 5.1.2014, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të qendrës “****”, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 31,500 lekë, nga e cila do të mbahet tatimi në burim në masën 10% të shumës; (iv) Referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Contract of Services”, datë 15.11.2014, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të qendrës “****”, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 50,000 lekë, nga e cila do të mbahet tatimi në burim në masën 10% të shumës.

26.18.90 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në llogarinë e personit të lidhur pranë Intesa Sanpaolo Bank gjatë vitit 2013 është kredituar shuma 82,800 lekë, ndërsa gjatë vitit 2014 është kredituar shuma 73,350 lekë, në total 156,150 lekë.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie* dhe prova të besueshme që tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vitet 2013 dhe 2014 ka pasur marrëdhënie financiare me qendrën “**” dhe se ka përfituar të ardhura nga shërbimet e kryera për këtë subjekt.**

26.18.91 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi dokumentacionin e plotë të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar, që lidhet me marrëdhënien e punësimit/shërbimit të personit të lidhur me qendrën “****”.

26.18.92 Në kushtet kur nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi marrëdhënien e punësimit/shërbimit të bashkëshortes së subjektit me qendrën “****” rezultoi se në marrëveshje/kontratë është përcaktuar se është mbajtur nga punëdhënësi tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur sipas shkallës tatimore përkatëse, në analizën financiare u reflektuan të ardhurat nga ky burim.

26.18.93 *Të ardhura nga trajnimi për qendrën “****”, në shumën 8,500 lekë, përfituar në shtator të vitit 2015. Subjekti/personi i lidhur ka deklaruar se nuk e disponon kontratën, por se ka nisur email për të marrë një kopje të saj.*

26.18.94 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2013 personi i lidhur ka deklaruar të ardhura të përfituara nga trajnimet e kryera për qendrën “****”, në shumën 8,500 lekë (shtator 2015).

➤ **Në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor dhe provueshmërisë së pagesës së detyrimeve tatimore mbi përfitimin e këtyre të ardhurave, në analizën financiare paraprahe nuk janë reflektuar të ardhura nga ky burim. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.**

26.18.95 *Të ardhura nga ***, kaluar nëpërmjet sistemit bankar (Intesa Sanpaolo Bank), datë 17.10.2014, në total shuma 107,222 lekë. Subjekti/personi i lidhur ka deklaruar se nuk disponon kontratë dhe as dokumente të tjera.*

26.18.96 Referuar DIPP-së së vitit 2014, duket se subjekti dhe/apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar të ardhura të përfituara prej personit të lidhur si rezultat i punës/shërbimit të kryer për ***.

26.18.97 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në llogarinë e personit të lidhur pranë Intesa Sanpaolo Bank gjatë vitit 2014 është kredituar cash shuma 107,222 lekë, me përshkrimin “Cash deposit E.M pagesë nga ***”.

➤ **Në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor dhe provueshmërisë së pagesës së detyrimeve tatimore mbi përfitimin e këtyre të ardhurave, në analizën financiare paraprahe nuk janë reflektuar të ardhura nga ky burim. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.**

26.18.98 *Të ardhura nga konsulenca për qendrën “****”: (i) për vitin 2011, shuma 7,200 lekë, nga shërbimi/moderimi i takimit “Të rinjtë dhe biznesi i riciklimit” (kontratë datë 1.4.2011); (ii) për vitin 2014, shuma 81,000 lekë, përfituar me pagesë përmes Intesa Sanpaolo Bank, sipas kontratës përkatëse.*

26.18.99 Nga verifikimi i deklarimeve të bëra ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur kanë deklaruar përfitimin e të ardhurave si rezultat i punës së kryer nga personi i lidhur për qendrën “****” vetëm për vitin 2014, konkretisht: Në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga konsulenca për qendrën “****”, në shumën 81,000 lekë.

26.18.100 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer (konsulenca) për qendrën “****”, duket se: (i) Referuar dokumentit “Kontratë shërbimi” datë 1.4.2011, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të qendrës “****”, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 8,000 lekë, nga e cila do të mbahet tatimi në burim në masën 10% të shumës; (ii) Referuar dokumentit “Kontratë shërbimi” datë 13.12.2013, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të qendrës “****”, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 90,000 lekë, nga e cila do të mbahet tatimi në burim në masën 10% të shumës.

26.18.101 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në llogarinë e personit të lidhur pranë Intesa Sanpaolo Bank, gjatë vitit 2013 është kredituar shuma 81,000 lekë.

26.18.102 Në kushtet kur nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi marrëdhënien e punësimit/shërbimit të bashkëshortes së subjektit me qendrën “***” rezultoi se në marrëveshje/kontratë është përcaktuar se është mbajtur nga punëdhënësi tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur sipas shkallës tatimore përkatëse, në analizën financiare paraprahe janë reflektuar të ardhurat nga ky burim.

26.18.103 *Të ardhura nga konsulenca për B.B:* (i) për vitin 2012, të ardhurat nga kontrata e muajit qershor 2012, në shumën 150,000 lekë, përfutuar nëpërmjet transfertës bankare në Intesa Sanpaolo Bank; (ii) të ardhurat nga kontrata e vitit 2014, në shumën 375,000 lekë, përfutuar nëpërmjet transfertës bankare në Intesa Sanpaolo Bank.

26.18.104 Nga verifikimi i deklarimeve të bëra ndër vite në ILDKPKI, duket se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur kanë deklaruar përfitimin e të ardhurave si rezultat i punës së kryer nga personi i lidhur për B.B, për vitet 2012 dhe 2014, konkretisht: (i) në DIPP-në e vitit 2012, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura të përfituara nga konsulenca për projekte të ndryshme në të cilat punon ose është e kontraktuar, në vlerën 7,743 euro, por duket se subjekti nuk ka bërë sqarim të mëtëjshëm në lidhje me punëdhënësit konkretë; (ii) në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura të përfituara nga konsulenca për B.B, në shumën 375,000 lekë.

26.18.105 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer (konsulenca) për B.B, duket se: (i) referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Leter of appointment for short term consultant”, datë 4.6.2012, duket se personi i lidhur është dakordësuar që për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë dokument do të përfitonte shumën neto prej 15,000 lekësh/ditë *10 ditë pune; (ii) referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Letër of appointment for short term consultant”, datë 23.5.2014, duket se personi i lidhur është dakordësuar që për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë dokument do të përfitonte shumën neto 15,000 lekë/ditë * 25 ditë pune.

26.18.106 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në Intesa Sanpaolo Bank, në datën 28.6.2012, është transferuar shuma 150,000 lekë, me dërgues (urdhërues) të identifikuar I.B, me përshkrimin “*** FEE Payment” dhe në datën 31.7.2014 është transferuar shuma 375,000 lekë, me dërgues (urdhërues) të identifikuar I.B, me përshkrimin “*** FEE Payment”.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie* dhe prova të besueshme që tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vitet 2012 dhe 2014 ka pasur marrëdhënie financiare me B.B dhe se ka përfutuar të ardhura nga shërbimet e kryera për këtë subjekt.

26.18.107 Në kushtet kur nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi marrëdhënien e punësimit/shërbimit të bashkëshortes së subjektit me B.B rezultoi se në kontratë është përcaktuar se shpërblimi i punëmarrësit (personit të lidhur) do të jetë në vlerë neto nga tatimi (në ditë), në analizën financiare përfundimtare janë reflektuar të ardhurat nga ky burim.

26.18.108 *Të ardhura nga konsulenca për kompaninë “***”*, në shumën 11,979 euro, me kontratën përkatëse, pagesat e kryera përmes Raiffeisen Bank.

26.18.109 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura të përfituara nga konsulenca për kompaninë “***” shumën 84,000 lekë.

➤ **Duket se ka mospërputhje mes shumës së të ardhurave të deklaruara në DIPP-në vjetore të vitit 2014 dhe atyre të deklaruara në deklaratën *Vetting*, me burim nga konsulenca e dhënë nga personi i lidhur për subjektin “***”.**

26.18.110 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer për kompaninë “***”,

duket se referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Short Term Consultancy Agreement”, datë 7.3.2012, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të kompanisë “****”, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 12,000 euro, e cila do të ndahet në 120 ditë pune me nga 100 euro/ditë.

26.18.111 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank: (i) në datën 21.6.2012 është transferuar shuma 850 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “****”, me përshkrimin “Inv May, Apr, may 12”; (ii) në datën 8.10.2012 është transferuar shuma 2,950 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “****”, me përshkrimin “SEP 12”; (iii) në datën 7.3.2013 është transferuar shuma 1,850 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “****”, me përshkrimin “Oct 12 – Feb 13”; (iv) në datën 20.5.2013 është transferuar shuma 2,479 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “****”; (v) në datën 18.11.2013 është transferuar shuma 3,150 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “****”, me përshkrimin “Invoice no amount paid 2013.11.12 May – Oct 13, 3,150”; (vi) në datën 27.2.2014 është transferuar shuma 600 euro, me dërgues “****”, me përshkrimin “Fee note nov. Dec. 2013”; (vii) në datën 26.6.2014 është transferuar shuma 100 euro, me dërgues “****”, me përshkrimin “Invoice no amount paid 2014.6.16 january 2014, 100”. Rezulton se në total shumat e transferuara në llogari të personit të lidhur janë 11,979 euro.

26.18.112 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi në formën e kërkuar nga ligji kontratën që lidhet me marrëdhënien e punësimit/shërbimit të personit të lidhur me kompaninë “****”. Rezulton se në këtë kontratë përcaktohet se taksat/pagesat e sigurimeve shoqërore dhe pensionet sociale në vendin e rezidentit janë tërësisht përgjegjësi e punëmarrësit (konsulentit).

➤ **Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dokumentuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga marrëdhënia e punësimit/shërbimit me kompaninë “****”.**

26.18.113 *Të ardhurat nga trajnimet për **** (D.M.O)* sipas kontratës së vitit 2014, si dhe për vitin 2015, duke sugjeruar t’i referohemi *statementit*-it bankar të Raiffeisen Bank për transfertën dhe deklarin periodik për vitin 2015. Në total deklaroi se ka përfituar shumën e të ardhurave prej 270 euro. Personi i lidhur deklaroi se kontratën nuk e posedon, por se ka paraqitur dy *email*-e me komunikime për të disponuar kontratën.

26.18.114 Komisioni konstaton se: (i) në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga DMO-ja në vlerën 37,800 lekë; (ii) në DIPP-në e vitit 2015, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura të përfituara në vlerën 270 euro (të derdhura në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank) sipas një kontrate, por duket se personi i lidhur nuk ka bërë sqarim të mëtjetshëm në lidhje me punëdhënësit konkretë.

26.18.115 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank, gjatë vitit 2015 është kredituar me transfertë shuma 270 euro, por nuk evidentohet pala dërguese - urdhëruese e këtij transaksioni.

26.18.116 Në vijim, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ****, subjekti ka depozituar si provë të re dokumentin “Kontratë shërbimi”, datë 1.12.2014, në referim të së cilës për ofrimin e shërbimeve (konsulencës) personi i lidhur paguhet me shumën 300 euro dhe se për këto të ardhura do t’i mbahet në burim nga punëdhënësi tatimi, sipas legjislacionit në fuqi – në masën 10%.

26.18.117 Në kushtet kur nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi marrëdhënien e punësimit/shërbimit të bashkëshortes së subjektit me DMO rezultoi se në kontratë është përcaktuar se do të mbahet nga punëdhënësi tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga personi i

lidhur sipas shkallës tatimore përkatëse, në analizën financiare paraprake janë reflektuar të ardhurat nga ky burim.

26.18.118 Të ardhura të përfituara nga kontrata e konsulencës me shoqërinë “* I.E.S Gmbh”, datë 12.1.2011, për punë në lidhje me landfillin Durrës, në shumën 1,900 euro, pagesat e kryera përmes Intesa Sanpaolo Bank.**

26.18.119 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga bashkëshortja për punë të kryer për shoqërinë “***”, në shumën 1,450 euro.

➤ **Pra, duket se ka mospërputhje mes shumës së të ardhurave të deklaruar në DIPP-në vjetore të vitit 2011 dhe atyre të deklaruar në deklaratën Vetting, me burim nga konsulenca e dhënë nga personi i lidhur për subjektin “*** I.E.S Gmbh”.**

26.18.120 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruar me burim nga puna e kryer për shoqëria “*** I.E.S Gmbh”, duket se: (i) referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë me titull “Consultant Agreement”, datë 12.1.2011, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të shoqërisë “*** I.E.S Gmbh”, duket se palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 25 euro/orë * 8 orë në ditë; (ii) referuar dokumentit në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë “Invoice nr. ***”, datë 3.5.2011, në shumën 800 euro/32 orë pune; (iii) referuar dokumentit në gjuhë të huaj “Invoice”, datë 31.5.2011, në shumën 550 euro; (iv) referuar dokumentit “Invoice nr. ***”, datë 6.6.2011, në shumën 550 euro.

26.18.121 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në datën 22.6.2011 në llogarinë e personit të lidhur në Intesa Sanpaolo Bank është transferuar shuma 550 euro, me dërgues të paidentifikuar dhe pa përshkrim specifik.

26.18.122 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi në formën e kërkuar nga ligji, të përkthyer në gjuhën shqipe, të njësuar dhe të noterizuar, kontratën/marrëveshjen e punësimit/shërbimit të personit të lidhur me shoqërinë “*** I.E.S Gmbh”. Gjithsesi, duket se në këtë marrëveshje/kontratë është përcaktuar se konsulenti pranon se do të deklarojë dhe paguajë në mënyrë të duhur çdo taksë dhe detyrim sipas ligjit në fuqi.

➤ **Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dokumentuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga marrëdhënia e punësimit/shërbimit me shoqërinë “*** I.E.S Gmbh”.**

26.18.123 Pagesë e përfituar nga shoqata “*”, në shumën 100 USD. Deklaron se nuk disponon kontratë dhe referon deklarin periodik vjetor të vitit 2011.**

26.18.124 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2011 personi i lidhur ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shoqata “***”, në vlerën 100 USD.

➤ **Në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor dhe provueshmërisë së pagesës së detyrimeve tatimore mbi përfitimin e këtyre të ardhurave, në analizën financiare paraprake nuk janë reflektuar të ardhura nga ky burim. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.**

26.18.125 Të ardhura të përfituara nga organizata “*”, në shumën 1,800 euro, me kontratë shërbimi nr. ***, datë 30.6.2011. Referon se pagesa është kryer përmes Raiffeisen Bank.**

26.18.126 Në vijim të verifikimit të deklarimeve të bëra ndër vite në ILDKPKI, duket se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 përfitimin e të ardhurave si rezultat i punës së kryer nga personi i lidhur për organizatën “***”.

26.18.127 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer për organizatën “***”, duket se referuar dokumentit në gjuhë të huaj “Service contract nr. ***, consultant services: local Expert”, datë 30.6.2011, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të organizatës “***”, palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 100 euro/ditë * 20 ditë.

26.18.128 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në datën 28.6.2012, në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës shuma 1,800 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “***” dhe me përshkrimin “Pagesë për shërbime konsulence V.M”.

26.18.129 Në vijim, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit depozitoi në formën e kërkuar nga ligji kontratën që lidhet me marrëdhënien e punësimit/shërbimit të personit të lidhur me organizatën “***”, në referim të së cilës përcaktohet se tatimi i mbajtur në burim në masën 10% do të paguhet drejtpërdrejtë nga punëdhënësi (marrësi i shërbimit).

26.18.130 Për sa më sipër, në kushtet kur nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi marrëdhënien e punësimit/shërbimit të bashkëshortes së subjektit me organizatën “***” rezultoi se në kontratë është përcaktuar se do të mbahet nga punëdhënësi tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur sipas shkallës tatimore përkatëse, në analizën financiare janë reflektuar të ardhurat nga ky burim.

26.18.131 *Të ardhurat nga kontrata e datës 22.6.20016, me shoqërinë “***”, në shumën 9,753 euro (Lothringerstrasse ***, ***, Vienna, Austria, HR Wien FN ***, UID ATU ***), projekti “***” i BE-së.* Subjekti/personi i lidhur ka depozituar kopjen e kontratës datë 22.2.2016, ***, disa Invoice; referon se pagesat janë bërë me bankë, kryer në tri këste në datat 1.7.2016, 31.8.2016 dhe 18.10.2016.

26.18.132 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2016 personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga kontrata me shoqërinë “***”, derdhur në llogarinë rrjedhëse nr. ***, në Raiffeisen Bank, shuma 9,753 euro.

26.18.133 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna apo shërbimi i kryer për shoqërinë “***”, duket se: (i) referuar dokumentit në gjuhë të huaj “Services agreement”, datë 22.2.2016, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të shoqërisë “***”, për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë dokument personi i lidhur do të përfitonte shumën 140 euro/ditë; (ii) referuar dokumentit në gjuhë të huaj “Invoice nr. ***”, datë 1.6.2016, është përcaktuar një pagesë prej 2,100 euro, 140 euro/ditë * 15 ditë pune; (iii) referuar dokumentit në gjuhë të huaj “Invoice nr. ****”, datë 25.7.2016, është përcaktuar një pagesë prej 3,500 euro, 140 euro/ditë * 25 ditë pune.

26.18.134 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank: (i) në datën 1.7.2016 është transferuar shuma 2,100 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “***”, me përshkrimin “DOC/***/***/***”; (ii) në datën 31.8.2016 është transferuar shuma 3,459 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “***”, me përshkrimin “DOC/***/***/***”; (iii) në datën 18.10.2016 është transferuar shuma 4,194 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “***”, me përshkrimin “FEES JULY – SEPTEMBER/***”. Totali i të ardhurave të transferuara në llogarinë e personit të lidhur në vlerën 9,753 euro.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se ekzistojnë *indicie* dhe prova të besueshme që tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vitin 2016 ka pasur marrëdhënie financiare me shoqërinë “****” dhe se ka përfituar të ardhura nga puna/shërbimet e kryera për këtë subjekt.

➤ Por, duket se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji për përfitimin e këtyre të ardhurave dhe nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore mbi to. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këto konstatime.

26.18.135 Të ardhura nga projekti “****”, trajnuese për llogari të subjektit “****” (ish-ITAP), mbi trajnimin e bashkive për administrimin e mbetjeve, përfituar nëpërmjet transfertës bankare të datës 18.3.2016, në shumën 108 euro. Deklaron se nuk disponon kontratë.

26.18.136 Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2016 personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga trajnimi i DLDP-së, të cilat i janë derdhur në llogaritë rrjedhëse në lekë dhe euro nr. *** në Raiffeisen Bank, në shumat 15,300 lekë dhe 108 euro.

26.18.137 Duket se ka mospërputhje mes shumës së të ardhurave të deklaruara në DIPP-në vjetore të vitit 2011 dhe atyre të deklaruara në deklaratën *Vetting*, me burim nga konsulenca e dhënë nga personi i lidhur për subjektin “****”.

26.18.138 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se: (i) në datën 18.3.2016, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank është kredituar nëpërmjet transfertës shuma 108 euro, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “****”, me përshkrimin “DOC/****”; (ii) në datën 20.7.2017 është transferuar shuma 15,300 lekë, me dërgues (urdhërues) të identifikuar “****”, me përshkrimin “Service agreement, training delivery”.

➤ Në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor dhe provueshmërisë së pagesës së detyrimeve tatimore mbi përfitimin e këtyre të ardhurave, në analizën financiare paraprake nuk janë reflektuar të ardhura nga ky burim. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.

Dieta nga Q.K.F, transferuar në bankë në datën 21.11.2014, shuma e të ardhurave 8,989 lekë

26.18.139 Në vijim të verifikimit të deklarimeve të bëra ndër vite në ILDKPKI, duket se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar përfitimin e të ardhurave si rezultat i punës së kryer nga personi i lidhur për Q.K.F. Referuar dokumentacionit bankar të administruar në dosje konfirmohet se në datën 21.11.2014, në llogarinë e personit të lidhur pranë Intesa Sanpaolo Bank kreditohet shuma 8,989 lekë, me përshkrimin “QKK Fëmijëve, dieta me jashtë urdhër drejtori nr. ***, datë 17.10.2014”.

26.18.140 Pas kërkesës së bërë nga Komisioni, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti ka depozituar dokumentacion financiar mbi përfitimin e kësaj shume – në referim të të cilit duket se kjo shumë ka shërbyer për mbulim shpenzimesh dhe, si e tillë, nuk mund të reflektohet si e ardhur në analizën financiare.

26.18.141 *Të ardhura nga *** Albania* për vitin 2013, në total në shumën 873 euro, përfituar me kontratën nr. ***, datë 25.3.2013, me dy transfertë bankare në Raiffeisen Bank.

26.18.142 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2013 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura nga projekte të ndryshme si ***, *** dhe *** Albania, në shumën totale 8,800 euro, por pa përcaktuar shumën e përfituar specifikisht për secilin projekt.

26.18.143 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti me qëllim provueshmërinë e të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e kryer për *** Albania, duket se referuar dokumentit “Kontrata nr. ***”, datë 25.3.2013, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të *** Albania palët janë dakordësuar që personi i lidhur për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në marrëveshje të përfitojë shumën 870 euro, nga të cilat vlera 10% do të mbahet si tatim në burim.

26.18.144 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit konfirmohet se në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank: (i) në datën 1.10.2013 është transferuar shuma 783 euro, me dërgues “*** Albania” sh.p.k., me përshkrimin “Pague honorarë për projektin ***”; (ii) në datën 14.01.2013 është transferuar shuma 90 euro me dërgues “*** Albania” sh.p.k., me përshkrimin “Pague honorarë për konsulencë”.

26.18.145 Për sa më sipër, në kushtet kur nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi marrëdhënien e punësimit/shërbimit të bashkëshortes së subjektit me *** Albania rezultoi se në kontratë është përcaktuar se do të mbahet nga punëdhënësi tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur sipas shkallës tatimore përkatëse, në analizën financiare janë reflektuar të ardhurat nga ky burim.

Qëndrimi i subjektit mbi analizën e të ardhurave pas dërgimit të rezultateve të hetimit

26.18.146 Nëpërmjet prapësimeve subjekti ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor nëpërmjet të cilit kërkon të provojë përfitimin e të ardhurave nga puna e kryer prej bashkëshortes së tij në fondacionin “****”, për vitet 2010 dhe 2011. Ndërsa, sa i përket të ardhurave nga paga për periudhën para vitit 2010, subjekti ka pretenduar se mospagimi i detyrimeve tatimore në lidhje me këto të ardhura të krijuara prej bashkëshortes së tij nga puna si konsulente lokale nuk ka pasur si synim fshehjen e tyre, por ka qenë i kushtëzuar nga rrethanat e kohës dhe formës juridike të cilën kishte zgjedhur ky fondacion, i cili ka operuar në Shqipëri fillimisht sipas kuadrit ligjor të kohës, ligjit nr. 7695, datë 7.4.1993, “Për fondacionet”, duke operuar vetëm me miratimin e funksionimit nga AKM-ja, të zyrës lokale të fondacionit “****” në Shqipëri. Ndërkohë, me ligjin e ri “Për organizatat jofitimprurëse”, nr. 8788, datë 7.5.2001, do të duhej që bordi drejtues i fondacionit “****” në Holandë të mblidhej dhe të autorizonte regjistrimin në gjykatë, sepse ata ishin themeluesit e OJF-së, vetëm ata mund të autorizonin dikë për të kryer veprimet për regjistrim në Shqipëri dhe pikërisht ky regjistrim ndodhi në fund të vitit 2009. Në mungesë të një vendimi gjyqësor, nuk mund të vijohej me regjistrimet në Institutin e Sigurimeve Shoqërore për efekt të pagimit të sigurimeve shoqërore, të atyre shëndetësore dhe as në Drejtorinë Rajonale Tatimore, për efekt të pagimit si subjekt të tatimeve për atë vetë dhe stafin e punësuar aty. Për më tepër, subjekti ka pretenduar se edhe nëse konsiderohet se bashkëshortja e tij do të ishte e gatshme të paraqitej në institucionet shtetërore për të shlyer detyrimet përkatëse mbi këto të ardhura, sipas ligjit të kohës “Për tatimin mbi të ardhurat”, pavarësisht se të ardhurat e saj vjetore nuk e tejkalonin vlerën 2,000,000 lekë/vit, parë kjo në këndvështrimin se mund të ishte subjekt deklarues për fashën e të ardhurave deri në shumën 1,050,000 lekë, ajo praktikisht nuk do të ishte e mundur në mungesë të formularëve të deklarimit, të cilat janë miratuar vetëm me ndryshimet e nenit 13/7 në të cilën citohet “Dorëzimi i deklaratës”, parashikon: “1. Deklarata dorëzohet në drejtorinë tatimore rajonale më të afërt me vendbanimin e tatimpaguesit, dorazi, me postë apo në rrugë elektronike. 2. Deklarata hartohet sipas formularit të miratuar me udhëzim të ministrit të Financave (ndryshuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010, Fl. Z. nr. 159, datë 3 dhjetor 2010)”.

26.18.147 Për më tepër, subjekti ka ritheksuar se referuar nenit 40 të ligjit nr. 8888, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, parashikohet: *“Organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga format e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, që realizojnë nga dhurimet, grantet, interesat bankarë dhe kuotat e anëtarësisë. Organizatat jofitimprurëse, që kryejnë veprimtari ekonomike në përputhje me nenin 36 të këtij ligji, i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat, vetëm në rast se të ardhurat e realizuara nuk destinohen për veprimtari, për të cilat organizata është regjistruar”*.

26.18.148 Komisioni vëren se edhe sa i përket të ardhurave të tjera të përfituara nga puna/shërbimi i kryer për persona të tjerë juridikë për të cilët nuk ka të dhëna/nuk është provuar pagesa e detyrimit tatimor mbi të ardhurat e përfituara, duket se subjekti në parashtrimet e tij kundërshton rezultatet e hetimit, duke argumentuar se: (i) së pari, kryesisht këto organizata kanë qenë të regjistruara si OJF dhe, si të tilla, kanë qenë të përjashtuara nga detyrimet tatimore; (ii) së dyti, marrëdhënia e bashkëshortes së tij me to ka qenë e kategorizuar si një marrëdhënie shërbimi e, në këtë kontekst, detyrimi për mbajtjen dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat i takonte këtyre personave juridikë; (iii) së treti, ligji për tatimin mbi të ardhurat nuk detyronte personin e lidhur për të qenë subjekt deklarues, për sa kohë nuk tejkalonte të ardhurat mbi 2 milionë lekë/vit, në dukje duke referuar se deklarata individuale e të ardhurave kërkonte deklarimin e tyre për vlerën mbi 2 milionë lekë dhe se ajo e ka filluar efektin në vitin 2011; (iv) së fundmi, të ardhurat e përfituara prej saj nga personat juridikë të regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk mund t’i nënshtrohen tatimit të dyfishtë. Në mbështetje të këtij pretendimi subjekti ka depozituar si provë të re shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me nr. *** prot., datë 15.11.2023, në referim të së cilës, ndër të tjera, citohet: *“...Të ardhurat personale të përfituara nga shoqëritë jorezidente në Republikën e Shqipërisë: “***” (rezidente në Holandë; “***”; “***”; “***”; “***/***” (rezidente në Austri); “***/I.H” (rezidente në Austri); “***” (rezidente në Austri); “***” (rezidente në Danimarkë); “***” – Projekti *** (rezidente në Austri), nuk i nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”*.

26.18.149 Gjithashtu, nëpërmjet prapësimeve subjekti ka depozituar dokumentacion shtesë që lidhet me disa nga burimet e të ardhurave të analizuara si më sipër.

Vlerësimi i Komisionit/analiza e shpjegimeve, provave dhe ligjit të zbatueshëm

26.18.150 Në vlerësimin dhe shqyrtimin përfundimtar të shpjegimeve të dhëna nga subjekti nëpërmjet prapësimeve të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni vëren se dokumentacioni i depozituar nga subjekti për të ardhurat e përfituara nga puna e personit të lidhur në fondacionin “***” për vitet 2010 dhe 2011 përmbush kushtet e përcaktuara në nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, këto të ardhura do të reflektohen në analizën financiare përfundimtare.

26.18.151 Ndërsa sa i përket pretendimit për të ardhurat e përfituara nga puna e personit të lidhur me fondacionin “***”, për periudhën para vitit 2010, si dhe të ardhurat e tjera nga marrëdhënia e punës/shërbimit me persona juridikë të regjistruar brenda dhe jashtë territorit shqiptar, Komisioni vlen të evidentojë se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është ligji bazë mbi të cilin rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat në tri kategori kryesore: (i) tatimi mbi të ardhurat personale; (ii) tatimi mbi fitimin; (iii) tatimi i mbajtur në burim i të ardhurave. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit në fuqi.

26.18.152 Në nenin 4 të këtij ligji, “Burimi i të ardhurave”, janë përcaktuar llojet e të ardhurave të realizuara nga një burim në Republikën e Shqipërisë, por pa u kufizuar vetëm në to dhe dy nga kategoritë e këtyre të ardhurave janë të ardhurat e parashikuara në shkronjën “a”, të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë; dhe në shkronjën

“b”, të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë.

26.18.153 Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat për kategoritë e të ardhurave personale shtrihet mbi të ardhurat e individëve (neni 6), të cilët janë rezidentë në kuptim të Kodit Civil dhe në kuptim të nenit 7 të ligjit të sipërcituar i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu.

26.18.154 Për sa më sipër, si dhe bazuar në parashikimet e nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Komisioni vlerëson se të ardhurat e referuara si të përfituara nga personi i lidhur në funksion punës së kryer për fondacionin “***” sh.p.k., si dhe nga marrëdhënia e shërbimit me persona juridikë të tjerë të regjistruar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të ardhura të tatueshme.

26.18.155 Në vijim të këtij arsyetimi, Komisioni vlerëson se për sa kohë këto të ardhura janë përfituar nga marrëdhënia e punës/shërbimit të personit të lidhur si rezident në Republikën e Shqipërisë, ligji kërkon që mbi to të mbahet dhe paguhet detyrimi tatimor – tatimi mbi të ardhurat.

26.18.156 Në këto rrethana, si dhe në kushtet kur në disa prej kontratave/shkresave të nënshkruara mes bashkëshortes së subjektit dhe personave juridikë të lidhura me marrëdhënie shërbimi – referohet se tatimi është mbajtur në burim prej tyre, trupi gjykues çmon të vlerësojë këto marrëdhënie bazuar në legjislacionin tatimor shqiptar, duke bërë ndarjen mes të ardhurave të përfituara nga marrëdhëniet e shërbimit me persona juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me të ardhurat e përfituara nga persona juridikë në dukje të regjistruar jashtë territorit shqiptar.

26.18.157 Komisioni vëren se në referim të shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 33 të këtij ligji, “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë në burim në masën 10%⁵⁷ (e më pas me 15% sipas ndryshimeve të bëra) nga shuma bruto e pagesave, edhe mbi pagesat për ndërtim, instalim, montim ose për punë mbikëqyrëse, që lidhen me to.

26.18.158 Ndërsa, në pikën 5.1 të Udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcaktohet se në zbatim të nenit 33 të ligjit (i referohet ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”), të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë, tregtarë, rezidentë, tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjërës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

26.18.159 Referuar shkronjës “c” të nenit 5 të ligjit nr. 9920, 19.5.2009, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Agjent i mbajtjes së tatimit në burim” është personi, të cilit, sipas legjislacionit tatimor, i kërkohet të llogarisë, të mbajë tatimin në burim për një tatimpagues, të raportojë dhe t’i transferojë këto tatime në buxhetin e shtetit.

26.18.160 Në nenin 7 të këtij ligji janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit në burim ku, ndër të tjera, parashikohet se agjenti i mbajtjes së tatimit ka detyrë të llogarisë saktësisht dhe të mbajë në burim tatimin për një tatimpagues, si dhe të paguajë tatimin në burim në buxhetin e shtetit në datën e përcaktuar në ligj, ndërsa në nenin 117 përcaktohen

⁵⁷ Dispozita në fuqi në kohën e nënshkrimit dhe zbatimit të pjesës më të madhe të kontratave të shërbimit: “Sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar” (neni 16 i këtij ligji)”.

dënimet/penalitetet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, në rast të mospërmbushjes së këtyre detyrimeve ligjore.

26.18.161 Nga vlerësimi në harmoni i dispozitave të referuara si më sipër – në kushtet kur rezultoi e provuar se znj. V.M (Sh) i ka lidhur këto kontrata shërbimi si individ, Komisioni arrin përfundimin se mbajtja, deklarimi dhe pagesa e tatimit në burim ka qenë detyrim i personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, të cilët në këtë rast luajnë rolin e agjentit të mbajtjes së tatimit në burim.

26.18.162 Lidhur me mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim nga këta persona juridikë, Komisioni vëren se personi i lidhur ka bërë përpjekje për të siguruar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, por duket se në kuptim të neneve 24, 25 dhe 31 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk është legjitimuar për të disponuar këtë informacion⁵⁸.

26.18.163 Si konkluzion, bazuar në analizën ligjore të kryer si më sipër, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e përfituara nga personi tjetër i lidhur, znj. V.M (Sh), si rezultat i shërbimit të kryer në favor të personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, janë të ardhura të ligjshme dhe, si të tilla, do të vlerësohen si të ardhura të mundshme për krijimin e pasurive apo për kryerjen/mbulimin e shpenzimeve nga subjekti dhe personi i lidhur ndër vite. Në këtë konkluzion, Komisioni është bazuar edhe në të gjitha provat e administruara lidhur me këto të ardhura ku evidentohet përfitimi i tyre kryesisht nëpërmjet sistemit bankar. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se këto të ardhura janë deklaruar periodikisht në deklaratat e interesave privatë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, duke u vlerësuar këto të fundit si prova për efekt të këtij procesi, në kuptim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

26.18.164 Sa i përket pretendimit të subjektit për të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e shërbimit me persona juridikë në dukje të regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë – në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e tatimeve, si dhe në kushtet kur rezultoi e provuar se ato janë përfitur nga personi i lidhur si individ rezident në territorin shqiptar, Komisioni arrin në përfundimin se personi i lidhur ka pasur detyrimin për pagesën e tatimit mbi to. Në këtë kontest, si dhe në shqyrtim të pretendimit tjetër të subjektit se për një periudhë të caktuar kohe këto nuk mund të deklaroheshin dhe, si rrjedhojë, nuk kishte mundësi të paguante tatimin përkatës – për sa kohë nuk kalohej kufiri minimal i deklarimit prej 2 milionë lekësh sipas ligjit, trupi gjykues argumenton se moskalimi i kufirit të deklarimit nuk do të thotë që të ardhurat e përfituara nuk i nënshtrohen tatimit. Nga ana tjetër, nuk duket se këto të ardhura t’i jenë nënshtuar tatimit në vendin e origjinës së tyre. Për më tepër, mbi pretendimin e ngritur për shmangien e tatimit të dyfishtë, i pyetur në seancë dëgjimore subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk ka informacion dhe/apo të dhëna për pagesën e tatimit mbi këto të ardhura në vendin e origjinës.

26.18.165 Parë në këtë optikë, megjithëse nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit shkresor të administruar në dosje rezultoi e provuar se gjithsesi këto të ardhura kanë rrjedhur nga një burim i ligjshëm, trupi gjykues çmon se ato nuk përmbushin kërkesat e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, nuk janë përfshirë në analizën financiare përfundimtare.

26.18.166 Për sa më sipër, në vlerësim të prapësimeve të bëra nga subjekti, provave shtesë të depozituara, shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, si dhe bazuar në analizën ligjore të kryer mbi burimet e të ardhurave, Komisioni reflektoi disa ndryshime në analizën financiare përfundimtare, të cilat gjenin mbështetje në dokumentacion justifikues ligjor, duke vlerësuar sa vijon: (i) për vitet 2010 dhe 2011 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 1,576,176 lekë (për vitin 2010, shumën 1,374,036 dhe për vitin 2011, shumën 202,140 lekë) bazuar në të dhënat e pasqyruara në vërtetimin e lëshuar nga ISSH-ja me nr. ***

⁵⁸ Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 13.11.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të depozituar nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

prot., datë 6.11.2023; (ii) për vitet 2008 dhe 2009 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 56,863 lekë (për vitin 2008, shumën 26,000 lekë dhe për vitin 2009, shumën 30,863 lekë), vlerësuar si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej marrëdhënies së shërbimit me shoqërinë “****”, për të cilat, bazuar në shkresën e kësaj qendre, me nr. *** prot., datë 6.11.2023, janë mbajtur dhe paguar detyrimet tatimore; (iii) për vitin 2008 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 77,500 lekë, vlerësuar si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej marrëdhënies së shërbimit me “****” (I.R.N në Shqipëri), për të cilën, bazuar në shkresën e këtij instituti, të datës 2.11.2023, janë mbajtur dhe paguar detyrimet tatimore; (iv) për vitin 2008 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 29,700 lekë, vlerësuar si të përfituar nga bashkëshortja e subjektit prej marrëdhënies së shërbimit me “****” (I.T.A.), për provueshmërinë e së cilës subjekti ka depozituar si provë të re kontratën e shërbimit nr. *** prot., datë 17.11.2008, dhe dokumentacion financiar që lidhet me të; (v) për vitet 2011 dhe 2012 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 110,000 lekë (për vitin 2010, shumën 55,000 lekë dhe për vitin 2011, shumën 55,000 lekë), vlerësuar si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej marrëdhënies së shërbimit me Universitetin **, për të cilën, bazuar në shkresën e këtij universiteti nr. *** prot., datë 30.10.2023, janë mbajtur dhe paguar detyrimet tatimore; (vi) për vitin 2011 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 48,650 lekë, vlerësuar si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej marrëdhënies së shërbimit me “**** Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri”, për provueshmërinë e së cilës subjekti ka depozituar si provë të re vërtetimin e kësaj organizate, me nr. *** prot., datë 31.10.2023; (vii) për vitin 2014 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 37,800 lekë, vlerësuar si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej marrëdhënies së shërbimit me “Q.S.Zh (SDC)”, për provueshmërinë e të cilave subjekti ka depozituar si provë të re dokumentacionin financiar që lidhet me mandatpagesa të tatimit në burim nga kjo qendër; (viii) për vitin 2016 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 15,300 lekë, vlerësuar si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej marrëdhënies së shërbimit në dukje me “****”, për provueshmërinë e të cilave subjekti ka depozituar si provë të re kontratën e shërbimit të datës 2.3.2016, si dhe dokumentacionin financiar që lidhet me të; (ix) për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 190,410 lekë (për vitin 2014, shumën 46,712 lekë; për vitin 2015, shumën 127,601; për vitin 2016, shumën 16,097 lekë), vlerësuar si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej marrëdhënies së shërbimit me fondacionin “****”, për provueshmërinë e të cilave subjekti ka depozituar si prova të reja “certifikatat e pagesës” dhe dokumentacionin financiar që lidhen me to; (x) për vitin 2015 të reflektojë në analizën financiare të ardhura shtesë në shumën totale 8,500 lekë, vlerësuar si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej marrëdhënies së shërbimit me qendrën “****”, për provueshmërinë e të cilave subjekti ka depozituar si provë të re shkresën e kësaj qendre, të datës 30.10.2023, në të cilën referohet se për pagesat e kryera në favor të znj. V.M është mbajtur prej tyre shuma përkatëse e detyrimit tatimor.

26.18.167 Gjithashtu, në qasjen e kryerjes së një analize sa më garantiste, Komisioni vlerësoi të reflektojë si të ardhura shtesë për vitet 2004, 2005, 2006, 2008, 2010 dhe 2013 në total shumën 242,273 lekë⁵⁹, të përfituara prej bashkëshortes së subjektit nga “****”, “****”, “****” dhe qendra “****” – evidentuar si persona juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, në kushtet kur rezultojnë e provuar vazhdimësia e bashkëpunimit të personit të lidhur me këto organizata – çmuar si një marrëdhënie shërbimi për të cilën detyrimin për mbajtjen dhe pagesën e tatimit e kanë pasur pranuesit e shërbimit në rolin e agjentit tatimor, pavarësisht se përfitimi i

⁵⁹ (i) Për vitin 2004, shuma 8,985 lekë, përfituar nga “****”; (ii) për vitin 2005: (a) shuma 4,753 lekë, përfituar nga “****”; (b) shuma 42,889 lekë, përfituar nga “****”; (iii) për vitin 2006, shuma 79,787 lekë, përfituar nga “****”; (iv) për vitin 2008, shuma 6,159 lekë, përfituar nga “****”; (v) për vitin 2009, shuma 30,863 lekë, përfituar nga “****”; (vi) për vitin 2010, shuma 56,218 lekë, përfituar nga “****”; (vii) për vitin 2013, shuma 12,619 lekë, përfituar nga “****”.

tyre provohet vetëm nëpërmjet sistemit bankar dhe/apo në shkresat e këtyre shoqërive nuk referohet mbajtja e tatimit në burim për këto të ardhura.

26.19 Të ardhura të tjera nga kursimet familjare të verifikuara në raport me deklarimet e likuiditeteve *cash* ndër vite dhe me gjendjen e deklaruar të likuiditeteve *cash* në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*

26.19.1 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar se disponojnë pasurinë e llojit likuiditete *cash*, në monedhën euro dhe lekë, në total përkatësisht vlerat 3,000 euro dhe 58,000 lekë. Si burim krijimi kanë deklaruar të ardhurat familjare.

26.19.2 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: (i) Për vitin 2003, në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie (dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.3.2004) rezulton se subjekti nuk ka deklaruar pasuri të llojit likuiditete *cash*; (ii) Në DIPP-në e vitit 2004, në seksionin e pasurive subjekti ka deklaruar: “...shuma 400,000 lekë, të cilat janë tërhequr dhe llogaria është mbyllur, depozita e kursimit në Bankën e Kursimeve dega ***, Elio Mazreku dhe B.P.”; (iii) Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësime të likuiditeteve *cash*; (iv) Në DIPP-në e vitit 2006, në seksionin e pasurive, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: (a) “...Vlera 400,000 lekë (equiv. 3,300 euro), që ruhej *cash* në banesë, është derdhur në euro në BKT...”; (b) “...Shuma parash në lekë, euro ose dollarë amerikanë, që ia ka dhënë ose dërguar babai dhe vëllai në emigracion, ndoshta 100,000 lekë – 200,000 lekë (të kthyera të gjitha në lekë).

➤ Por, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e krijuara nga vëllai i tij nga puna në emigracion, të deklaruara si të dhuruara në vitin 2006. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me qëllim provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të vëllait të tij të deklaruara si një nga burimet e krijimit të likuiditeteve *cash*.

26.19.3 Pas shqyrtimit të prapësimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të depozituara bashkëlidhur tyre, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga puna e vëllait të tij në emigracion.

26.19.4 Komisioni konstaton se: (i) Në DIPP-në e vitit 2007, në seksionin e pasurive, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: (a) “...depozita bankare në BKT, në shumën 16,300 euro përfshin brenda edhe shumën 3,300 euro, që i përgjigjen shumës 400,000 lekë, të cilat i kishte *cash* në shtëpi nga mbyllja e llogarisë së kursimit në Bankën e Kursimeve (Raiffeisen Bank)...”; (b) “...gjendja *cash*, të krijuara gjatë vitit 2006, dhënë nga vëllai emigrant (afërsisht) shuma 150,000 lekë...”; (ii) Në DIPP-në e vitit 2008, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “...5,000,000 lekë të holla (*cash*) të përfituara pas vdekjes së babait H.M , më 18.2.2008. Burimi i krijimit trashëgimia, dhurimi nga babai para vdekjes dhe përfitimi pas vdekjes...”.

26.19.5 Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në seksionin e deklarimit të të ardhurave, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “[...] Të holla (*cash*) të përfituara pas vdekjes së H.M , më 18.2.2008. Nuk kam dokumente provuese. Janë deklaruar si shumë në deklarimin periodik, kam dhënë shpjegime dhe kam paraqitur dokumente të veprimitarisë tregtare të të ndjerit në vitin 2016, gjatë kontrollit tërësor të pasurisë së kryer nga ILDKPKI-ja [...]”.

26.19.6 Gjithashtu, Komisioni konstaton se me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka depozituar disa dokumente të llojit mandate, fletëhyrje, fletëdalje, urdhërdorëzimi dhe fletore/blloqe me shënime të lira dore, në dukje në përpjekje për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave prej babait të tij, të cilat pretendohen se kanë shërbyer për krijimin e shumës 5,000,000 lekë. Pra, duket se subjekti pretendon se këto të ardhura janë krijuar nga aktiviteti tregtar i babait.

26.19.7 I pyetur me parë nga ILDKPKI-ja⁶⁰ mbi krijimin e kësaj shume, deklaruar si likuiditet *cash* në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: “...*Babai është marrë me aktivitet privat qysh prej vitit 1990, tek ish-uzina “***”. Ka pasur një garazh afër hyrjes së uzinës, në të cilin mbante të gjithë mallin. Garazhin e ka blerë 300,000 lekë, garazh i cili më vonë u prish, si ndërtim i paligjshëm. Pas kësaj, malli qëndroi në një ambient shtëpie, të një të njohurit të tij, derisa u shit... Në vitin 2008, kur babai ka ndërruar jetë malli i lënë ka qenë rreth 7,000,000 lekë, fakt të cilin e ka përmendur edhe kur kanë ardhur inspektorët e ILDKPKI-së për trajnime në vitin në fjalë, për mënyrën e plotësimit të deklaratës. Malli u shit në vitet në vijim dhe shumicën e të ardhurave e ka marrë e veja e babait, e quajtur Z.M. Babai nuk ka mbajtur likuiditete në bankë – në dijeninë e tij dhe e ka të vështirë të provojë me dokumente ligjore dhurimin nga ana e tij të likuiditetit në shumën 5,000,000 lekë”.*

26.19.8 Në vijim të deklarimeve të tij të bëra para ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka referuar se ka gjetur fatura origjinale të punës, kopje të të cilave i ka paraqitur për t’u administruar në dosje.

26.19.9 Bazuar në pikën 14 të nenit 3 dhe në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, babai i subjektit, z. H.M, bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, për të cilin subjekti mbart detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast provimin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 5,000,000 lekë, deklaruar si shumë e lënë prej tij pas vdekjes, e përdorur për nevoja familjare të subjektit.

26.19.10 Pasi Komisioni i kërkoi sërish subjektit të japë detaje rreth përfitimit të kësaj shume ku përfshihet edhe mënyra dhe momenti i marrjes në dorëzim të saj, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, babait të tij, të cilat kanë shërbyer si burim i krijimit të saj⁶¹, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: “...*Për këtë çështje është përgjigjur hollësisht në kontrollin periodik që është kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2016. Ka paraqitur asokohe origjinalet e tërë faturave që ka gjetur në garazhin ku babai i tij kryente veprimtarinë tregtare. Inspektori i ILDKPKI-si pasi shqyrtoi tërë origjinalet i kërkoi të paraqiste fotokopjet. I ka fotokopjuar dhe i ka paraqitur në vijim... Faturat e gjetura, me sa kupton, u jepeshin klientëve të tij që ishin kryesisht nga rrethe të tjera, që kishin ndonjë sipërmarrje të vetën (prodhues divanësh, mobiliesh etj. - i mban mend këto nga bisedat me babain) dhe tregtarë që blinin tek ai dhe rishisnin mallrat në qytete të tjera. Ndërkaq, blerje më të vogla, më të shpeshta, nga klientë që merrnin mallra sa për nevoja të tjera, nuk duhet të jenë shënuar nëpër fatura. Gjithsesi, në lidhje me sa pyetet, sqaron se babai i tij pasi u largua nga tregu i ***, u vendos te tregu i ***, që administrohej nga Bashkia Tiranë. Beson se duke qenë tregtar ambulant aty në stendat e shitjeve të përcaktuara nga pushteti vendor, pagesat duhet të jenë bërë prej tij në favor të Bashkisë së Tiranës në kohën e kërkuar prej tyre. Pasi u largua nga tregu i ***... nisi të ushtronte veprimtarinë në hyrjen e ish-uzinës “***”... Ky vend ku nisi të ushtronte veprimtarinë ishte një garazh, i ndërtuar me mure betoni dhe me hyrjen metalike. Beson se koha kur ka nisur të ushtrojë veprimtarinë në një vend të tillë duhet të jetë në vitin 2002, sepse dokumentet që ka gjetur në garazhin e tij pas vdekjes, përveç faturave të shitjeve, ka gjetur edhe një vendim për regjistrimin si person fizik, nr. ***, datë 12.2.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶²... Duke iu referuar vendimit, shikohet edhe fusha e tregtimit “artikuj të ndryshëm industrialë, gozhdë, bulona etj.”... Sa i përket vlerës 5,000,000 lekë, konfirmon se ka pasur vlerë të tillë në vitin 2008 pas vdekjes së babait, çka është deklaruar. Babai nuk ka pushuar asnjë ditë të jetës së tij, ka punuar deri afro 22 ditë para vdekjes. Kur ka ardhur nga puna një ditë janari 2008, ka qenë me probleme zemre, është*

⁶⁰ Referojuni dokumentit “Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 22.7.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023, të ILDKPKI-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.5.2023).

⁶¹ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

⁶² Vendim të cilin e ka depozituar si provë, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***.

*njoftuar dhe ka shkuar urgjent nga puna në shtëpinë e tij, më pas e kanë shtruar në spitalin e zemrës në QSUT “Nënë Tereza”, ku dhe ndërroi jetë. Pra, puna e tij mbeti përgjysmë, mallrat dhe dokumentet mbetën në dyqanin/garazhin e tij dhe paratë cash gjithashtu. Vëllai i tij asokohe ndodhej në Kinë. Sikurse ka sqaruar më lart, vëllai dhe babai kanë qenë tregtarë, mendësia e asokohe ishte që paraja duhej e disponueshme cash në dorë, sa më shpejt... Sa u përket shumave që ai mund të ketë pasur nëpër duar gjatë tregtisë së tij, nuk mund ta thotë me siguri të plotë. Pagesat për tatimet nuk ishin pjesë e bisedave me babain, por mban mend që kur punonte në tregun te fusha e ***, pagesa për një periudhë ka qenë 300 lekë në ditë për stendën/vendin e tregtimit, bënin pagesa tek inspektorët. Po ashtu, nuk e di se si kanë qenë paguar detyrimet nga ai kur ka nisur të punonte si shitës ambulant dhe, më pas, në garazh, ngaqë tashmë ishte pensionist... ”.*

26.19.11 Në vijim të verifikimeve të kryera mbi pretendimin e ngritur për ushtrimin e aktivitetit tregtar nga personi i lidhur, babai i subjektit H.M , pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁶³, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon se⁶⁴ pasi bëri verifikimet në të dhënat që disponon në regjistrin kombëtar rezultoi se ky shtetas nuk figuron i regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

➤ **Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e babait të tij, të cilat pretendohet se kanë mundësuar krijimin e shumës 5,000,000 lekë , deklaruar si shumë e përfituar pasi babai ka ndërruar jetë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

26.19.12 Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar përcaktimin e babait të tij si person të lidhur, duke referuar rrethana familjare që lidhen me divorcin e prindërve të tij në kohën që ai ka qenë i mitur dhe faktin se ka jetuar me nënën.

26.19.13 Komisioni vëren se subjekti i ka qëndruar deklarimeve të dhëna më parë mbi aktivitetin tregtar të babait të tij, për të cilin parashtron se ka punuar si ambulant, duke depozituar si prova të reja në mbështetje të pretendimeve dhe shpjegimeve të tij dy dokumente: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 7.11.2023, lëshuar nga Bashkia Tiranë, në të cilin konfirmohet se regjistrimet e bashkisë “në dukje për ambulantët” fillojnë nga viti 2010 e në vijim, ndërsa për periudhën 1991 – 2008 nuk disponohen regjistrime; (ii) deklaratën noteriale⁶⁵ të shtetasit E.K (referuar si familjar i tij, djali i motrës së babait) nëpërmjet së cilës ai deklaroi mbi rrethana të kryerjes së aktivitetit tregtar të shtetasit H.M dhe përfitimit të të mirave materiale nga ana e subjektit, pas vdekjes së tij.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe ligjit të zbatueshëm

26.19.14 Në vlerësim dhe shqyrtim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni vëren se subjekti pretendon se babai i tij nuk është person i lidhur me të për shkak të disa rrethanave familjare dhe se gjithashtu gjendet në pamundësi të disponimit të informacionit dhe dokumentacionit të plotë për të provuar ushtrimin e aktivitetit tregtar të babait të tij.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2023, e Komisionit.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2023, e DPT-së (protokolluar në Komision me nr. ***prot., datë 29.9.2023).

⁶⁵ Deklaratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.10.2023, noteri publik, znj. A.S.

26.19.15 Në këtë kontekst, së pari, trupi gjykues gjen me vend të sqarojë se babai i subjektit nuk është kategorizuar në cilësinë e personit të lidhur, por në cilësinë e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit në përputhje me përkufizimin e bërë në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, për pasje në zbatim të nenit 32/4 të këtij ligji, dispozitë e cila ngarkon subjektin me barrën e provës për dokumentimin e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur.

26.19.16 Sa i përket pretendimit të subjektit se babai i tij ka ushtruar aktivitetin tregtar si ambulant dhe se në dukje pikërisht për këtë fakt nuk mund të disponojë të dhëna lidhur me këtë aktivitet, Komisioni vlerëson se pretendimet e tij mbeten të karakterit deklarativ. Vetë shkresa e Bashkisë Tiranë referon se nuk disponon të dhëna për ambulantët para vitit 2010, por jo se nuk disponon të dhëna për aktivitetin e babait të subjektit. Pra, në referim të kësaj shkrese nuk konfirmohet se babai i subjektit të ketë ushtruar aktivitetin e ambulantit dhe se bashkia nuk disponon të dhëna shtesë, rrethanë e cila mund të çonte në mënyrë hipotetike subjektin në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, vlera e pretenduar nga subjekti – në total në shumën 5,000,000 lekë, me burim fitimin nga aktiviteti tregtar i babait, në kushtet kur subjekti referon se ka pasur edhe mallra në sasi të konsiderueshme gjendje e të pashitura në momentin kur babai ka ndërruar jetë, duket se nuk është proporcionale me aktivitetin e ambulantit – duke vlerësuar se për të arritur në këtë vlerë të fituar (krahas të ardhurave të tjera që mund të jenë shpenzuar nga babai) do të duhej të realizohej një qarkullim në vlerë të konsiderueshme, që nuk i përgjigjet këtij lloji aktiviteti. Gjithashtu, nga provat e administruara rezulton se në shkurt të vitit 2002, babai i subjektit është regjistruar si person fizik në gjykatë me qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar, por nga ana tjetër nuk rezulton të jetë regjistruar në organet tatimore.

➤ **Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016 nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur për të mundësuar lënien/dhurimin e shumës 5,000,000 lekë në favor të tij.**

26.19.17 Në vijim të verifikimit të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI, që lidhen me shtesat/pakësimet e likuiditeteve *cash*, Komisioni konstaton se: (i) Në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “...*Të holla (cash) të trashëguara nga babai pas vdekjes janë pakësuar gjatë vitit 2009, shuma 2,000,000 lekë...*”; (ii) Rezulton se në DIPP-të e viteve 2010 – 2015, subjekti dhe/apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar shtesa/pakësime të pasurisë së llojit likuiditete; (iii) Në DIPP-në e vitit 2016, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “...*lekë në dorë cash në fund të vitit, shuma 10,000 lekë, tërhequr nga llogaria e pagës...*”; (iv) Ndërsa, personi i lidhur ka deklaruar: “...*Para në dorë (cash) 20,000 lekë dhe 6,000 euro në fund të vitit. Burimi: tërheqje nga llog. rrjedhëse nr. *** Raiffeisen Bank, ku janë derdhur të ardhura nga kontrata me “***...”*”.

26.19.18 Pasi Komisioni i kërkoi të deklarojë gjendjen e likuiditeteve *cash*, të disponuar jashtë sistemit bankar, kronologjikisht për çdo vit më vete për periudhën 2003 – 2016, si dhe gjendjen e disponuar në momentin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e tyre, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁶⁶: “...*Është e pamundur që të deklaroj me saktësi vlerat cash që ka pasur qëkur ka qenë student, kur ka nisur punë (kudo ku ka punuar) dhe, posaçërisht, për periudhën 2003 – 2016, për të cilën pyetet... Mjafton të përmend faktin që, ngaqë fillimisht e merrnin pagën mujore në dorë, në zyrën e financës së institucionit provohet katërcipërisht që kanë pasur para cash në gjendje. Nëse në mbarim të viteve 2003-2004-2005 e kanë pasë marrë pagën në dorë (cash) nga zyra e financës (gjë që ndodhte zakonisht në fund të çdo viti kalendarik), atëherë logjikisht në fund të vitit kalendarik duhet të kenë pasur para cash në dorë. Po ashtu, është normale që në fund të vitit, kur tërë shqiptarët festojnë një festë familjare, të kenë lekë nëpër duar. Nëse në fillim të*

⁶⁶ Referojuni përgjigjes së pyetjeve nr. *** dhe *** të pyetësorit nr. *** të dërguar nga Komisioni.

deklarimit të pasurisë ose dhe në vijim, mund të mos ketë deklaruar konkretisht vlera të tilla, mendon që ka qenë harresë ose moskuptim, duke u përqendruar vetëm tek ato lloj pasurish të luajtshme që lidhen me bankat dhe mjetet motorike... Konfirmon që ka pasur të tilla vlera; ato mund të kenë variuar nga relativisht të konsiderueshme, që duhet të ketë qenë koha kur ka nisur punësimi, për arsyet e përmendura në përgjigjet e mësipërme dhe për origjinën e shpjeguar më sipër (pra nga vëllai, nga puna e tij para se të punonte në prokurori, nga të ardhurat e bashkëshortes para dhe gjatë martesës); ka qenë viti 2008, kur nga babai pati shumë 5,000,000 lekë pas vdekjes së tij, çka është deklaruar.... Këtu sqaron se babai ka punuar deri afro 22 ditë para vdekjes. Kur ka ardhur nga puna një ditë janari 2008, ka qenë me problem zemre, e kanë shtruar urgjent në spitalin e zemrës në QSUT “Nënë Tereza”, ku dhe vdiq. Pra, puna e tij mbeti përgjysmë, mallrat mbetën në garazhin e tij dhe paratë cash gjithashtu. I vetmi fëmijë që pati pranë gati tërë jetën isha ai, sepse vëllai vinte rrallëherë në Shqipëri dhe qëndronte jo më shumë se dy javë. Kjo shumë e deklaruar është mbajtur, është përdorur në vijim për jetesën dhe përmbushjen e nevojave të ndryshme familjare që mund të kenë qenë të zakonshme ose edhe të befasishme. Sikurse ka sqaruar më lart, babai dhe vëllai kanë qenë tregtarë, mendësia asokohe ishte që paraja duhej e disponueshme cash në dorë, sa më shpejt. Në lidhje me këtë shumë prej 5,000,000 lekësh është e pamundur që ta ketë shpenzuar të tërën brenda vitit 2008, sepse përgjithësisht niveli i jetesës ka qenë modest, në familje nuk kanë bërë e nuk bëjnë shpenzime të mëdha. Pra, logjikisht, ajo shumë duhet të ketë vijuar dhe të jetë përdorur e shpenzuar dhe në vitet vijuese. Por, që të përcaktoj saktësisht vlerën për çdo vit pas kaq shumë vitesh, kjo do të ishte gënjeshtër. Nuk besoj që do e mbaja mend vlerën e saktë as për vitin pasardhës, e jo më tani. Shuma e deklaruar në deklaratën Vetting lidhet me kursime familjare, si dhe me tërheqje të kryera në bankë nga bashkëshortja V.M, kjo është deklaruar edhe në deklaratat e pasurisë për vitet 2016 dhe 2017. Sa i përket vlerave 23,000 lekë dhe 3,000 euro në kohën e dorëzimit të deklaratës Vetting, sqaroj që burimi i shifrës 3,000 euro më 30.1.2017, kur u dorëzua deklarata Vetting në ILDKPKI, lidhet me tërheqjen e 6,000 euro nga llogaria rrjedhëse nr. *** në Raiffeisen Bank, nga V.M, ku ishin derdhur më parë të ardhura nga kontrata me “****” (mund t’i referoheni deklaratës së pasurisë për vitin 2016). Në datën 18.1.2017 (12 ditë para dorëzimit të deklaratës Vetting), depozita me afat nr. ***, në Credins Bank, në emër të Elio Mazrekut e V.M, u mbyll. Shuma 7,618.41 euro u derdh më pas në një llogari kursimi nr. ***, në BKT, në emër të Elio Mazrekut dhe V.M, çelur më 19.1.2017, pra një ditë pas mbylljes së depozitës në Credins Bank. Po ashtu, aty u shtuan rreth 3,000 euro (nga 6,000 euro gjithsej të ardhura të V.M nga kontrata me ***, derdhur në llogarinë rrjedhëse të saj në Raiffeisen Bank gjatë vitit 2016). Për rrjedhojë, 11 ditë më vonë, ditën e dorëzimit të deklaratës Vetting në ILDKPKI, janë deklaruar 3,000 euro të mbetura nga shifra 6,000 euro...”.

26.19.19 Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur në ILDKPKI mbi shtesat/pakësimet/gjendjet e likuiditeteve cash ndër vite, duket se ecuria e gjendjes së kursimeve në formë likuiditetesh cash nga deklarata fillestare e pasurisë deri në DIPP-në e vitit 2016 paraqitet e pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 2

Viti	Deklaruar në DIPP / gjatë hetimit administrativ	SUBJEKTI DHE PERSONI I LIDHUR					
		Valuta Lek			Valuta Euro		
		Shtesë	Pakësim	Progresive	Shtesë	Pakësim	Progresive
2004	"...Shuma 400,000 lekë të cilat janë tërhequr dhe llogaria është mbyllur, depozita e kursimit në Bankën e Kursimeve dega 4, Elio Macreku dhe B.P..."	400,000 Lekë	- Lekë	400,000 Lekë			
2005	Nuk janë deklaruar shtesa/pakësim/gjendje	- Lekë	- Lekë	400,000 Lekë			
2006	"...Vlera 400,000 lekë (equiv. 3,300 euro) që ruhej cash në banesë është derdhur në euro në BKT..." "...Shuma parash në lekë, euro ose dollarë Amerikanë që mi ka dhënë ose dërguar im atë dhe vëllai në emigracion, ndoshta 100,000 lekë – 200,000 lekë (të kthyera të gjitha në lekë)..."	- Lekë	400,000 Lekë	- Lekë			
2007	Nuk janë deklaruar shtesa/pakësim/gjendje për vitin 2007.	- Lekë	- Lekë	150,000 Lekë			
2008	"...5,000,000 lekë të holla (cash) të përfutuara pas vdekjes së babait tim, H.M, në 18.02.2008. Burimi i krijimit trashëgimia, dhurimi nga babai para vdekjes dhe përfutimi pas vdekjes..."	5,000,000 Lekë		5,150,000 Lekë			
2009	"...Të holla (cash) të trashëguara nga im atë pas vdekjes janë paksuar gjatë vitit 2009 shuma 2,000,000 lekë..."		2,000,000 Lekë	3,150,000 Lekë			
2010-2015	Nuk janë deklaruar shtesa/pakësim/gjendje	- Lekë	- Lekë	3,150,000 Lekë			
2016	Subjekti: "...lekë në dorë cash në fund të vitit shuma 10,000 lekë. tërhequr nga llogaria e pagës..." Personi i lidhur: "...Para në dorë (cash) 20,000 lekë dhe 6,000 euro në fund të vitit. Burimi tërheqje nga llog. Rrjedhëse nr. *** Raftësien ku janë derdhur të ardhura nga kontrata me ***..."	10,000 Lekë		3,160,000 Lekë			
		20,000 Lekë		3,180,000 Lekë	€ 6,000		€ 6,000
19.01.2017	Datë 19.01.2017 investuar në BKT 10,000 euro në depozitë me afat nga e cila shuma 3,000 euro nga gjendja e mëparshme e likuiditeteve cash.					€ 3,000	€ 3,000
	Deklaruar në vetting			58,000 Lekë			€ 3,000
	Diferenca			3,122,000 Lekë			€ -

26.19.20 Pra, referuar vetëdeklarimeve të bëra në formularët e deklarimit të interesave privatë ndër vite, duket se në fund të vitit 2016 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur dispononin gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumat prej rreth 3,180,000 lekësh dhe 3,000 euro, ndërkohë, në momentin e dorëzimit të deklarimit *Vetting*, në datën 30.1.2017, rezulton se ata kanë deklaruar se disponojnë pasurinë e llojit likuiditete *cash* në vlerat 58,000 lekë dhe 3,000 euro.

➤ **Sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegimet e tij shteruese mbi vetëdeklarimet e bëra ndër vite për likuiditetet *cash*, si dhe të deklarojë mbi destinacionin e shumës 3,122,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën mes vlerës së likuiditeteve *cash* në lekë, të vlerësuar si gjendje në datën 31.12.2016, bazuar në vetëdeklarimet e bëra ndër vite në ILDKPKI dhe vlerës 58,000 lekë, të deklaruar si gjendje likuiditetesh *cash* në momentin e dorëzimit të deklarimit *Vetting*, datë 30.1.2017.**

26.19.21 Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i qëndron deklarimeve të dhëna më parë mbi disponimin e likuiditeteve *cash*, duke parashtruar se për sa kohë nuk ka mundur më herët që të paraqesë me bindje vlera të sakta, për të mos rënë në pozita të deklarimeve të pasakta/të rreme ose në pretendime të pambështetura, ka kërkuar nga një ekspert kontabël për të kryer një vlerësim objektiv.

26.19.22 Pas verifikimit të raportit financiar të depozituar nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit⁶⁷, Komisioni vëren se audituesi ligjor ka mbajtur të njëjtin qëndrim mbi shtesat/pakësimet dhe gjendjet e likuiditeteve *cash* ndër vite – sikurse është paraqitur në rezultatet e hetimit administrativ.

➤ **Në shqyrtimin përfundimtar të deklarimeve të bëra nga subjekti mbi shtesat/pakësimet dhe gjendjet e likuiditeteve *cash* ndër vite, Komisioni vlerëson se ai ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, duke u vendosur në kushtet e parashikuara sipas leximit *acontrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.**

26.19.23 Për sa u parashtrua më sipër, bazuar në deklarimet e subjektit, dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në analizën e bërë mbi të ardhurat e deklaruara si burim për krijimin e tri depozitave bankare nga personi i lidhur dhe krijimin e kursimeve të tjera në formë likuiditetesh *cash*, vlerat e të cilave në vijim janë referuar si burim krijimi i pasurisë objekt

⁶⁷ Raporti i audituesit ligjor datë 15.11.2023, përpiluar nga z. A.M (ekspert kontabël i regjistruar me nr. Licence ***, datë 31.1.2000).

vlerësimi, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë⁶⁸, nga ku rezulton se periudha 1995 – 2003 dhe vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010 paraqiten me balancë negative fondesh. Pra, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të mundësuar krijimin e depozitave dhe kursimeve *cash* të referuara në vijim si burime krijimi të pasurisë objekt vlerësimi.

➤ **Si rrjedhim, trupi gjykues arrin në përfundimin se ata nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat e kryera në korrik të vitit 2010 për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, duke u vendosur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.**

26.19.24 Në vijim të verifikimit të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara ndër vite në ILDKPKI nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se pasuria objekt vlerësimi nuk është deklaruar si adresë në të cilën është regjistruar në gjendje civile dhe as si adresë banimi apo vendqëndrimi tjetër.

26.19.25 Pasi Komisioni i kërkoi⁶⁹ të deklarojë mbi vendbanimet e tij përgjatë periudhës që ka ushtruar detyrën, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se *gjatë gjithë jetës ai ka jetuar në apartamentin e ndodhur në blv. “****”, pallati ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, që ka pasur fillimisht në bashkëpronësi me gjyshen, nënën dhe vëllain, të cilin e kanë fituar ne bazë të ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore.*

26.19.26 Ndërsa, për apartamentin objekt vlerësimi ka deklaruar se nuk ka qenë i përdorur për banim prej tyre pasi ka qenë në huapërdorim/qira, nga OJF e fondacioni “**** ” për përdorim zyre dhe nuk kanë investuar as për mobilimin e kësaj pasurie.

26.19.27 Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar: (i) kontratë huapërdorjeje⁷⁰ për pasuri të paluajtshme, e datës 20.12.2010, nënshkruar nga shtetasit Elio dhe V.M, në cilësinë e huadhënësit në përdorim dhe fondacionit “****”⁷¹, me përfaqësues ligjor znj. V.M, në cilësinë e huamarrësit në përdorim, me objekt dhënien në huapërdorje pa kundërshtëpërblim të një pjese prej 32 m² të pasurisë objekt vlerësimi për një periudhë 1-vjeçare deri në datën 19.12.2011; (ii) kontratë huapërdorjeje⁷² për pasuri të paluajtshme të datës 20.12.2011, të nënshkruar nga shtetasit Elio dhe V.M, në cilësinë e huadhënësit në përdorim dhe fondacionit “**** ”, me përfaqësues ligjor znj. V.M, në cilësinë e huamarrësit në përdorim, me objekt dhënien në huapërdorje pa kundërshtëpërblim të një pjese prej 32 m² të pasurisë objekt vlerësimi për një periudhë 1-vjeçare, deri në datën 19.12.2012; (iii) kontratë qiraje⁷³ për pasuri të paluajtshme, e datës 30.3.2012, nënshkruar nga shtetasit Elio dhe V.M, në cilësinë e qiradhënësit dhe fondacionit “**** ”, me përfaqësues ligjor znj. V.M, në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënien me qira në vlerën 20,000 lekë/muaj të një pjese prej 32 m² të pasurisë objekt vlerësimi për një periudhë 9-mujore deri në datën 31.12.2012; (iv) kontratë qiraje⁷⁴ për pasuri të paluajtshme, e datës 1.1.2013, nënshkruar nga shtetasit Elio dhe V.M, në cilësinë e qiradhënësit dhe fondacioni “****”, me përfaqësues ligjor znj. V.M, në cilësinë e qiramarrësit,

⁶⁸ Referojuni tabelës së analizës përmbledhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, ndodhur në Aneks **** – bashkëlidhur këtij vendimi.

⁶⁹ Nëpërmjet pyetësorit nr. ****.

⁷⁰ Kontratë huapërdorjeje për pasuri të paluajtshme nr. **** regj., datë 20.12.2010, ndodhur në aneksin nr. **** në dosjen e ILDKPKI-së, në dukje e redaktuar nga avokat A.Ll.

⁷¹ Duket se ky subjekt është i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ****, datë 2.11.2009, sipas shkresës nr. **** prot., datë 1.11.2018, të DRT-së, ndodhur në aneksin nr. **** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷² Kontratë huapërdorjeje për pasuri të paluajtshme nr. **** regj., datë 20.12.2011, ndodhur në aneksin nr. **** në dosjen e ILDKPKI-së, në dukje e redaktuar nga avokat A.Ll.

⁷³ Kontratë qiraje nr. ****, datë 30.3.2012, ndodhur në aneksin nr. **** në dosjen e ILDKPKI-së, në dukje e redaktuar nga avokat A.Ll.

⁷⁴ Kontratë qiraje nr. ****, datë 1.1.2013, ndodhur në aneksin nr. **** në dosjen e ILDKPKI-së, në dukje e redaktuar nga avokat A.Ll.

me objekt dhënien me qira në vlerën 20,000 lekë/muaj të një pjese prej 32 m² të pasurisë objekt vlerësimi për një periudhë 12-mujore, deri në datën 31.12.2013; (v) kontratë qiraje⁷⁵ për pasuri të paluajtshme, e datës 4.1.2014, nënshkruar nga shtetasit Elio dhe V.M, në cilësinë e qiradhënësit dhe fondacionit “****”, me përfaqësues ligjor znj. V.M, në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënien me qira të një pjese prej 32 m² të pasurisë objekt vlerësimi për një periudhë 12-mujore, deri në datën 31.12.2013. Vlera e qirasë është përcaktuar 30,000 lekë/muaj për periudhën 1.1.2014 – 30.6.2014 dhe 34,600 lekë/muaj për periudhën 1.7.2014 – 31.12.2014; (vi) kontratë qiraje⁷⁶ për pasuri të paluajtshme, e datës 1.1.2015, nënshkruar nga shtetasit Elio dhe V.M, në cilësinë e qiradhënësit dhe fondacionit “****”, me përfaqësues ligjor znj. V.M, në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënien me qira të një pjese prej 32 m² të pasurisë objekt vlerësimi për një periudhë 12-mujore, deri në datën 31.12.2015. Vlera e qirasë është përcaktuar 30,000 lekë/muaj, për 6 muaj do të parapaguhet në vlerën 180,000 lekë dhe për muajt në vazhdim pagesa do të kryhet në llogarinë bankare të qiradhënësit pranë Raiffeisen Bank; (vii) kontratë qiraje⁷⁷ për pasuri të paluajtshme, e datës 1.1.2015, nënshkruar nga shtetasit Elio dhe V.M, në cilësinë e qiradhënësit dhe fondacionit “****”, me përfaqësues ligjor znj. V.M, në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënien me qira të një pjese prej 32 m² të pasurisë objekt vlerësimi për një periudhë 12-mujore, deri në datën 31.12.2015. Vlera e qirasë është përcaktuar 30,000 lekë/muaj, e cila do të paguhet nga datat 1 – 5 të çdo 6-mujori.

26.19.28 Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia e kësaj pasurie shumat 1,028,600 lekë dhe 680 euro. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezulton se në llogarinë e subjektit në Raiffeisen Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank në vazhdimësi janë kryer kreditime të vlerave të qirasë nga fondacioni “****”, në total shumat 1,028,600 lekë dhe 680 euro. Gjithashtu evidentohet dokumentacion ligjor provues mbi pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, konkretisht mbi pagesat e bëra për tatimin në burim (tatim mbi qiranë) nga fondacioni “**** Shqipëri” për periudhën 2012 – 2016⁷⁸.

26.19.29 Ndërsa, në deklaratat e interesave privatë periodikë të viteve 2012 – 2016, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar përkatësisht të ardhurat nga qiradhënia e kësaj pasurie, në total në shumat 1,111,700 lekë dhe 680 euro.

26.19.30 Të paraqitura në formë tabelare të ardhurat e deklaruara nga marrëdhënia e qiradhënies në deklaratat periodike vjetore në raport me të ardhurat e deklaruara në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe të kredituara në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, si dhe të dhënat në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, pasqyrohen në tabelën si më poshtë:

⁷⁵ Kontratë qiraje nr. ***, datë 4.1.2014, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, në dukje e redaktuar nga avokat A.Ll.

⁷⁶ Kontratë qiraje nr. ***, datë 1.1.2015, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, në dukje e redaktuar nga avokat A.Ll.

⁷⁷ Kontratë qiraje nr. ***, datë 1.1.2016, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, në dukje e redaktuar nga avokat A.Ll.

⁷⁸ Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 1.11.2018, të DRT-së Tiranë, ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, në aneksin nr. ***.

Tabela nr. 3

Periudha	2012	2013	2014	2015	2016	2012 – 2016
Deklaruar në DIPP-të vjetore	162,000 lekë	216,000 lekë	324,000 lekë	300,900 lekë	108,800 lekë dhe 680 euro	1,111,700 lekë dhe 680 euro
Deklaruar në <i>Vetting</i>						1,028,900 lekë dhe 680 euro
Kredituar në bankë	162,000 lekë	216,000 lekë	241,200 lekë	300,900 lekë	108,800 lekë dhe 680 euro	1,028,900 lekë dhe 680 euro
Paguar tatimin (DPT)	18,000 lekë	24,000 lekë	24,000 lekë	53,500 lekë	49,200 lekë	168,700 lekë

26.19.31 Në analizën financiare janë reflektuar si të ardhura të përfituara nga marrëdhënia e qiradhënies me fondacionin “***” shumat e vetëdeklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, të konfirmuara si të kredituara në llogarinë bankare të subjektit, si dhe për të cilat rezultoi e provuar pagesa e detyrimeve tatimore.

27. Zotëron ½ pjesë takuese të pasurisë së llojit depozitë në Intesa Sanpaolo Bank, depozitë e përbashkët në emër të tij dhe bashkëshortes V.M, me vlerë totale 4,414,600 lekë.

27.1 Si burim krijimi të kësaj depozite ka deklaruar të ardhurat e përbashkëta familjare ndër vite, si përpara fillimit të punës në prokurori, përpara martesës, edhe gjatë punës dhe martesës. Subjekti ka deklaruar se burimi i kësaj depozite vjen nga llogaria e hapur pranë Bankës Italo-Shqiptare më 16.5.2001, e cila ka pësuar disa ndryshime. Gjithashtu, ka sqaruar se në këtë depozitë derdhet paga e bashkëshortes dhe aktualisht derdhet edhe qiraja e shtëpisë.

Hetimi/verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

27.2 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Intesa Sanpaolo Bank⁷⁹, Komisioni konstaton se në datën 16.5.2001, në llogarinë bankare dyemërore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në lekë (llogaria nr. ***) është depozituar fillimisht shuma 240,000 lekë, e cila është investuar në depozitë duke përfituara interesat në shumën 7,682 lekë⁸⁰. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2001 (datë 31.12.2001) ka qenë 247,682 lekë. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie konstatohet se gjatë vitit 2002 ajo është shtuar me vlerën 700,000 lekë⁸¹, të depozituar *cash* dhe 37,372 lekë⁸² të përfituar nga interesat. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2002 (datë 31.12.2002) ka qenë në vlerën 985,054 lekë. Gjatë vitit 2003 rezultoi se në këtë llogari është kredituar në total interesi i përfituar 65,662 lekë⁸³. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2003 ka qenë në vlerën 1,050,716 lekë.

27.3 Komisioni konstaton se në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie të vitit 2003 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.3.2004), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Depozitë kursimi në Bankën Italo-Shqiptare në emër të V.M /Elio Mazrekut, datë 16.05.2001, llogaria nr. ***, të holla të mbledhura nga rrogat dhe përkthimet, hartimi i raporteve juridike, kursime etj., prej tij dhe bashkëshortes, shuma 1,050,000 lekë*”.

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 9.5.2023, nga Intesa Sanpaolo Bank (ish-Banka Italo-Shqiptare), protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.5.2023.

⁸⁰ Në datën 16.8.2001, shuma 3,811 lekë dhe në datën 16.11.2001, shuma 3,871 lekë.

⁸¹ Në datën 16.5.2002, shuma 600,000 lekë; në datën 18.11.2002, shuma 100,000 lekë (totali i shtuar 700,000 lekë).

⁸² Në datën 16.2.2002, shuma 4,045 lekë; në datën 16.5.2002, shuma 3,867 lekë; në datën 16.8.2002, shuma 14,072 lekë; në datën 16.11.2002 shuma 15,388 lekë.

⁸³ Në datën 16.2.2003, shuma 17,391 lekë; në datën 16.5.2003, shuma 17,159 lekë; në datën 16.8.2003, shuma 16,307 lekë; dhe në datën 16.11.2003 shuma 14,805 lekë.

27.4 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara në ILDKPKI, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar shtesat e kësaj depozite, si vijon:

27.4.1 Në DIPP-në e vitit 2004 ka deklaruar: “*Depozitë kursimi në Bankën Italo-Shqiptare, Elio dhe V.M, shuma 51,514 lekë*”.

27.4.2 Në DIPP-në e vitit 2005 ka deklaruar: “*Në llogarinë e kursimit në *** nr. *** është shtuar interesi bankar shuma 40,945 lekë*”.

27.4.3 Në DIPP-në e vitit 2006 ka deklaruar: “*Llogaria e kursimit në Bankën Italiane të Shqipërisë nr. *** është shtuar interesi bankar, shuma 41,179 lekë*”.

27.4.4 Në DIPP-në e vitit 2007 ka deklaruar: “*Llogaria e kursimit nr. *** në BIA-Banka Italiane e Shqipërisë, është shtuar interesi bankar vlerën nuk e di të saktë*”.

27.4.5 Në DIPP-në e vitit 2008 nuk ka deklaruar shtesa ose pakësime në këtë depozitë.

27.4.6 Në DIPP-në e vitit 2009 ka deklaruar: “*Depozita me afat në lekë në Intesa Sanpaolo Bank Albania në emër të V + Elio Mazreku interesi, burimi interesi bankar mbi shumën*”.

27.4.7 Në DIPP-në e vitit 2010 ka deklaruar: “*Sa u përket llogarive ose depozitave të tjera të kursimit ato kanë ndryshuar vetëm për vlera të barabarta me interesat e miratuara bankare*”.

27.4.8 Në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar: “*Depozitat bankare në emrin e tij dhe të bashkëshortes (së bashku apo veç e veç) janë shtuar në vlerën e interesave bankarë apo nga të ardhurat vjetore të bashkëshortes që janë derdhur nëpër banka, si dhe nga dhurata e bërë nga vëllai i tij”... “shiko të ardhurat e shënuara më lart për bashkëshorten, si edhe dhurata nga vëllai deklaruar në kolonat përkatëse... ”.*

27.4.9 Në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar: “*Shtuar interesi bankar në depozitat e kursimit të deklaruar më parë*”. Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Intesa Sanpaolo Bank konfirmohet se gjatë viteve 2004 – 2012 në këtë llogari është kredituar periodikisht interesi bankar në total shuma 440,455 lekë⁸⁴ dhe në vitin 2012 është kredituar nëpërmjet transfertës bankare edhe shuma 100,000 lekë⁸⁵ nga një llogari tjetër e personit të lidhur. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2012 ka qenë në vlerën rreth 1,591,000 lekë, nga e cila shuma prej 1,491,000 lekësh e investuar në depozitë me afat dhe në vlerën 100,000 lekë gjendje të lirë në llogari.

➤ **Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti/personi i lidhur nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 shtesën prej 100,000 lekësh në këtë llogari, si rrjedhim as burimin e krijimit të kësaj shume.**

27.4.10 Në vijim të verifikimit të deklaratave periodike rezulton se në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “*Shtesa nga interesat bankarë për depozitat e kursimeve në banka të deklaruar në vitet e mëparshme*”. Rezulton se gjatë vitit 2013 në këtë llogari është kredituar nëpërmjet transfertës bankare shuma 15,000 lekë⁸⁶, si dhe janë përfituar 47,826 lekë nga interesat⁸⁷. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2013 ka qenë në vlerën 1,660,546 lekë⁸⁸.

⁸⁴ Gjatë vitit 2004, shuma 51,514 lekë; gjatë vitit 2005, shuma 40,495 lekë; gjatë vitit 2006, shuma 41,179; gjatë vitit 2007, shuma 40,476 lekë; gjatë vitit 2008, shuma 47,064 lekë; gjatë vitit 2009, shuma 53,055 lekë; gjatë vitit 2010, shuma 58,178 lekë; gjatë vitit 2011, shuma 54,057 lekë; gjatë vitit 2012, shuma 53,978 lekë.

⁸⁵ Në datën 20.7.2012 kreditohet shuma 100,000 lekë nga llogaria e znj. V.M.

⁸⁶ Në datën 1.3.2013 kreditohet me transfertë nga znj. V.M shuma 15,000 lekë.

⁸⁷ Shuma 47,826 lekë, interesat vjetorë.

⁸⁸ Nga të cilat 1,628,400 lekë të investuara në depozitë me afat, ndërsa shuma prej 32,146 lekësh është në gjendje të lirë në llogari.

➤ **Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti/personi i lidhur nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 shtesën prej 15,000 lekësh në këtë llogari, si rrjedhim as burimin e krijimit të kësaj shume.**

27.4.11 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *“Llogaria e kursimit në lekë në Intesa Sanpaolo Bank është ndryshuar për sa i përket kushteve të depozitës, shuma 1,702,000 lekë”...* *“shtesa nga interesat bankarë për depozitat dhe llogaritë e kursimeve dhe skemat e kursimit në banka të deklaruara në vitet e mëparshme...”*. Rezulton se në vitin 2014 në këtë llogari është shtuar vlera 47,295 lekë, me burim interesat bankarë të përfituara gjatë vitit. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2014 ka qenë në vlerën 1,717,725 lekë⁸⁹.

27.4.12 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“...Depozita e kursimit nr. ***, në lekë, në Intesa Sanpaolo Bank është shtuar me derdhje në të holla dhe është ndryshuar kontrata për sa u përket kushteve të depozitës. Burime të kësaj depozite janë nga e njëjta depozitë kursimi nr. *** në lekë, në të njëjtën bankë, interesat gjatë vitit 2015, të kësaj të fundit, derdhje në të holla nga qiraja e shtëpisë, dhënë si zyrë dhe të ardhurat e bashkëshortes nga paga...”* *“...shuma 600,395 lekë derdhje nga paga e bashkëshortes shuma 153,000 lekë qiraja e shtëpisë...”*. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie depozitë konstatohet se gjatë vitit 2015 është kredituar nëpërmjet transfertave nga llogaria e pagës e personit të lidhur dhe si pagesa qiraje, në total shuma 1,079,394 lekë⁹⁰, si dhe shuma 31,644 lekë, përfituar nga interesat vjetorë bankarë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2015 ka qenë në vlerën 2,828,763 lekë⁹¹.

➤ **Sa më sipër, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti/personi i lidhur nuk ka deklaruar saktë shtesat e vlerave monetare në këtë depozitë.**

27.4.13 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *“...Depozita e përbashkët 1-vjeçare në Intesa Sanpaolo Bank, referencë ***, në emër të Elio dhe V.M, shtuar dredhja nga të ardhurat të bashkëshortes nga paga, punë sipas kontratave, qiraja e shtëpisë dhe interesi bankar... Shuma 1,585,967 lekë”*. Rezulton se gjatë vitit 2016, në këtë llogari është kredituar nëpërmjet transfertave nga llogaria e pagës e personit të lidhur dhe si pagesa qiraje, në total shuma 1,554,300 lekë⁹², si dhe shuma 31,668 lekë, përfituar nga interesat vjetorë bankarë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 ka qenë në vlerën 4,414,681 lekë⁹³.

27.5 Si konkluzion, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi – llogaria depozitë e përbashkët në Intesa Sanpaolo Bank.

28. Zotëron ½ pjesë takuese të pasurisë së llojit depozitë në Intesa Sanpaolo Bank, depozitë e përbashkët në emër të tij dhe bashkëshortes V.M, me vlerë totale 52,637 euro.

28.1 Si burim krijimi të kësaj depozite ka deklaruar të ardhurat e përbashkëta familjare ndër vite, si përpara fillimit të punës në prokurori, përpara martesës, edhe gjatë punës dhe martesës. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se burimi i kësaj depozite vjen nga llogaria e hapur pranë Bankës Amerikane në datën 11.10.2004, e cila ka pësuar disa herë ndryshime.

⁸⁹ Nga të cilat vlera prej 1,702,000 lekësh është investuar në depozitë me afat, ndërsa shuma prej 15,725 lekësh është në gjendje të lirë në llogari.

⁹⁰ Në datën 1.6.2015 transferohet në këtë llogari shuma 326,000 lekë – nga llogaria e pagës së personit të lidhur, e cila bashkohet me shumën 1,702,000 lekë dhe investohet në depozitë me afat. Në datën 4.12.2015 transferohen në këtë llogari shumat 71,400 lekë dhe 81,600 lekë si pagesë qiraje (totali 153,000 lekë) dhe në datën 4.12.2015 transferohet në këtë llogari shuma 600,395 lekë – nga llogaria e pagës së personit të lidhur.

⁹¹ Nga të cilat, shuma prej 2,064,225 lekësh është të investuara në depozitë me afat dhe shuma prej 764,538 lekësh është investuar në depozitë me afat më vete.

⁹² Në datën 24.8.2016 transferohet në llogari shuma 108,800 lekë si pagesë e qirasë për periudhën janar – gusht 2016. Në datën 6.12.2016 transferohet në këtë llogari shuma prej 1,445,500 lekësh nga llogaria e pagës së personit të lidhur.

⁹³ Nga të cilat shuma prej 2,064,225 lekësh është investuar në depozitë me afat dhe shuma prej 764,538 lekësh është investuar në depozitë me afat më vete.

Hetimi/verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

28.2 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Intesa Sanpaolo Bank (ish-Banka Amerikane e Shqipërisë) Komisioni konstaton⁹⁴ se në llogarinë bankare në euro të subjektit me nr. ***, pas tërheqjes së kryer të shumës 48,000 euro (trajtuar si më lart – tërhequr shuma para kryerjes së pagesës për apartamentin), në datën 2.7.2010, gjendja e llogarisë ka qenë 202 euro. Në vijim evidentohet se në këtë llogari pas datës 2.7.2010 është kredituar në total vlera 6,118 euro⁹⁵ dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2010 ka qenë në vlerën 6,320 euro.

28.3 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2010, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar se llogaria në Intesa Sanpaolo Bank ka pësuar pakësim për shkak të tërheqjes së shumës 48,000 euro, të përdorur për blerjen e apartamentit, si dhe ka pësuar shtim për shkak të derdhjes së pagës mujore dhe shpërblime të bashkëshortes, rreth 7,000 euro.

28.4 Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie evidentohet se gjatë vitit 2011 në të është kredituar në total shuma 11,253 euro⁹⁶ dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2011 ka qenë në vlerën 17,573 euro.

28.5 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2011, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar shumën 4,500 euro si dhuratë nga i vëllai D.P , për të cilat referon se janë depozituar në llogarinë nr. *** në Intesa Sanpaolo Bank. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se depozitat bankare në emrin e tij dhe të bashkëshortes (së bashku apo veç e veç) janë shtuar në vlerën e interesave bankarë apo nga të ardhurat vjetore të bashkëshortes që janë derdhur nëpër banka, si dhe nga dhurata nga i vëllai.

➤ **Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e krijuara nga vëllai i tij nga puna në emigracion, të deklaruar si të dhuruara në vitin 2011⁹⁷.**

28.6 Gjatë vitit 2012 në këtë llogari është kredituar vlera monetare prej 15,856 euro⁹⁸ dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2012 ka qenë në shumën 33,429 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2012, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar se në depozitat e kursimit të deklaruara më parë janë shtuar interesat bankarë.

28.7 Në kushtet kur rezulton se kjo depozitë gjatë vitit 2012 është shtuar vetëm me vlerën prej 147 euro me burim interesat bankarë, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti/personi i lidhur nuk ka deklaruar shtesën e kësaj pasurie në vlerën 15,709 euro dhe si rrjedhim as burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume.

⁹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 9.5.2023, e Intesa Sanpaolo Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.5.2023.

⁹⁵ (i) Shuma 4,991 euro nga pagat e personit të lidhur; (ii) shuma 1,097 euro, depozituar *cash*; (iii) 30 euro nga interesat.

⁹⁶ (i) Shuma 1,446 euro nga pagat e personit të lidhur; (ii) shuma 4,682 euro, depozituar *cash* nga personi i lidhur; (iii) shuma 4,500 euro, depozituar *cash* nga shtetasi D.P (datë 15.3.2011); (iv) shuma j 550 euro transferuar nga llogaria e personit të lidhur; (v) shuma 75 euro nga interesat bankarë.

⁹⁷ Referojuni trajtimit të bërë mbi dhurimet e vëllait në seksionin “Çështje të tjera” të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

⁹⁸ (i) Vlera 991 euro nga pagat e personit të lidhur; (ii) vlera 14,718 euro, depozituar *cash* nga personi i lidhur; (iii) vlera 147 euro nga interesat bankarë.

28.8 Gjatë vitit 2013 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 17,263 euro⁹⁹ dhe gjendja e saj në datën 31.12.2013 ka qenë në vlerën 50,692 euro¹⁰⁰. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar shtesa në depozitat e kursimit në banka të ndryshme të deklaruara edhe në vitet e mëparshme, pa referuar vlerat konkrete për secilën depozitë, me burim të ardhurat vjetore të bashkëshortes të deklaruara më lart dhe që gjithmonë derdhen në bankë.

28.9 Gjatë vitit 2014 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 930 euro¹⁰¹ dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2014 ka qenë vlerën 51,622 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar se llogaria e kursimit në euro në ISP Bank është ndryshuar, për sa u përket kushteve të depozitës tani ajo quhet depozita stafetë (shumat 35,224 euro dhe 15,925 euro). Gjithashtu ka deklaruar se kjo llogari është shtuar me shumën 353 euro, me anë të transfertës bankare të datës 30.10.2014.

28.10 Gjatë vitit 2015 rezulton se kjo llogari depozitë është shtuar me vlerën 157 euro nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2015 ka qenë në shumën 51,779 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar se depozitat/llogaritë e kursimit kanë pasur shtesa nga interesat bankarë.

28.11 Gjatë vitit 2016 rezulton se në këtë llogari depozitë është shtuar vlera 858 euro nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2016 ka qenë në shumën 52,637 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2016 subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësime të kësaj llogarie depozitë.

28.12 Si konkluzion, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi, llogari depozitë e përbashkët në Intesa Sanpaolo Bank.

29. Zotëron ½ pjesë takuese të pasurisë së llojit depozitë në Veneto Bank, depozitë e përbashkët në emër të tij dhe bashkëshortes V.M, me vlerë totale 46,221 euro.

29.1 Si burim krijimi të kësaj depozite ka deklaruar të ardhurat e përbashkëta familjare ndër vite. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se burimi i depozitës vjen nga llogaria në bankën Italiane Di Sviluppo (sot Veneto Bank), konkretisht llogaria nr. ***, datë 7.10.2008, ndryshuar në llogarinë nr. ***, datë 13.5.2009.

Hetimi/verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

29.2 ISP Bank (ish-Veneto Bank) konfirmon se¹⁰² në llogarinë bankare dyemërore në euro të subjektit dhe personit të lidhur me nr. ***, pas hapjes në datën 7.10.2008 janë kryer tri depozitime *cash*¹⁰³ dhe gjendja e llogarisë në datën 31.12.2008 ka qenë në vlerën 4,285 euro.

29.3 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2008, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar depozitë kursimi në Bankën Italiane të Zhvillimit, krijuar në datën 7.10.2008, shuma 4,285 euro, me burim krijimi të ardhurat e bashkëshortes nga paga, shpërblimet dhe kursime.

⁹⁹ (i) Vlera 2,700 euro nga pagat e personit të lidhur; (ii) vlera 14,105 euro, depozituar *cash* nga personi i lidhur; (iii) vlera 458 euro nga interesat bankarë.

¹⁰⁰ (i) Investuar vlera 34,925 euro, depozitë me afat më vete; (ii) shuma 15,700 euro depozitë me afat më vete; (iii) 67 euro gjendje të lirë në llogari.

¹⁰¹ Vlera 353 euro nga paga e personit të lidhur dhe 577 euro nga interesat bankarë.

¹⁰² Shkresë nr. *** prot., datë 9.5.2023, e Intesa Sanpaolo Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 18.5.2023.

¹⁰³ (i) Në datën 7.10.2008 depozitohet *cash* shuma 1,000 euro; (ii) në datën 16.12.2008 depozitohet *cash* shuma 1,630 euro; (iii) në datën 29.12.2008 depozitohet *cash* shuma 1,650 euro.

29.4 Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie rezulton se gjatë vitit 2009 në këto llogari është kredituar në total shuma 18,832 euro¹⁰⁴ dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2009 ka qenë në vlerën 23,117 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e pasurive, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar depozitën e përbashkët me afat në Bankën Italiane të Zhvillimit, duke referuar se në të janë derdhur të holla + interesi, me burim të ardhurat e bashkëshortes nga pagat, shpërblime etj., në shumën prej rreth 20,000 euro.

29.5 Gjatë vitit 2010 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 661 euro, përfituar nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2010 ka qenë në shumën 23,778 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2010, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se llogaritë ose depozitat e tjera të kursimit të deklaruara më parë janë shtuar me vlerat e përfituara nga interesat bankarë.

29.6 Gjatë vitit 2011 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 501 euro, përfituar nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2011 ka qenë në shumën 24,279 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2011, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se depozitat bankare në emrin e tij dhe të bashkëshortes (së bashku apo veç e veç) janë shtuar në vlerën e interesave bankarë apo nga të ardhurat vjetore të bashkëshortes që janë derdhur nëpër banka, si dhe dhurata nga i vëllai.

29.7 Gjatë vitit 2012 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 485 euro, përfituar nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2012 ka qenë në shumën 24,764 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2012, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar se në depozitat e kursimit të deklaruara më parë janë shtuar interesat bankarë.

29.8 Gjatë vitit 2013 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 2,643 euro¹⁰⁵ dhe gjendja e saj në datën 31.12.2013 ka qenë në vlerën 27,407 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar shtesa në depozitat e kursimit në banka të ndryshme të deklaruar edhe në vitet e mëparshme, pa referuar vlerat konkrete për secilën depozitë, me burim të ardhurat vjetore të bashkëshortes, të deklaruar më lart, dhe që gjithmonë derdhen në bankë.

29.9 Gjatë vitit 2014 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 15,066 euro¹⁰⁶ dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2014 ka qenë vlerën 42,474 euro. Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar se depozita e kursimit në Veneto Bank është shtuar me derdhje të hollash, me burim të ardhurat e bashkëshortes nga paga vjetore, shpërblimet nga përkthime, trajnime e konsulenca, në shumën 14,880 euro.

29.10 Gjatë vitit 2015 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 3,415 euro¹⁰⁷ dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2015 ka qenë vlerën 45,889 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2015, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se depozita e kursimit në Veneto Bak është shtuar në shumën 2,300 euro, me burim të ardhurat e bashkëshortes nga paga vjetore, shpërblimet nga përkthime, trajnime e konsulenca, si dhe me interesat bankarë të përfituar.

➤ **Sa më sipër Komisioni konstaton se në DIPPP-në e vitit 2015, subjekti/personi i lidhur nuk ka deklaruar saktë shtesën e kësaj pasurie, me burim të ardhurat vjetore të personit të lidhur – evidentuar se gjatë këtij viti kjo llogari depozitë është shtuar me vlerën 3,200 euro nga ky burim.**

¹⁰⁴ Shuma 18,525 euro e depozituar *cash*, e kryer nëpërmjet 13 depozitimeve të ndryshme dhe shuma j 307 euro nga interesat vjetorë.

¹⁰⁵ Shuma 2,220 euro, depozituar *cash* nga personi i lidhur në datën 27.12.2013 dhe shuma 423 euro përfituar nga interesat vjetorë bankarë.

¹⁰⁶ Shuma 14,880 euro, kredituar nëpërmjet 7 depozitimeve *cash* dhe shuma 186 euro përfituar nga interesat vjetorë bankarë.

¹⁰⁷ Shuma 3,200 euro, kredituar nëpërmjet 3 depozitimeve *cash* dhe shuma 215 euro nga interesat vjetorë bankarë.

29.11 Gjatë vitit 2016 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 332 euro nga interesat bankarë dhe se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 ka qenë në shumën 46,221 euro.

29.12 Si konkluzion, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi – llogaria depozitë e përbashkët në Veneto Bank.

30. Zotëron ½ pjesë takuese të pasurisë së llojit depozitë në Alpha Bank, depozitë e përbashkët në emër të tij dhe bashkëshortes V.M, me vlerë totale 5,368 euro.

30.1 Si burim krijimi të kësaj depozite ka deklaruar të ardhurat e përbashkëta familjare ndër vite. Gjithashtu, subjekti, duke specifikuar se depozita është çelur më 21.2.2012, ka deklaruar se depozitimet në këtë bankë janë bërë nga të ardhurat familjare ndër vite, lëvizjet, tërheqjet dhe derdhjet e parave nga njëra bankë në tjetrën.

Hetimi/verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

30.2 Alpha Bank konfirmon se¹⁰⁸ në llogarinë bankare dyemërore në euro me nr. ***, të subjektit dhe personit të lidhur, pas hapjes në datën 29.12.2009 është kryer një depozitim *cash* në shumën 7,000 euro dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2009 ka qenë 7,000 euro.

30.3 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar depozitë në emër të tij dhe bashkëshortes në Alpha Bank, me afat 3-mujor, datë 29.12.2009, në shumën 7,000 euro, me burim të ardhurat e bashkëshortes.

30.4 Gjatë vitit 2010 rezulton se në këtë llogari është kredituar nëpërmjet depozitimit *cash* në total shuma 2,785 euro (50 euro janë përfituar nga interesat bankarë) dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2010 ka qenë 23,778 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2010, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se llogaritë ose depozitat e tjera të kursimit të deklaruara më parë janë shtuar me vlerat e përfituara nga interesat bankarë.

30.5 Gjatë vitit 2010 evidentohet se në këtë llogari është depozituar *cash* shuma 2,785 euro, si dhe janë përfituar 50 euro nga kreditimi i interesave bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2010 ka qenë në vlerën 9,835 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar se llogaria në Alpha Bank ka pësuar shtesë për shkak të derdhjes së një shume prej 2,785 euro në datën 9.4.2010.

30.6 Gjatë vitit 2011 nuk evidentohen shtesa/pakësime në këtë llogari dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2011 ka qenë 9,835 euro.

30.7 Gjatë vitit 2012 rezulton se në këtë llogari është kredituar shuma 429 euro nga interesat bankarë dhe është tërhequr në total shuma 5,264 euro¹⁰⁹. Si rrjedhim, gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2012 ka qenë në vlerën 5,000 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2012, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar se në depozitat e kursimit të deklaruara më parë janë shtuar interesat bankarë.

➤ **Sa më sipër, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar pakësimin e kësaj pasurie të llojit llogari depozitë në Alpha Bank.**

30.8 Gjatë vitit 2013 rezulton se në këtë llogari është kredituar shuma 10 euro nga interesat bankarë dhe se është depozituar *cash* shuma 300 euro. Si rrjedhim, gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2013 ka qenë në vlerën 5,310 euro¹¹⁰. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar shtesa në depozitat e kursimit në banka të ndryshme, të deklaruara edhe

¹⁰⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2020, e Alpha Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.9.2020.

¹⁰⁹ Në datën 21.2.2012, personi i lidhur ka tërhequr *cash* shumën 264 euro dhe në datën 22.2.2012 ka tërhequr *cash* shumën 5,000 euro.

¹¹⁰ Shuma 5,160 euro në depozitë dhe 150 euro gjendje e lirë në llogari.

në vitet e mëparshme, pa referuar vlerat konkrete për secilën depozitë, me burim të ardhurat vjetore të bashkëshortes të deklaruar më lart dhe që gjithmonë derdhen në bankë.

30.9 Gjatë vitit 2014 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 141 euro, përfituar nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2014 ka qenë në shumën 5,451 euro¹¹¹. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar se depozitat dhe llogaritë e kursimit në banka, të deklaruara në vitet e mëparshme, janë shtuar me interesat bankarë.

30.10 Gjatë vitit 2015 rezulton se në këtë llogari është kredituar në total shuma 55 euro, përfituar nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2015 ka qenë në shumën 5,506 euro¹¹². Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar se depozitat dhe llogaritë e kursimit në banka, të deklaruara në vitet e mëparshme, janë shtuar me interesat bankarë.

30.11 Gjatë vitit 2016 evidentohet se në këtë llogari është kredituar shuma 12 euro nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2016 ka qenë në total në shumën 5,508 euro, nga të cilat 5,368 euro në depozitë dhe 140 euro të lira në llogari.

30.12 Si konkluzion, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi të llogarisë depozitë e përbashkët në Alpha Bank.

31. Zotëron ½ pjesë takuese të pasurisë së llojit depozitë në Tirana Bank, depozitë e përbashkët në emër të tij dhe bashkëshortes V.M, me vlerë totale 5,166 euro.

31.1 Si burim krijimi të kësaj depozite ka deklaruar të ardhurat e përbashkëta familjare ndër vite. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kjo depozitë është çelur në datën 29.12.2009.

Hetimi/verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

31.2 Tirana Bank konfirmon se¹¹³ në llogarinë nr. *** të personit të lidhur, pas hapjes në datën 29.12.2009, është kryer një depozitim *cash* nga personi i lidhur në shumën 13,000 euro dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2009 ka qenë 13,000 euro, të investuara në depozitë me afat.

31.3 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar depozitë e përbashkët me afat 3-mujor, hapur në datën 29.12.2009, në Tirana Bank, me burim të ardhurat e bashkëshortes.

31.4 Gjatë vitit 2010 rezulton se kjo llogari është kredituar me vlerën 297 euro, përfituar nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2010 ka qenë në shumën 13,297 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2010, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se në depozitat e kursimit të deklaruara më parë janë shtuar interesat bankarë.

31.5 Gjatë vitit 2011 rezulton se kjo llogari është kredituar me vlerën 189 euro, përfituar nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2011 ka qenë në shumën 13,486 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2011, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se në depozitat e kursimit të deklaruara më parë janë shtuar interesat bankarë.

31.6 Gjatë vitit 2012 rezulton se në këtë llogari është kredituar vlera 129 euro, përfituar nga interesat bankarë, si dhe është tërhequr *cash* shuma 8,548 euro¹¹⁴. Si rrjedhim, gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2012 ka qenë në shumën 5,067 euro. Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2012, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar se në depozitat e kursimit të deklaruara më parë janë shtuar interesat bankarë.

¹¹¹ Shuma 5,301 euro në depozitë dhe 150 euro gjendje e lirë në llogari.

¹¹² Shuma 5,356 euro në depozitë dhe 150 euro gjendje e lirë në llogari.

¹¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 9.9.2020, e Tirana Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.9.2020.

¹¹⁴ Në datën 22.2.2012, tërhequr *cash* nga personi i lidhur shuma 8,548 euro.

➤ Sa më sipër, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar pakësimin e kësaj pasurie të llojit llogari depozitë në Tirana Bank.

31.7 Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie depozitë (me afat), Komisioni konstaton se për vitet 2013 – 2016 janë përfituar vlera monetare nga interesat bankarë dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2016 ka qenë në shumën 5,166 euro.

31.8 Si konkluzion, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi – llogaria depozitë e përbashkët në Tirana Bank.

32. Zotëron ½ pjesë takuese të pasurisë së llojit depozitë në BKT, depozitë e përbashkët në emër të tij dhe bashkëshortes V.M, çelur në datën 19.1.2017, me vlerë totale 9,985 euro.

32.1 Si burim krijimi të kësaj depozite ka deklaruar se ajo buron nga: (i) tërheqja e parave nga depozita e kursimit në Credins Bank (depozitë e mbyllur në datën 18.1.2017); (ii) shtesa e të ardhurave nga kontrata me “****”, derdhur në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank gjatë vitit 2016. Gjithashtu, ka sqaruar se vetë depozita në Credins Bank është çelur në datën 22.2.2012, pas një tërheqjeje të hollash nga llogaria në Tirana Bank.

Hetimi/verifikimet e kryera nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

32.2 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Credins Bank¹¹⁵ konstatohet se në llogarinë dyemërore të subjektit dhe të personit të lidhur me nr. ***, në datën 22.2.2012, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën 7,000 euro dhe se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2012 ka qenë 7,000 euro, të investuara në depozitë me afat. Gjatë viteve 2012 – 2016 evidentohet se në këtë llogari janë kredituar 618 euro¹¹⁶ nga interesat bankarë dhe se në datën 18.1.2017 është tërhequr *cash* vlera prej 7,618 euro¹¹⁷, e cila deklarohet se ka shërbyer pjesërisht për hapjen e depozitës në shumën 10,000 euro në BKT, deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

32.3 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2016, në seksionin e pasurive, personi i lidhur ka deklaruar se disponon në gjendje *cash* vlerat monetare prej 20,000 lekë dhe 6,000 euro, me burim tërheqjen nga llogaria rrjedhëse nr. ***, në Raiffeisen Bank, ku ishin depozituar të ardhura nga kontrata me “****”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga Raiffeisen Bank konfirmohet se nga kjo llogari gjatë vitit 2016 është tërhequr *cash* vlera prej 9,100 euro.

32.4 Nga ana tjetër, rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* (depozituar në ILDKPKI, në datën 30.1.2017) personi i lidhur ka deklaruar se disponon *cash* vlerat monetare 23,000 lekë dhe 3,000 euro.

32.5 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni¹¹⁸ mbi likuiditetet *cash*, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “...Në datën 18.1.2017 (12 ditë para dorëzimit të deklaratës *Vetting*), depozita me afat nr. ***, në Credins Bank, në emër të Elio Mazreku e V.M, u mbyll. Shuma 7,618 euro u derdh më pas në një llogari kursimi nr. ***, në BKT, në emër të Elio Mazreku dhe V.M, çelur më 19.1.2017, pra një ditë pas mbylljes së depozitës në Credins. Po ashtu, aty u shtuan rreth 3,000 euro (nga 6,000 euro gjithsej të ardhura të V.M nga kontrata me ***, derdhur në llogarinë rrjedhëse të saj në Raiffeisen Bank gjatë vitit 2016)”.

32.6 Gjithashtu, konstatohet se në DIPP-në e vitit 2017 subjekti ka deklaruar llogarinë e përbashkët të kursimit në BKT (në emër të tij dhe bashkëshortes), me nr. ***, çelur në datën

¹¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2020, e Credins Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.12.2020.

¹¹⁶ Shuma 208 euro nga interesat bankarë në vitin 2013; shuma 207 euro nga interesat bankarë në vitin 2014; shuma 139 euro nga interesat bankarë në vitin 2015; shuma 64 euro nga interesat bankarë në vitin 2016.

¹¹⁷ Në datën 18.1.2017, tërhequr *cash* nga personi i lidhur shuma 7,618 euro.

¹¹⁸ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. ***.

19.1.2017, duke referuar se depozitimi në këtë bankë buron nga tërheqja e parave nga depozita e kursimit Credins Bank, nr. *** (mbyllur në datën 18.1.2017) dhe se, po ashtu, u shtuan të ardhura të bashkëshortes nga kontrata me “***”, derdhur në llogarinë rrjedhëse të saj në Raiffeisen Bank gjatë vitit 2016.

32.7 BKT-ja konfirmon se¹¹⁹ në llogarinë dyemërore të subjektit dhe personit të lidhur me nr. ***, në datën 19.1.2017, personi i lidhur ka kryer një depozitim *cash* në shumën 10,000 euro dhe se gjendja e llogarisë në datën 30.1.2017 ka qenë 9,985 euro, të investuara në depozitë me afat dhe 15 euro në gjendje të lirë.

32.8 Si konkluzion, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi – llogaria depozitë e përbashkët në BKT.

33. Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank, çelur në datën 3.3.2005, me gjendje (në momentin e dorëzimit të deklaratës) në shumën 502,343 lekë.

33.1 Si burim krijimi të kësaj llogarie, subjekti ka deklaruar: (i) të ardhurat nga paga e tij si prokuror (të derdhura në këtë llogari deri në vitin 2009 – kur derdhej paga në këtë bankë); (ii) të ardhurat nga qiraja e banesës së përbashkët (dhënë me qira fondacionit “*** Shqipëri”); (iii) tri transfertat nga Q.R.M (***) për konsulencë që ka zhvilluar në disa takime.

33.2 Raiffeisen Bank¹²⁰ konfirmon se në llogarinë bankare në lekë të subjektit (nr. ***) ka filluar të kreditohet paga prej datës 31.3.2005 deri më 16.12.2009. Më pas, gjatë vitit 2010, kjo llogari është përdorur për kryerjen e pagesave utilitare, e në vijim, në vitet 2011 – 2015, në këtë llogari është kredituar qiraja e paguar nga “*** ” për pasurinë e llojit apartament në pronësi të subjektit dhe personit të lidhur. Gjithashtu, konstatohet se në këtë llogari, në vitet 2011 dhe 2014, janë kryer dy kreditime me anë të transfertës bankare¹²¹, me dërgues (urdhërues) të identifikuar Q.R.M (***), në total në shumën 82,800 lekë. Rezulton se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 ka qenë në shumën 502,343 lekë.

33.3 Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi – llogaria depozitë e përbashkët në BKT.

34. Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank, çelur në datën 3.3.2005, me gjendje (në momentin e dorëzimit të deklaratës) në shumën 429 euro. Si burim krijimi të kësaj llogarie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga rimbursimet, pagesat për viza dhe dërgesa vizash me postë.

34.1 Raiffeisen Bank¹²² konfirmon se në llogarinë bankare në euro të subjektit (nr. ***), gjatë viteve 2012 – 2016 janë kredituar me transfertë disa vlera monetare, në total shuma 429 euro¹²³ nga viti 2012 – 2016. Gjithashtu, konstatohet se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 ka qenë 429 euro.

¹¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2020, e BKT-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.9.2020.

¹²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020.

¹²¹ Në datën 2.3.2011 kreditohet vlera prej 45,000 lekësh, me përshkrimin “Q.R.M *** pagesë eksperti projekti i ligjeve”, si dhe në datën 10.4.2014 kreditohet vlera prej 37,800 lekësh, me përshkrimin “Q.R.M, ***, E. Mazreku expert net fee”.

¹²² Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020.

¹²³ (i) Në datën 23.10.2012, kredituar 150 euro nga “*** (Franca)”, me përshkrimin “Advanced training for judges and p.”; (ii) në datën 9.7.2013, kredituar 84 euro nga “*** (Irlanda)”, me përshkrimin “Visa and shipping costs”; (iii) në datën 13.11.2015, kredituar 195 euro nga States of Guernsey (Britania e Madhe), me përshkrimin “Visa refund”.

34.2 Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi – llogaria rrjedhëse në Raiffeisen Bank.

35. Fond investimi, R.P, në shumën 2,889,026 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar likuiditetet që ishin të depozituara në depozitë kursimi në Raiffeisen Bank (llogaria nr. ***), si dhe likuiditete të cilat ishin në llogari rrjedhëse po në Raiffeisen Bank (llogaria nr. ***).

35.1 Nga verifikimi i informacionit dhe dokumentacionit të përftuar nga Raiffeisen Bank¹²⁴ rezulton se në datën 15.1.2001 subjekti dhe personi i lidhur kanë hapur një llogari dyemërore pranë ish-Bankës së Kursimeve (sot Raiffeisen Bank) dhe se gjatë vitit 2001 kanë depozituar 960,000 lekë, ndërsa 9,613 lekë janë kredituar nga interesat bankarë të përfituar. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2001 ka qenë 969,613 lekë.

35.2 Gjatë vitit 2002, në këtë llogari është depozituar *cash* shuma prej 200,000 lekësh dhe janë përfituar interesat bankarë në vlerën 55,760 lekë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2002 ka qenë në shumën 969,613 lekë.

35.3 Gjatë vitit 2003, nga kjo llogari është tërhequr *cash* shuma prej 710,000 lekësh dhe, nga ana tjetër, është kredituar prej 87,821 lekësh nga interesat bankarë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2003 ka qenë 603,194 lekë.

35.4 Komisioni konstaton se në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003 (dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së në datën 26.3.2004) subjekti ka deklaruar depozitë kursimi nr. *** në emër të tij dhe të bashkëshortes, hapur në datën 15.1.2001, në shumën 603,000 lekë, me burim të ardhurat nga pagat, përkthimet, hartimin e raporteve juridike e mjedisore prej tij dhe bashkëshortes, si dhe të ardhura të sjella nga i vëllai në emigracion.

35.5 Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar rezulton se gjatë vitit 2004, e më konkretisht deri në datën 30.9.2004, në këtë llogari janë kredituar interesat në vlerën 27,217 lekë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 30.9.2004 ka qenë në shumën 628,425 lekë (llogari pranë ish-Bankës së Kursimeve).

35.6 Raiffeisen Bank¹²⁵ konfirmon se teprica e llogarisë në shumën 628,425 lekë, e cila ishte e mbartur nga llogaria ekzistuese në ish-Bankën e Kursimeve (trajtuar si më lart) në datën 1.10.2004, ka vijuar të investohet tashmë në Raiffeisen Bank në depozitë me afat, ku rezulton se për vitet 2005 – 2008 janë shtuar vetëm interesa bankarë vjetorë¹²⁶ dhe se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2008 ka qenë 711,142 lekë.

35.7 Në vijim të verifikimit të dokumentacionit bankar të administruar në dosje, duket se në vitin 2009, në llogarinë ku kreditohet paga e subjektit, është akumuluar në total shuma prej 980,000 lekësh¹²⁷, e transferuar në llogarinë e depozitës së evidentuar si më sipër. Gjithashtu, konstatohet se gjatë vitit 2009 në llogarinë depozitë janë përfituar interesa bankarë në total në shumën 49,974 lekë. Rezulton se të gjitha këto shuma janë investuar në dy depozita me afat, përkatësisht: (i) në vlerën 1,000,000 lekë; (ii) në vlerën 742,558 lekë.

¹²⁴ Referojuni dokumentit “Vërtetim” nr. *** prot., datë 10.5.2023, lëshuar nga Raiffeisen Bank, depozituar nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***.

¹²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020.

¹²⁶ (i) Për vitin 2005, përfituar interesa bankarë në vlerën 31,384 lekë; (ii) për vitin 2006, përfituar interesa bankarë në vlerën 7,472 lekë; (iii) për vitin 2007, përfituar interesa bankarë në vlerën 12,709 lekë; (iv) për vitin 2008, përfituar interesa bankarë në vlerën 32,978 lekë.

¹²⁷ (i) Në datën 14.5.2009, fondet e akumuluar te llogaria e pagës në shumën 680,000 lekë transferohen nga llogaria personale e pagës e subjektit (nr. ***) tek llogaria e depozitës dhe investohen me afat; (ii) në datën 15.10.2009, fondet e akumuluar te llogaria e pagës së subjektit (nr. ***) në shumën 300,000 lekë transferohen te llogaria e depozitës dhe investohen me afat.

35.8 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar se në Raiffeisen Bank është çelur depozita me afat në datën 14.5.2009, në shumën 1,000,000 lekë, me burim transferim të hollash nga llogaria rrjedhëse e pagës në depozitë.

35.9 Në vijim, për vitet 2010 – 2012, duket se në këtë llogari është kryer vetëm një depozitim *cash* në vlerën 45,000 lekë¹²⁸ dhe janë përfituar interesa bankarë në total në shumën 220,696 lekë¹²⁹. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2012 ka qenë në shumën 2,008,292 lekë.

35.10 Evidentohet se gjatë vitit 2013 në këtë llogari janë shtuar interesat vjetorë në shumën 88,565 lekë¹³⁰, si dhe një shumë prej 300,000 lekësh¹³¹, me burim të ardhurat nga qiraja, paguar nga fonacioni “***” për apartamentin e ndodhur në rrugën “***”, në pronësi të subjektit dhe personit të lidhur. Gjendja e kësaj llogarie depozitë në datën 30.12.2012 ka qenë në vlerën 2,396,910 lekë, e cila është investuar nga subjekti në R.I – fondi R.P, me përshkrimin “Kalim fondesh për R.I Elio Mazreku”.

35.11 Konstatohet se në DIPP-në e vitit 2013 personi i lidhur ka deklaruar se është mbyllur depozita e kursimit në Raiffeisen Bank, për t’u investuar në fond investimi në R.P shuma prej 2,396,910 lekësh.

35.12 Në vijim të verifikimit dhe analizimit të dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit¹³², duket se në datën 30.1.2017 vlera e kuotave në pronësi të subjektit në fondin e investimit R. P ka qenë në shumën 2,890,133 lekë, e cila duket se është e përafërt me atë të deklaruar nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* (deklaruar vlera 2,889,026 lekë).

❖ Pasuri të deklaruara veçmas nga personi i lidhur, znj. V.M

36. Zotëron 25% pjesë takuese të pasurisë së llojit apartament me sipërfaqe 64 m², ndodhur në rrugën “*”, përfituar nga ligji i privatizimit.**

36.1 Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë ndër vite pjesën takuese që zotëronte mbi këtë pasuri.

36.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së mbi këtë pasuri: Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

36.3 Pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi informacionin/dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ¹³³ për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe burimin e krijimit të saj, rezulton se në datën 27.7.1993 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. V.Sh, vëllai i saj G.Sh dhe prindërit e tyre Sh dhe H.Sh, kanë blerë¹³⁴ nga N.K.B, sektori nr. ***, Tiranë, pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 64 m², në pallatin nr. ***, apartamenti nr. ***, të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, për vlerën 9,568 lekë. Referuar informacionit të përcjellë në ILDKPKI nga ZVRPP-ja Tiranë (shkresa e datës 11.5.2018), konfirmohet se pasuria e sipërcituar figuron e regjistruar në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. V.Sh, vëllait të saj G.Sh dhe prindërve të tyre Sh dhe H.Sh.

¹²⁸ Në datën 22.12.2011 depozitohet *cash* nga subjekti shuma 45,000 lekë.

¹²⁹ (i) Për vitin 2010, përfituar interesat bankarë në vlerën 80,608 lekë; (ii) për vitin 2011, përfituar interesat bankarë në vlerën 99,268 lekë; (iii) për vitin 2012, përfituar interesat bankarë në vlerën 40,820 lekë.

¹³⁰ Kredituar interesat në datën 22.6.2013, në shumën 88,565 lekë.

¹³¹ Rezulton se qiraja është paguar në llogarinë tjetër të subjektit në Raiffeisen Bank dhe nga kjo llogari në datën 30.12.2013 është transferuar shuma prej 300,000 lekësh në llogarinë e depozitës.

¹³² Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2017, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³³ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); (ii) shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2018, e ZVRPP-së Tiranë, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (ndodhur në aneksin nr. ***).

¹³⁴ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.1993, redaktuar nga noteri publik, znj. M.S.

36.4 Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie dhe pjesën takuese që ajo zotëronte mbi të, si dhe se nuk ka dyshime për burimin e krijimit të saj.

37. Fond investimi, R.P, në shumën 8,060 euro. Ka deklaruar se depozitimi i parave në këtë fond buron nga paratë që ishin tashmë të depozituara në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank (llogaria nr. ***) etj.

37.1 Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar se bashkëshortja V.M ka përfituar të ardhura nga puna si eksperte e kontraktuar nga instituti “****” për 3 projekte, kontrata G.Z, Fushë-Arrëz, shuma 11,200 euro.

37.2 Siç u evidentua më sipër, me qëllim provueshmërinë e përfitimit të këtyre të ardhurave në shumën 11,200 euro, subjekti ka depozituar një kontratë shërbimi në gjuhë të huaj¹³⁵, lidhur midis institutit “****” dhe shtetases V.M, ku është përcaktuar shpërblimi i personit të lidhur për shërbimin si eksperte në vlerën bruto 12,444 euro, për të cilat duket se është përcaktuar se nga instituti “****” do të mbahej tatimi në burim në masën 10%. Rezulton se në datën 8.12.2009, në llogarinë e personit të lidhur, është kredituar nga instituti “****” shuma 11,183 euro, me përshkrimin “***, pagesë shlyerje kontrate”.

37.3 Në vijim të verifikimit të informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Raiffeisen Bank¹³⁶, rezulton se gjatë viteve 2009 – 2011 në këtë llogari janë kredituar vetëm interesat bankarë vjetorë në shumën totale 235 euro. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2011 ka qenë 11,418 euro.

37.4 Gjatë vitit 2012 rezulton se në këtë llogari është depozituar *cash* nga personi i lidhur shuma 7,000 euro, si dhe janë përfituar interesa bankarë në vlerën 135 euro. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2012 ka qenë 18,592 euro¹³⁷.

37.5 Në datën 18.3.2013, nga vlera totale e llogarisë së sipërcituar – shuma prej 8,060 euro është investuar në fondin R.I.

➤ **Sa më sipër, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2013 subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar investimin e kryer në R. I, në vlerën 8,060 euro.**

37.6 R.I¹³⁸ konfirmon se në datën 20.3.2013 personi i lidhur ka investuar në blerjen e rreth 79 kuotave për vlerën 8,060 euro. Duket se në datën 30.1.2017 këto kuota kanë pasur vlerën 9,056 euro¹³⁹.

37.7 Nga ana tjetër, Komisioni konstaton se pjesa e mbetur e fondeve në llogarinë pranë Raiffeisen Bank (nr. ***), në shumën 11,180 euro, ka vijuar të investohet në depozitë me afat dhe se gjendja e kësaj llogarie sipas viteve ka qenë: (i) Në datën 31.12.2014, shuma 11,180 euro, investuar në depozitë me afat dhe 11 euro janë në gjendje të lirë në llogari; (ii) Në datën 31.12.2015, shuma 11,180 euro, investuar në depozitë dhe 22 euro janë në gjendje të lirë në llogari. Vlen të evidentohet këtu se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar: “*Llogari rrjedhëse nr. ***, në Raiffeisen Bank, në euro, në fillim të vitit 2015 shuma 11 euro; në fund të vitit 2015 shuma 22 euro*”; (iii) në datën 31.12.2016, shuma 11,180 euro rezulton e investuar në depozitë dhe shuma 785 euro është në gjendje të lirë në llogari. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Llogari rrjedhëse nr. ***, në Raiffeisen Bank, në emër të V.M, ka shërbyer si llogari ku janë derdhur të ardhura nga kontrata trajnimi për programin “****”*”.

¹³⁵ Kontratë në gjuhë të huaj lidhur në datën 15.1.2009 midis *** dhe shtetases V.M për shumën bruto 12,444 euro, ndodhur në aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. ***, datë 16.9.2020.

¹³⁷ Shuma 11,180 euro investuar në depozitë me afat, shuma 7,277 euro investuar në depozitë me afat dhe 135 euro në gjendje të lirë në llogari.

¹³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, protokolluar në Komision me nr. ***prot., datë 16.9.2020.

¹³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2017, ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së. Faqe ***.

***, *shtuar 762 euro*". Rezulton se këto vlera kanë qenë gjendje edhe në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, në datën 30.1.2017.

37.8 Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka deklaruar llogari rrjedhëse, depozitë pa afat në Raiffeisen Bank, çelur në datën 5.10.2006, me gjendje në vlerën 785 euro. Si burim krijimi të kësaj llogarie ka referuar të ardhurat nga: (i) konsulencat; (ii) punë të ndryshme; (iii) kontrata nga fondacione dhe ente të tjera; (iv) trajnimet. Gjithashtu, ka deklaruar se kalimet janë bërë në llogari bankare të ***, ***, I. H, ***, ***, ***, ***, ***, ***, ***, ***. *** etj.

37.9 Duket se kjo vlerë e deklaruar përkon me gjendjen e lirë të fondeve në llogarinë në Raiffeisen Bank, të analizuar si më sipër.

➤ **Nga ana tjetër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka deklaruar pasurinë e llojit depozitë në vlerën 11,180 euro – evidentuar si gjendje në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank.**

37.10 Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës lidhur me këtë konstatim, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i kësaj depozite ka qenë një harresë nga ana e tij apo e personit të lidhur.

37.11 Lidhur me këtë situatë, në kushtet kur kemi të bëjmë me pasuri e cila evidentohet në llogari bankare, pra një pasuri e cila hipotetikusht nuk mund t'i shmanget kontrollit, Komisioni çmon se me rëndësi paraqitet vlerësimi i burimeve financiare që janë përdorur për krijimin e saj.

37.12 Por, nga ana tjetër – për sa kohë për periudhën e rivlerësimit janë krijuar disa llogari bankare të llojit rrjedhëse/depozitë, si dhe fonde investimi dhe/apo pasuri të tjera, duke pasur edhe ndërthurje midis tyre – Komisioni vlen të sqarojë këtu se ligjshmëria e burimeve financiare të krijimit të tyre është trajtuar në tërësi, bazuar në rezultatet e analizës financiare përfundimtare.

➤ **Gjithsesi, Komisioni vlerëson se edhe në këtë rast subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë, sipas leximit *acontrario* të nenit 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016.**

38. Llogari rrjedhëse, depozitë pa afat, në Raiffeisen Bank, çelur në datën 5.10.2006, me gjendje në vlerën 193,325 lekë

38.1 Si burim krijimi të kësaj llogarie ka deklaruar: (i) të ardhurat nga paga si pedagoge në Universitetin ***; (ii) të ardhurat nga konsulenca; (iii) të ardhurat nga punë të ndryshme; (iv) pagesa dietash; (v) shlyerje kontratash nga fondacione të tjera; (vi) të ardhura nga trajnimet. Gjithashtu, ka deklaruar se kalimet janë bërë në llogari bankare të ***, ***, ***, ***, Qendra ***, *** etj.

38.2 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga Raiffeisen Bank¹⁴⁰, Komisioni konstaton se në llogarinë bankare të personit të lidhur në valutën lekë (llogaria nr. ***), e hapur në datën 16.5.2008, është kredituar gjatë vitit 2008 shuma prej 127,100 lekësh¹⁴¹ dhe se gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2008 (datë 31.12.2008) ka qenë në vlerën 107,200 lekë.

¹⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020.

¹⁴¹ (i) Transfertë në mbërritje në datën 16.5.2009, shuma prej 19,900 lekësh, me përshkrimin "Pag. dieta nga fondi *** Shoq. për ruajtjen e natyrës", të cilat personi i lidhur i ka tërhequr në datën 19.5.2008; (ii) transfertë në mbërritje në datën 22.12.2008, shuma 29,700 lekë, me përshkrimin "HON, V.M"; (iii) transfertë në mbërritje në datën 24.12.2008, shuma 77,500 lekë me përshkrimin "Pagesë 8 ditë fee dhe 8 ditë *** nga shoq. për ruajtjen e natyrës".

38.3 Në DIPP-në e vitit 2009, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “...*Bashkëshortja V.M eksperte e kontraktuar nga ***... kontrata komuna D, datë 7.9.2009, shuma 1,380,000 lekë... kontrata komuna G.Z, datë 1.10.2009, shuma 1,214,400 lekë...*”.

38.4 Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie konstatohet se gjatë vitit 2009 është kredituar shuma 2,702,055 lekë¹⁴² nga instituti “***”, të cilat, së bashku me gjendjen ekzistuese në llogari, janë tërhequr të gjitha *cash* nga personi i lidhur brenda vitit¹⁴³ dhe se gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2009 (datë 31.12.2002) ka qenë zero.

38.5 Gjatë viteve 2010 – 2012 rezulton se në këtë llogari nuk janë kryer transaksione. Ndërsa, për periudhën 2013 – 2016 duket se në këtë llogari për disa muaj është kredituar paga e personit të lidhur, si dhe është kredituar me disa transfertë nga palë të treta, në total shuma prej 23,800 lekësh. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 ka qenë në vlerën 193,324 lekë.

38.6 Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi – llogaria rrjedhëse në Raiffeisen Bank.

39. Llogari kursimi në Intesa Sanpaolo Bank, çelur në datën 21.10.2008, me gjendje në vlerën 113,159 lekë. Si burim krijimi të kësaj llogarie ka deklaruar të ardhurat nga paga, trajnime, konsulenca etj.

39.1 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga ISP Bank, konfirmohet gjendja e deklaruar e kësaj llogarie në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

❖ **Pasuritë e deklaruara veçmas nga personi i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, D.P**

40. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, vëllai i subjektit ka deklaruar pasuritë si vijon: (i) Para të derdhura në ABC Bank (Agricultural Bank of China) në vlerën 9,986 CNY. Pjesa takuese 100%. Llogaria nr. ***, çelur më 24.12.2015; (ii) Para gjendje *cash* që i ka në banesën e tij në Kinë, në vlerat 20,000 CNY dhe 760 USD. Pjesa takuese 100%; (iii) Ka blerë pajisje ndërtimi që kushtojnë mbi 15.500 CNY (ekuivalent me 300.000 lekë). Këto përdoren aktualisht prej tij. Pagesat janë bërë nga paratë që ka fituar ndër vite në Kinë. (*Për shembull, kam Faro freestyle 3D handheld 3D laser scanner, që kushton 12.000 USD, blerë nga *** (M); një laser scanner që kushton mbi 6,000 USD; pajisje TruPulse 360R laser finder, me vlerë 2,120 USD, blerë nga H. Makineri të ndryshme kushtojnë gjithsej mbi 20,000 USD*). Referon që vlera totale e makinerive mund të jetë 100,000 USD. Ato elektronike ndoshta 30,000 USD. Pjesa takuese: 100%.

➤ **Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e pretenduara si burim krijimi të këtyre pasurive. Gjithashtu, duket se personi i lidhur nuk ka deklaruar pjesët e tij takuese në pasuritë e paluajtshme të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në të cilat ai figuron si bashkëpronar.**

¹⁴² (i) Transfertë në mbërritje në datën 8.12.2008, shuma 1,213,185 lekë, me përshkrimin “Shlyerje kontrate datë 1.10.2009 nga ***”; (ii) transfertë në mbërritje në datën 8.12.2008, shuma 1,378,620 lekë, me përshkrimin “Shlyerje kontrate datë 7 shtator nga ***”; (iii) transfertë në mbërritje në datën 10.12.2009, shuma 110,250 lekë, me përshkrimin “Dieta”.

¹⁴³ (i) Në datën 21.1.2009, tërhequr shuma 107,200 lekë; (ii) në datën 12.12.2009, tërhequr shuma 110,250 lekë; (iii) në datën 21.12.2009, tërhequr shuma 2,591,800 lekë.

40.1 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegimet/argumentet e tij mbi këto konstatime, në funksion të provueshmërisë së ligjshmërisë së burimeve financiare të personit të lidhur – të deklaruara si burim krijimi i pasurive, si dhe mosdeklarimit prej tij të pjesëve takuese në disa pasuri të paluajtshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

40.2 Nëpërmjet prapësimeve subjekti ka kërkuar që vëllai i tij të mos përfshihet në kategorinë e personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të cilët mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë, kjo për shkak të rrethanave, nga ku rezulton se ai prej më shumë se 20 vjetësh jeton jashtë vendit. Gjithsesi, në përpjekje për të provuar qëndrimin e vëllait në emigracion, punën e kryer dhe të ardhurat e përfituara, vërehet se subjekti ka depozituar disa materiale shkresore, si *email*-e, fotografi, deklaratë noteriale të vëllait, kopje transfertash bankare, lëvizje llogarie, mandate të thjeshta dhe kontrata, kryesisht të përkthyer nga gjuha kineze, etj.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit/analiza e provave dhe ligjit të zbatueshëm

40.3 Në vlerësim dhe shqyrtim të pretendimeve të bëra nga subjekti, trupi gjykues vëren se në kushtet kur për periudhën e rivlerësimit vëllai i subjektit është në të njëjtën certifikatë familjare me të, ai është kategorizuar në cilësinë e personit të lidhur në përputhje me pikën 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Vlen të theksohet këtu se vetë subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë edhe për vëllain e tij, që lidhet me deklarimin për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

40.4 Nga ana tjetër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e deklaruara si burim krijimi të pasurive të vëllait. Për më tepër, duket se ai nuk ka bërë përpjekje serioze për disponimin e këtij dokumentacioni.

40.5 Si konkluzion, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, duke u vendosur në kushtet e parashikuara sipas leximit *acontrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e këtij ligji.

❖ Gjetje/Çështje të tjera

41. Investimi në institucionin financiar R.I

41.1 Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga R. I¹⁴⁴, personi i lidhur ka investuar në fond investimi në këtë institucion financiar, konkretisht në datën 25.6.2012, shumën prej 140,000 lekësh (duke blerë 137 kuota).

41.2 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investimin e kryer në fondin R.I, në shumën prej 140,000 lekësh.

41.3 Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga Raiffeisen Bank¹⁴⁵, konstatohet se në datën 22.6.2012, nga llogaria e subjektit në të cilën kreditohen shumat e përfituara nga dhënia me qira e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, është investuar shuma prej 140,000 lekësh për blerjen e kuotave pranë R.I. Rezulton se në datën 30.1.2017 këto kuota kanë pasur vlerën 189,942 lekë¹⁴⁶.

➤ **Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti/personi i lidhur nuk ka deklaruar pasurinë e llojit depozitë – në fond investimi, me kuota në vlerën 189,942 lekë.**

¹⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e R.I, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020.

¹⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020.

¹⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2017, e R.I, ndodhur në aneksin nr. *** , në dosjen e ILDKPKI-së.

41.4 Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës lidhur me këtë konstatim, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i kësaj depozite ka qenë një harresë nga ana e tij apo e personit të lidhur.

41.5 Lidhur me këtë mosdeklarim, në kushtet kur kemi të bëjmë me pasuri që evidentohet në llogari bankare, pra një pasuri e cila hipotetakisht nuk mund t'i shmanget kontrollit, Komisioni çmon se edhe në këtë rast me rëndësi paraqitet vlerësimi i burimeve financiare, të cilat janë përdorur për krijimin e saj. Por, nga ana tjetër – për sa kohë për periudhën e rivlerësimit janë krijuar disa llogari bankare të llojit rrjedhëse/depozitë, fonde investimi dhe/apo pasuri të tjera – duke pasur edhe ndërthurje midis tyre, Komisioni vlen të sqarojë këtu se ligjshmëria e burimeve financiare të krijimit të tyre është trajtuar në tërësi – bazuar në rezultatet e analizës financiare përfundimtare.

➤ **Gjithsesi, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë, sipas leximit *acontrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.**

42. Dhurimet e deklaruara nga personi i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, D.P

42.1 Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në seksionin e deklarimit të të ardhurave, subjekti ka deklaruar: “[...] *Të ardhura nga im vëlla, të sjella ndër vite, pasi ishte në emigracion. Këto vlera kanë qenë sjellë edhe para se të nisja punën në prokurori edhe gjatë saj. Një herë paratë janë derdhur prej tij në shumën 4,500 euro në llogarinë nr. ***, në Intesa Sanpaolo Bank. Të tjera dokumente nuk disponoj. Gjithsej, mund të jenë në vlerën 22,000 (njëzet e dy mijë) euro [...]*”.

42.2 Gjithashtu, Komisioni konstaton se krahas të ardhurave të deklaruara si të krijuara nga puna e vëllait të subjektit – të referuara si burim i krijimit të llogarive bankare (evidentuar si më sipër), në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë të depozituara në ILDKPKI, në seksionin e deklarimit “Dhurime dhe trajtime preferenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlera monetare të dhuruara nga personi i lidhur, vëllai i tij D.P , si vijon: (i) në DIPP-në e vitit 2010, vlerën 5,000 euro; (ii) në DIPP-në e vitit 2011, vlerën 4,500 euro; (iii) në DIPP-në e vitit 2012, vlerën 7,000 euro; (iv) në DIPP-në e vitit 2013, vlerën 5,000 euro; (v) në DIPP-në e vitit 2014, vlerën 3,000 euro.

42.3 Duket se personi i lidhur, vëllai i subjektit, D.P , në dokumentin në dukje të nënshkruar prej tij, shkresë e thjeshtë me titull “Deklaratë me sqarime për procesin e *Vetting*-ut”, depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, ka pranuar dhënien e këtyre vlerave monetare subjektit të rivlerësimit.

➤ **Komisioni konstatoi se me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar, si dhe gjatë hetimit administrativ – subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i këtyre shumave të dhuruara në favor të subjektit. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.**

42.4 Pas shqyrtimit dhe analizimit të prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti, Komisioni vëren se ai nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e vëllait të tij nga puna në emigracion.

42.5 Si konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se këto shuma të deklaruara si të dhuruara prej vëllait nuk mbulohen me burime financiare të ligjshme e, për rrjedhojë, ato nuk do të reflektohen në analizën financiare si të ardhura të mundshme për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

43. Analiza financiare për periudhën para deklaratës fillestare të pasurisë (1995 – 31.12.2003), si dhe për vitet 2004 – 2016

43.1 Komisioni evidentoi pasuritë e deklaruara nga subjekti në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie të vitit 2003 (dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së në datën 26.3.2004), si më poshtë:

43.1.1 Automjet i markës “***”, tip “****”, me vlerë 300,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat financiare familjare nga rrogat, përkthime. DPSHTRR-ja¹⁴⁷ konfirmon se në datën 8.9.2003 subjekti ka blerë në shtetin gjerman automjetin tip “****”, vit prodhimi 1992, kundrejt çmimit 1,200 euro (ekuivalent i shumës 162,000 lekë) dhe ka paguar për zhdoganimin e mjetit 158,000 lekë. Pra, në total duket se ky automjet ka kushtuar 320,000 lekë, pa përllogaritur këtu koston e transportit nga Gjermania në Shqipëri dhe shpenzimet e kryera për regjistrimin dhe targimin e tij në shtetin shqiptar.

43.1.2 Depozitë kursimi në Bankën e Kursimeve, në shumën 400,000 lekë, arka nr. *** Tiranë, numri i depozitës nr. ***, me burim krijimi të ardhura të mbledhura ose të sjella prej vëllait nga emigracioni dhe gjatë kohës kur punonte në Shqipëri.

43.1.2.1 Raiffeisen Bank¹⁴⁸ konfirmon se në datën 30.5.2000 subjekti ka pasur gjendje në llogarinë e Bankës së Kursimeve me nr. *** shumën prej 1,343,720 lekësh, të mbartur nga një periudhë e mëparshme. Gjatë vitit 2000, nga kjo llogari është tërhequr shuma 500,000 lekë dhe është kredituar vlera 37,876 lekë nga interesat bankarë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2000 ka qenë në shumën 881,529 lekë. Gjatë vitit 2001, në këtë llogari janë kredituar 53,972 lekë nga interesat bankarë dhe gjendja e saj në datën 31.12.2001 ka qenë në shumën 935,501 lekë. Në vitin 2002, nga kjo llogari: (i) është tërhequr shuma prej 629,922 lekësh; (ii) është kredituar vlera prej 49,421 lekësh nga interesat bankarë; (iii) është depozituar vlera *cash* prej 45,000 lekësh. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2002 ka qenë 400,000 lekë. Gjatë vitit 2003, në këtë llogari janë kredituar interesat bankarë në vlerën totale prej 26,421 lekësh dhe gjendja e saj në datën 31.12.2003 ka qenë në vlerën 426,421 lekë.

43.1.3 Depozitë kursimi nr. *** i kartelës në emër të Elio Mazreku/ose V.Sh.M, datë 15.1.2001, të holla të mbledhura nga rrogat dhe nga përkthimet; hartimi i raporteve juridike e mjedisore prej tij dhe bashkëshortes, si dhe të ardhura të sjella prej vëllait nga emigracioni, shuma 603,000 lekë.

43.1.3.1 I pyetur nga Komisioni¹⁴⁹ në lidhje me depozitat e ndodhura në Bankën e Kursimeve, duke i kërkuar të deklarojë mbi momentin e krijimit të tyre, si dhe në mënyrë kronologjike shtesat/pakësimet e shumave në këto llogari dhe të depozitave dokumentacionin justifikues ligjor për burimin e krijimit të tyre, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar *vëllai i tij D.P (M) ka qenë i angazhuar në fushën e biznesit për periudhën 1991 – 1995, ka emigruar në vitin 1998 drejt Kanadasë e, për rrjedhojë, gjithçka i mbeti atij (subjektit) si i vetmi i afërm që mundej të merrej me to, pasi mamaja dhe gjyshja e tyre ishin të moshuara dhe me probleme shëndetësore ose pleqërie. Ka qenë kjo arsyeja për të cilën një pjesë të parave cash që i vëllai i pati lënë në Shqipëri, ose që u përftua nga shitja e sendeve që ai kishte pasë lënë në Shqipëri, u përdorën dhe u depozituan në Bankën e Kursimeve.*

43.1.3.2 Në mbështetje të deklarimeve të dhëna, subjekti ka paraqitur edhe disa dokumente¹⁵⁰, të cilat, pasi u administruan nga Komisioni, duket se konfirmojnë se vëllai i subjektit ka pasur

¹⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2020, e DPSHTRR-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.9.2020.

¹⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., “Vërtetim” i lëshuar nga Raiffeisen Bank në datën 10.5.2023, paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

¹⁴⁹ Pyetësori nr. ***.

¹⁵⁰ (i) Vërtetim nr. *** prot., datë 23.11.2001, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, sipas të cilit vërtetohet se personi fizik ka derdhur në rregull kontributin e sigurimeve shoqërore sipas ligjit në fuqi për periudhën 1 janar – 30 qershor 1993, për shtetasin D.M; (ii) librezë pune, model i vjetër, të plotësuar në faqen e

të regjistruar një aktivitet si person fizik tregtar në prill të vitit 1994 dhe duket se është larguar nga Shqipëria¹⁵¹ në shkurt të vitit 1995. Por, nga ana tjetër, duket se nuk provojnë shuma të ardhurash të mundshme të përfituara nga ky aktivitet e, për rrjedhojë, këto të ardhura mbeten të nivelit deklarativ dhe nuk janë përlllogaritur në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni. Nga ana tjetër, duket se subjekti ka pasur në pronësi dy automjete¹⁵² dhe ka qenë palë shitëse e tyre, konkretisht një kamion¹⁵³, shitur nga subjekti në datën 13.3.1995 kundrejt çmimit 800,000 lekë dhe të një autoveture¹⁵⁴, shitur nga subjekti në datën 14.7.1995 kundrejt çmimit 70,000 lekë. Të ardhurat e përfituara nga shitja e kamionit në vlerën 800,000 lekë janë përfshirë nga Komisioni në analizën financiare paraprake të përgatitur për periudhën 1995 – 2003, duke konsideruar se kjo pasuri duket se ka qenë në pronësi të vëllait të subjektit deri më 22.12.1994, kohë në të cilën duket se ai ia ka shitur këtë pasuri subjektit dhe brenda një periudhe të shkurtër kohe është shitur prej vetë subjektit ndaj një pale të tretë në datën 13.3.1995. Pra, duket se përpulhet deklarimi i personit të lidhur D.P (M) se të ardhurat në shumën 800,000 lekë nga shitja e kamionit i kanë mbetur vëllait të tij (subjektit të rivlerësimit). Ndërsa, të ardhurat në shumën 70,000 lekë, me burim nga shitja e automjetit, do të konsiderohen në zërin e të ardhurave në analizën financiare, pasi edhe në zërin e shpenzimeve ky mjet do të përlllogaritet i blerë nga subjekti 3 muaj më parë në vlerën 155,000 lekë.

43.1.4 Depozitë kursimi në Bankën Italo-Shqiptare në emër të shtetasve V.M/Elio Mazreku, datë 16.5.2001, llogaria nr. ***, në shumën 1,050,000 lekë, me burim të ardhurat e mbledhura nga pagat dhe përkthimet, hartimi i raporteve juridike, kursime etj., të subjektit dhe personit të lidhur.

43.1.5 I pyetur nga Komisioni¹⁵⁵ në lidhje me burimet e krijimit të depozitës në vlerën 1,050,000 lekë të ndodhur në Bankën Italo-Shqiptare (sot ISP Bank), subjekti ka deklaruar se janë të njëjtat burime të ardhurash nga puna, përkthime etj., të kryera nga personi i lidhur prej vitit 1996 e në vijim (burime të cilat janë trajtuar si më lart). Gjithashtu, si burim krijimi ka deklaruar edhe të ardhurat nga puna e tij.

parë dhe në faqet 16-17, ku konfirmohet sa më sipër; (iii) kontratë shitblerjeje nr. *** regj/nr. *** kol., datë 14.7.1995, nëpërmjet së cilës ka shitur automjetin e markës “****”, tip “****”, me targë TR *** B; (iv) kontratë shitblerjeje nr. *** regj., nr. *** kol., datë 1.3.1995, nëpërmjet së cilës ka shitur kamionin tip “****” me targë TR *** B; (v) vendim nr. ***, datë 14.4.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin shtetasi D.M regjistrohesh si person fizik me objekt veprimtarie “Transport mallrash me automjet privat dhe tregtim i mallrave të ndryshme shtëpiake, industriale, fruta-perime, materiale ndërtimi etj., me shumicë e pakicë, import dhe eksport”; (vi) dokument nr. ***, datë 14.4.1994, me titull “Entscheidung”, që duket të jetë vendimi i gjykatës i përkthyer në gjermanisht; (vii) kopje e pasaportës nr. ***, datë 23.3.1994, e shtetasit D. M, me disa viza dhe vula hyrëse e dalëse; (viii) vërtetim nr. *** prot., datë 23.11.2001, i DRSSH-së Tiranë, që vërteton pagimin e kontributeve për sigurimet shoqërore, për shtetasin D.M, për periudhën 1 janar – 30 qershor 1993; (ix) dokumente të gjendjes civile nga Bashkia Tiranë, vërtetime nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Prokuroria e Rrethit Tiranë, të lëshuara në vitin 1998, të përkthyer në anglisht dhe të noterizuara.

¹⁵¹ Deklaruar data e largimit nga Shqipëria nga vetë personi i lidhur në dokumentin “Deklaratë me sqarime për procesin e *Vetting*-ut”, dorëzuar nga personi i lidhur bashkëlidhur në deklaratën *Vetting*.

¹⁵² (i) Deklaruar nga vetë personi i lidhur në dokumentin “Deklaratë me sqarime për procesin e *Vetting*-ut”, dorëzuar nga personi i lidhur bashkëlidhur në deklaratën *Vetting*; (ii) sipas dokumentit kontratë shitjeje (kamioni) me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.1994, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Ç, me palë shitëse D. M, palë blerëse Elio Mazreku, paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. ***; (iii) sipas dokumentit kontratë shitjeje (autoveturë) me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.1995, redaktuar nga noteri publik, znj. Z.S, me palë shitëse F.A, palë blerëse Elio Mazreku, paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

¹⁵³ Kontratë shitjeje (kamioni) me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.3.1995, redaktuar nga noteri publik, znj. K. P, palë shitëse Elio Mazreku, palë blerëse L.V, paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

¹⁵⁴ Kontratë shitjeje (autoveturë) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.7.1995, palë shitëse Elio Mazreku, palë blerëse E.P, paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

¹⁵⁵ Pyetësori nr. ***.

43.1.6 Në mbështetje të deklarimeve, subjekti ka depozituar disa dokumente¹⁵⁶, në dukje të lidhura me punësimin e tij: (i) prej qershorit deri në korrik të vitit 1997 pranë ***-së; (ii) prej tetorit në dhjetor 1997 pranë shoqatës mjedisore “***”; (iii) për periudhën janar 1998 – shtator 2002 si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Tiranë; (iv) për periudhën shtator 2000 e në vijim nga puna si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Tiranë.

➤ **Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e pretenduara si të përfituara prej punësimit 1-mujor pranë ***-së.**

43.1.7 Nga ana tjetër, duket se provohet se subjekti ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë “***”¹⁵⁷, si dhe nga puna në Prokurorinë e Rrethit Tiranë¹⁵⁸ për periudhat e referuara si më sipër, për rrjedhojë këto të ardhura janë reflektuar në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni për periudhën 1995 – 2003.

43.1.8 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur për periudhën 1995 – 2003 dhe për vitet 2004 – 2016, nga ku duket se periudha 1995 – 2003, vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014 paraqiten me balancë negative fondesh në vlera të konsiderueshme. Totali i balancës negative të fondeve është në shumën prej rreth 22.8 milionë lekësh.

43.1.9 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti dërgoi prapësimet e tij të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse lidhur me analizën e treguesve financiarë, të cilat Komisioni i ka analizuar dhe vlerësuar në këtë vendim kryesisht në trajtimin e të ardhurave të personit të lidhur.

43.1.10 Pas kryerjes së analizës financiare përfundimtare, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur paraqiten me pamundësi financiare për të justifikuar plotësisht me të ardhura nga burime financiare të ligjshme pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera për periudhën 1995 – 2003 dhe vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, të pasqyruara balancat negative të fondeve si vijon¹⁵⁹: (i) për periudhën 1995 – 2003, balanca negative e fondeve (-2,618,896 lekë); (ii) për vitin 2004, balanca negative e fondeve - 620,074 lekë; (iii) për vitin 2005, balanca negative e fondeve -753,178 lekë; (iv) për vitin 2006, balanca negative e fondeve -1,330,388 lekë; (v) për vitin 2007, balanca negative e fondeve - 1,926,657 lekë; (vi) për vitin 2008, balanca negative e fondeve -7,838,151 lekë; (vii) për vitin 2009, balanca negative e fondeve -1,707,408 lekë; (viii) për vitin 2010, balanca negative e fondeve -706,948 lekë; (ix) për vitin 2011, balanca negative e fondeve -716,086 lekë; (x) për vitin 2012, balanca negative e fondeve -728,937 lekë; (xi) për vitin 2013, balanca negative e fondeve -1,408,852 lekë; (xii) për vitin 2014, balanca negative e fondeve - 257,721 lekë.

43.2 Si konkluzion, referuar kësaj analize, rezulton një balancë negative fondesh në total për vlerën prej rreth 20.6 milionë lekësh, nga ku Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1995 – 2003 dhe për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008,

¹⁵⁶ (i) Kopje dokumenti identifikimi të ***-së për Elio Mazrekun, shoqërues; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 22.12.1997, e Prokurorisë së Përgjithshme, vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Tiranë për emërimin e Elio Mazreku në këtë Prokurori; (iii) *Curriculum Vitae* Elio Mazreku, pa datë.

¹⁵⁷ Referojuni dokumentit pasqyrë kontributesh sigurimesh shoqërore “***”, vitet 1995 – 1998 (anglisht), paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

¹⁵⁸ Referojuni dokumentit “Vërtetim” të datës 24.1.2017, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

¹⁵⁹ Për më tepër, referojuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare – ndodhur në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

44. Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë, duke u vendosur në kushtet parashikuara sipas leximit *acontrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e këtij ligji, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

45. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

46. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin¹⁶⁰ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Elio Mazreku, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete me ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

47. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Elio Mazreku.

48. Komisioni ka kërkuar nga AKSIK-ja përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione të reja të mundshme, të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku. AKSIK-ja ka dërguar në Komision shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit pas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt. Nga verifikimi i tyre rezultojnë të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, z. Elio Mazreku, në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korruptiv.

49. Në këtë kontekst, në kushtet kur duket se ekzistojnë informacione apo sinjalizime mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, z. Elio Mazreku, në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korruptiv, AKSIK-ja ka përpiluar një raport të ri¹⁶¹, me konkluzionin se: Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku, gjykohet se për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera, që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ të kryer.

¹⁶⁰ Raporti i AKSIK-së nr. *** prot., datë 2.11.2017.

¹⁶¹ Raporti i AKSIK-së nr. *** prot., datë 21.6.2022 (deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 29.9.2022, të KDZH-së).

50. Trupi gjykues vëren se informacionet e përcjella nga institucioni i verifikimit – mbi bazën e të cilave duket se është përditësuar/ndryshuar raporti i AKSIK, nuk evidentojnë raste konkrete mbi të cilat mund të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe/apo përfshirja e tij në veprimtari të kundërligjshme.

51. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, z. Elio Mazreku, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve/sinjalizimeve të përfituara nga agjencitë ligjzbatuese/institucionet e verifikimit.

52. Në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfituara nga institucionet e verifikimit, Komisioni, ndër të tjera, administroi¹⁶² dosjet/fashikujt e plotë të dy çështjeve gjyqësore penale, të hetuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

53. Pas shqyrtimit dhe analizimit të këtyre dy dosjeve gjyqësore penale dhe akteve pjesë përbërëse të tyre, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk ekzistojnë të dhëna/fakte dhe/apo dokumentacion për gjetje mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Elio Mazreku, për aspekte që lidhen me kriterin etiko-profesional dhe/apo figurën e tij. Për më tepër duket se informacionet/sinjalizimet e përfituara nga institucionet e verifikimit nuk lidhen me dosjet penale të shqyrtuara dhe rrethanat e evidentuara në këto dosje.

54. Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës

55. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Elio Mazreku, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

56. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë – si organi ndihmës për vlerësimin profesional – ka përpiluar raportin për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Elio Mazreku.

57. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me short; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore. Në këtë raport janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

¹⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 1.9.2023, e Komisionit dhe shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.9.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.10.2022), e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

58. Referuar këtij raporti, rezulton se subjekti i rivlerësimit Elio Mazreku tregon korrektësi në zbatimin e ligjit, shfaq aftësi në arsyetimin ligjor, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Gjithashtu, nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

59. Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore.

60. Pas shqyrtimit dhe analizimit të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, mbi të cilin është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

61. Ndërsa, pas verifikimit të të dhënave dhe materialeve të përfuara nga burimet arkivore të prokurorive të rretheve gjyqësore, rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit, prokurorit Elio Mazreku, janë depozituar 8 materiale kallëzuese, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

62. Gjithsesi, nga shqyrtimi në tërësi i këtyre materialeve kallëzuese, Komisioni evidentoi disa rrethana/pretendime/gjetje, të cilat lidhen me dosje penale të hetuara nga prokurori Mazreku, të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur sa vijon: (i) në një rast është pretenduar se subjekti ka vendosur mosfillimin e çështjes penale, duke mos kryer asnjë lloj verifikimi mbi faktet e kallëzuar; (ii) në një rast është vendosur nga Gjykata prishja e vendimit të pushimit të marrë nga prokurori Mazreku dhe vazhdimi i hetimeve, duke lënë dhe detyra për veprime hetimore konkrete; (iii) në dy raste pretendohet se janë shkelur të drejtat e kallëzuesit/viktimës së veprës penale; (iv) në një rast, Gjykata, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes (kërkesën e prokurorit Mazreku), e ka pranuar pjesërisht atë, duke vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, duke u thelluar për akuzën në ngarkim të shtetasës së kallëzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, si dhe kthimin e akteve, duke urdhëruar formulimin e akuzës për veprën penale të “kallëzimit të rremë”, të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal; (v) në një rast, nga Drejtuesi i Prokurorisë është vendosur zëvendësimi i prokurorit Mazreku, në shqyrtim të pretendimeve të bëra mbi njëanshmëri në kryerjen e veprimeve hetimore.

63. Në vlerësimin e prokurorit Mazreku u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 16 denoncime të depozituara nga publiku. Pas verifikimit dhe analizimit të tyre, më dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe/apo të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbi veprimet e kryera prej tij në hetimin dhe shqyrtimin e çështjeve penale që lidhen me 6 denoncime të depozituara nga publiku, përkatësisht për denoncimet/ankesat e bëra nga shtetasit A.A¹⁶³, B.K¹⁶⁴, B.D¹⁶⁵, D.D¹⁶⁶, G.B¹⁶⁷ dhe S.B¹⁶⁸. Më konkretisht, pas shqyrtimit të tyre dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni konstatoi se ngrihen pretendime dhe/apo duket se evidentohen gjetje: (i) për zvarritje të procesit të hetimit; (ii) për moskryerjen e veprimeve hetimore apo moskryerjen e veprimeve të duhura hetimore; (iii) për mosvënie në dispozicion të akteve të dosjes.

64. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet/argumentet e tij dhe depozitoi prova të reja mbi gjetjet/konstatimet dhe kërkesat e

¹⁶³ Ankesë nr. *** prot., datë 3.1.2018.

¹⁶⁴ Ankesë nr. *** prot., datë 8.2.2018.

¹⁶⁵ Ankesë nr. *** prot., datë 26.9.2018 dhe ankesë nr. *** prot., datë 13.5.2019.

¹⁶⁶ Ankesë nr. *** prot., datë 19.3.2019.

¹⁶⁷ Ankesë nr. *** prot., datë 30.11.2022.

¹⁶⁸ Ankesë nr. *** prot., datë 2.10.2023.

bëra nga Komisioni pas verifikimit dhe analizimit të materialeve kallëzuese të depozituara ndaj tij, si dhe pas shqyrtimit të 6 denoncimeve të depozituara nga publiku.

65. Pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi shpjegimet dhe provat e depozituara mbi gjetjet/konstatimet dhe kërkesat e bëra në vlerësimin e kriterit profesional, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në shqyrtimin e disa çështjeve penale, duke evidentuar raste të zvarritjes së procesit hetimor pa shkaqe të justifikuara, si dhe shkelje të të drejtave të kallëzuesve/viktimizeve të veprave penale, pasi pas kërkesave të bëra prej tyre duket se nuk i është dhënë informacion/kopje e akteve/ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta, në kundërshtim me parashikimet e bëra nga nenet 58 dhe 105 të Kodit të Procedurës Penale. Duket se këto raste janë pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit në prapësime, ku, krahas sqarimeve teknike e procedurale, ai ka argumentuar se ato kanë ardhur si rezultat i ngarkesës së lartë në punë, kjo për shkak të situatës së krijuar nga procesi i rivlerësimit kalimtar të prokurorëve. Gjithsesi, këto mangësi në raport me gjithë konstatimet e tjera për këtë kriter, trupi gjykues i çmon të pamjaftueshme për cenimin e kriterit të aftësive profesionale.

66. Sa i përket konstatimeve dhe kërkesave të tjera të lidhura me kriterin e vlerësimit profesional, të evidentuara pas shqyrtimit të materialeve kallëzuese dhe denoncimeve të depozituara nga publiku, Komisioni vlerëson se nëpërmjet parashtrimeve të paraqitura në prapësimet e tij dhe shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor mbi to. Në këtë kontekst, nga shqyrtimi në tërësi i tyre nuk evidentohen gjetje, që do mund të ndikonin në kriterin e vlerësimit, aspektin etiko-profesional për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Elio Mazreku.

67. Vlen të evidentohet këtu se disa nga çështjet penale të lidhura me denoncimet e bëra nga publiku, për të cilat subjektit iu kërkuan shpjegime, duket se janë ende në hetim dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se nuk ka kompetencë në trajtimin e mëtejshëm të tyre dhe as nuk mund të shprehet proporcionalisht për penalizim të subjektit në këtë vlerësim, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit¹⁶⁹.

68. Si përfundim, nga vlerësimi tërësor i gjetjeve të evidentuara në trajtimin e kriterit të vlerësimit profesional, në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti nëpërmjet prapësimeve të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe sqarimet e dhëna prej tij në seancë dëgjimore, Komisioni vlerëson se ato nuk përbëjnë shkelje procedurale të tilla, që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

Konkluzioni i Komisionit për kriterin e vlerësimit profesional

69. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

70. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi rezulton se: (i) ka

¹⁶⁹ Referojuni vendimit nr. 33 (JR), datë 3.11.2021.

mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (ii) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Elio Mazreku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
U shpall në Tiranë, më 23.11.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKSI NR. 1 - TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

Analiza e treguesëve financiarë për periudhën 1995 - 2003 dhe për vitet 2004 - 2016 (Vlerat në lek)	1995-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) Pasuri	5,324,024	1,288,516	1,455,333	2,122,918	2,476,626	8,969,269	7,073,508	3,697,003	2,148,544	2,373,591	3,917,116	2,682,978	1,030,566	2,865,900
Pasuria e llojit apartament banimi, ndodhur në Tiranë								15,990,000						
Automjetet i markës *** tip, ***	155,000													
Automjetet i markës *** tip ***	320,000													
Ndryshim likuiditeti	4,849,024	1,288,516	1,455,333	2,122,918	2,476,626	8,969,269	7,073,508	-12,292,997	2,148,544	2,373,591	3,917,116	2,682,978	1,030,566	2,865,900
B) Detyrime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C) Pasuri neto (A-B)	5,324,024	1,288,516	1,455,333	2,122,918	2,476,626	8,969,269	7,073,508	3,697,003	2,148,544	2,373,591	3,917,116	2,682,978	1,030,566	2,865,900
D) Të ardhura	4,394,657	950,034	1,112,993	1,296,320	1,626,842	1,768,248	6,004,704	3,536,535	2,001,938	2,356,854	3,135,454	3,312,255	3,264,162	3,878,767
Të ardhura të dokumentuara nga paga e subjektit	2,697,011	805,782	805,747	952,591	905,056	1,073,092	1,349,936	1,281,341	1,417,352	1,163,959	1,044,842	1,209,219	1,267,716	1,268,826
Të ardhura nga puna e subjektit si ekspert	-								-			-		
Të ardhura si ish kreditorë të ***	-		101,626											
Të ardhura (B.Sh) nga paga ***	353,425													
Të ardhura (B.Sh) nga paga *** (dem)														
Të ardhura (B.Sh) nga paga *** (euro)		-	-	-	-	-	-	-	-					
Të ardhura (B.Sh) nga paga *** (lekë)	-							1,374,036	202,140	205,848	823,392	959,845	1,198,788	1,357,224
Të ardhura (B.Sh) mësimdhënie / përkthime / konsulencia / trainime	-	8,985	47,642	173,968	445,402	429,325	4,294,298	139,652	103,650	541,520	693,079	716,877	414,776	255,291
Të ardhurat nga Minibashkia 9	-										9,900			
Të ardhurat nga qiraja (lekë)	-									162,000	216,000	216,000	300,900	108,800
Të ardhurat nga qiraja (euro)	-													91,984
Të ardhurat nga interesat depozita në lekë pranë Intesa San Paolo	110,716	51,514	40,945	41,179	40,476	47,064	53,055	58,178	54,057	53,987	47,826	47,295	31,644	31,668
Të ardhurat nga interesat depozita në euro pranë Intesa San Paolo	42,621	53,738	85,649	121,110	152,709	133,158	124,688	64,963	12,342	19,100	63,294	81,573	22,113	5,431
Të ardhurat nga interesat depozita në euro pranë BKT	-				70,491	10,224		348,552						
Të ardhurat nga interesat depozita në euro pranë Veneto Bank	-					680	41,694	91,753	69,288	67,764	59,309	26,102	281	44,910
Të ardhurat nga interesat depozita në euro pranë Credins Bank	-										29,164	29,003	19,133	8,657
Të ardhurat nga interesat depozita në euro pranë ProCredit Bank	-					41,727	91,059	35,820						
Të ardhurat nga interesat depozita në lekë Raiffeisen Bank	320,884	30,015	31,384	7,472	12,709	32,978	49,974	80,608	99,268	40,820	88,566			
Të ardhurat nga interesat depozita në euro Raiffeisen Bank	-							13,603	18,117	24,172	37,576	2,522	1,377	-
Të ardhurat nga interesat depozita në euro Tirana Bank	-							41,088	25,724	17,744	73	2,662		
Të ardhurat nga interesat depozita në euro Alpha Bank	-							6,941		59,940	22,434	21,157	7,433	1,082
Të ardhurat nga fondi Raiffeisen Invest Euro														134,729
Të ardhurat nga fondi Raiffeisen Invest Lekë														543,165
Të ardhurat nga personi i lidhur A.M (vajza)	-													27,000
Të ardhurat nga shitja e automjetit ***	800,000													
Të ardhurat nga shitja e automjetit ***, ***	70,000													
Të ardhurat nga vëllai S.R., D.P														
Të ardhurat nga babai, H.M	-													
E) Shpenzime	1,689,529	281,592	410,839	503,791	1,076,873	637,129	638,605	546,480	569,480	712,199	627,191	886,998	903,987	978,244
Shpenzime jetike	1,659,529	281,592	410,839	438,228	943,872	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime për mobilim	30,000					50,000	40,000		23,000					
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit				65,563	133,001	40,649	52,125			148,103	63,095	7,006	6,883	37,876
Balanca e fondeve (D-C-E)	-2,618,896	-620,074	-753,178	-1,330,388	-1,926,657	-7,838,151	-1,707,408	-706,948	-716,086	-728,937	-1,408,852	-257,721	1,329,609	34,623